



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Departamenti i të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit

Seksioni për monitorim të sistemit juridik

KOSOVË

SHQYRTIM I SISTEMIT TË DREJTËSISË PENALE

1999-2005

REFORMA DHE SHQETËSIMET E MBETURA

Mars 2006

Fjalorth.....	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
Kreu 1	10
HYRJE	10
i. Sfond	10
II. Mandati i seksionit për monitorim të sistemit juridik.....	11
KREU 2	13
SHQETËSIMET QË JANË TRAJTUAR	13
I. Hyrje	13
II. Zhvillimet institucionale.....	14
i. Njësia e inspektimit gjyqësor dhe Këshilli gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës	14
ii. Instituti gjyqësor i Kosovës	16
iii. Qendra burimore për mbrojtje penale juridike	17
iv. Shërbimi sprovues	18
v. Gjykatat.....	19
a. Numri i gjyqtarëve nëpër gjykata	19
b. Pjesëmarrja e pakicave në sistemin e drejtësisë	21
c. Pajisjet e përkthimit	233
d. Shpërndarja e vendimeve të Gjykatës Supreme.....	23
III. Zhvillimet legjislative.....	24
i. Qarkoret e drejtësisë	24
a. Vendimet mbi paraburgimin.....	25
b. Masat e sigurimit për personat e sëmurë mental	25
c. Programi për mbrojtjen e dëshmitarëve	26
ii. Ligjet	277
a. Zbatim i instrumenteve për të drejtat e njeriut	27
b. Kodi i përkohshëm penal dhe i procedurës penale	28
IV. Zhvillimet në praktikë	29
i. Gjykatat.....	29
a. Trajtimi i pakicave në sistemin gjyqësor.....	29
b. Viktimat e sulmit seksual.....	301
c. Qasja në avokatin mbrojtës.....	312

ii.	Paraburgimet jashtë-gjyqësore	32
a.	Paraburgimet me vendim ekzekutiv të PSSP	32
b.	Paraburgimet jashtëgjyqësore nga KFOR-i	344
c.	Mekanizmi habeas corpus.....	345
iii.	Mbrojtësit.....	35
a.	Oda e avokatëve të Kosovës.....	367
b.	Avokati mbrojtës.....	39
c.	Autoritetet tjera	40
VII.	ZHVILLIMI i PROGRAMIT PËR GJYQTARË DHE PROKURORË NDËRKOMBËTAR.....	41
KREU 3	445
	SHQETËSIMET TË CILAT NUK JANË ADRESUAR	445
I.	PARATHËNIE	445
II.	SHQETËSIMET QË KANË TË BËJNË ME INSTITUCIONET	445
i.	Gjykatat.....	445
a.	Mungesa e zyrave	445
b.	Pagat	456
ii.	Objektet e paraburgimit.....	467
a.	Dënimet alternative (masat jo-izoluese).....	467
b.	Personat me çrregullime mentale:	478
III.	ÇËSHTJET LIGJORE	489
i.	Qarkoret e drejtësisë.....	48
a.	Çështjet e përkthimit/interpretimit.....	48
b.	Qasja në vendimet e gjykatës	50
ii.	Ligjet.....	50
IV.	Shqetësimet lidhur me praktikën.....	501
i.	Gjykatat.....	501
a.	Kërkesat “Habeas corpus”	501
b.	Seancat publike	512
c.	Vendimet e arsyetuara për paraburgim	523
d.	Praktikat e shqiptimit të dënimeve	556
e.	Vonesat.....	556
f.	Menaxhimi i rrjedhës së lëndëve:.....	59
g.	Caktimi i prokurorëve komunal:	60

h	Dëshmia e ekspertit:.....	601
ii.	Çështjet e avokatëve mbrojtës.....	61
a.	Rekomandimet për avokatët mbrojtës.....	62
b.	Rekomandimet organeve gjyqësore	64
V.	SHQETËSIMET PËRKITAZI ME PROGRAMIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NDËRKOMBËTAR	66
i.	Aranzhimet joadekuate kontraktuale	667
ii.	Procedurat joadekuate për caktimin e lëndëve	678
iii.	Mungesa e mentorimit.....	70
	KREU 4	712
	PËRFUNDIMET.....	712
	SHTOJCË	723
	ZHVILLIMET PËRKATËSE NË LEGJISLACIONIN PENAL 2000 – 2005	723
	LIGJET E KUVENDIT TË KOSOVËS	767

FJALORTH

DAD	Departamenti administrativ i drejtësisë
CDRC(Orig.)	Qendra burimore për mbrojtje penalo-juridike
DAGJ	Departamenti i administratës gjyqësore
DD	Departamenti i drejtësisë
KEDNJ	K onventa E vroplane për Mbrojtjen e të D rejtave dhe L irive Themelore të N jeriut
SEGJ	Sistemi emergjent i gjyqësisë
LPP të RFJ-së	Ligji i procedurës penale të Republikës Federale të Jugosllavisë
PNDKP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
GJPN	Gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë
NJIGJ	Njësia e inspektimit gjyqësor
LPM	Ligji penal për të mitur
KFOR(Orig)	Forca e Kosovës
KGJK	Këshilli gjyqësor i Kosovës
KGJPK	Këshilli gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës
IGJK	Instituti gjyqësor i Kosovës

KFOS (Orig)	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
SMSJ	Seksioni për monitorim të sistemit juridik
NATO(Orig)	Organizata e Aleancës Veri-Atlantike
OMiK(Orig)	Misioni i OSBE-së në Kosovë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KPPK	Kodi i përkohshëm penal i Kosovës
KPPPK	Kodi i përkohshëm i procedurës penale të Kosovës
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
KB	Kombet e Bashkuara
UNMIK(Orig) në Kosovë	Misioni i administratës të përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
NJMD	Njësi për mbrojtjen e dëshmitarëve

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Deri më sot, Seksioni për monitorim të sistemit juridik (SMSJ) në Departamentin për të drejtat e njeriut dhe sundim të ligjit (departamenti) në kuadër të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (Misioni i OSBE-së në Kosovë), ka publikuar gjithsej nëntë raporte publike dhe tetë gjysmë-publike, me të cilat e ka analizuar sistemin e drejtësisë nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut dhe ka nënvizuar shqetësimet lidhur me gjykimin e drejtë dhe procesin e drejtë gjyqësor. Në këto raporte bëjnë pjesë gati 200 rekomandime të cilat u drejtohen autoriteteve relevante lidhur me veprimet specifike të cilat ndihmojnë evitimin e mangësive dhe ndihmojnë përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare. Autoritetet përgjegjëse të përmendura ishin, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) në misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, KFOR-i, Departamenti i drejtësisë i UNMIK-ut (DD), institucionet ligjore ose gjyqësore, kryetarët e gjykatave, prokurorët dhe avokatët mbrojtës. Ky raport e analizon shkallën e adresimit të shqetësimeve të përmendura në raportet e SMSJ-së nga ana e këtyre autoriteteve.

Një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve të OSBE-së janë përmbushur tërësisht ose pjesërisht nga autoritetet e përmendura. Sa i përket ndërtimit të institucioneve, autoritetet kanë themeluar Njësinë e Inspektimit Gjyqësor dhe Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës me qëllim të ngritjes së shkallës së mbikëqyrjes të sistemit të drejtësisë penale; Institutin Gjyqësor të Kosovës (IGJK) me qëllim të aftësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve; Qendrën burimore për mbrojtje penalo-juridike (CDRC) me qëllim të sigurimit të barazisë së armëve¹; dhe shërbimin sprovues me qëllim të adoptimit të një sistemi penal më rehabilitues. Në gjykata janë bërë përmirësime ku autoritetet në mënyrë të suksesshme kanë inkurajuar një pjesëmarrje më të madhe nga pakicat etnike. Sa i përket zhvillimeve legjislative, një numër i rekomandimeve të OSBE-së është përmbushur përmes fuqizimit të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, si dhe dy kodeve penale materiale dhe procedurale përfshirë këtu edhe nxjerrjen e qarkoreve të ndryshme të drejtësisë.

Gjithashtu janë trajtuar edhe një numër i rekomandimeve të OSBE-së që i janë drejtuar gjykatave, prokurorëve dhe avokatëve mbrojtës. Nëpër gjykata janë shënuar përmirësime të dukshme në lidhje me shqyrtimin e krimeve të cilat kanë të bëjnë me sulmet seksuale, si dhe përmirësime në çështjen e

¹ IGJK dhe CDRC janë themeluar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë

caktimit të avokatit mbrojtës. Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK), e cila e përfaqëson palën mbrojtëse, ka luajtur një rol të rëndësishëm në ngritjen e standardeve të përfaqësimit nga mbrojtja përmes hartimit të Kodit të sjelljes profesionale duke ofruar trajnime për anëtarët e vet. Standardet e mbrojtjes së avokatëve janë përmirësuar dukshëm në disa fusha.

Rekomandimi i OSBE-së se me qëllim të evitimit të animeve gjyqësore, gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar të marrin pjesë në lëndët etnikisht të ndjeshme, është përmbushur përmes zgjidhjes së re me të cilën gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar janë anëtarë të trupit gjykues së bashku me homologët e tyre vendor. Në fund, tani praktika e mëhershme e paraburgimeve jashtëgjyqësore nga ana e PSSP-së dhe KFOR-it është ndërprerë, si duket për gjithmonë, prandaj edhe janë përmbushur rekomandimet e OSBE-së të bëra në këtë drejtim.

Mirëpo, me gjithë përpjekjet e përmendura më lart, një numër i rekomandimeve të OSBE-së nuk ëhëtë trajtuar në masë të kënaqshme. Për pjesën më të madhe, kur autoritetet nuk kanë arritur të veprojnë sipas rekomandimeve, shqetësimi relevant edhe sot e kësaj dite ka mbetur problem. Në lidhje me institucionet ligjore dhe gjyqësore, përkundër rekomandimeve të OSBE-së autoritetet kanë dështuar që gjykatave t'u sigurojnë hapësirën e punës adekuate për mbajtjen e seanceve publike, dhe u kanë rezistuar thirrjeve për rritjen e pagave në gjyqësor me qëllim të tërheqjes së juristëve më të zotë dhe flakjes së korrupsionit. Ende vazhdon mungesa e përkrahjes institucionale për rastet e dënimeve alternative, veçanërisht për delinkuentët e mitur, kështu që një numër i këtij lloji të dënimeve nuk mund të përdoret. Përkundër rekomandimeve të shumta të cilat thërrasin për kushte më të mira për kryesit e sëmurë mental, ende mungon një objekt adekuat dhe i sigurt për këtë kategori. UNMIK-u ka shpallur në fuqi një numër ligjesh të reja, megjithatë ka mbetur e paprekur një fushë e gjerë çështjesh të cilat do të kishin përfitur me shpalljen e ligjeve më të reja ose me ndryshimin e tyre.

Shumicën e rekomandimeve të veta OSBE ia ka drejtuar gjyqtarëve. Mirëpo, pa marr parasysh ndihmën e ofruar përmes raporteve të hollësishme të rregullta dhe trajnimeve të dhëna përmes IGJK-së, në shumë fusha gjyqtarët duhet edhe më tej t'i ngritin standardet e tyre të praktikës me qëllim të përmbushjes së standardeve ndërkombëtare. Shkeljet e rregullave të procedurës së rregullt dhe gjykimit të drejtë ndodhin anekënd Kosovës përkundër rekomandimeve specifike të cilat tregojnë se cilat praktika duhet të ndryshohen. Veçanërisht, gjyqtarët nga të gjitha nivelet dështojnë vazhdueshëm që në mënyrë të rregullt dhe të plotë t'i arsyetojnë vendimet e veta mbi paraburgimin dhe dënimin. Gjykatat kanë dështuar t'i fusin në veprim praktikatat dhe rregullat procedurale me të

cilat sigurohet që seancat gjyqësore të mbahen pa shtyrje të panevojshme: aty mbeten problemet lidhur me sigurimin e pjesëmarrjes të dëshmitarëve në gjykim, në organizimin e prokurorëve në gjykatat komunale dhe në sigurimin e ekspertizës. Prandaj, përkundër tërheqjes së vazhdueshme të vëmendjes në këtë drejtim, një numër kryetarësh të gjykatave ende nuk sigurojnë që oraret e seancave gjyqësore të jenë të shpallura në vende ku ka qasje publiku.

Krahas kësaj, shumë rekomandime për avokatët mbrojtës kanë hasur në vesh të shurdhër. OSBE ka vazhduar të vrojtojë rastet në të cilat avokatët mbrojtës kanë dështuar në përfaqësimin efektiv të klientëve të tyre dhe me këtë kanë shkelur kodin vetjak të sjelljes profesionale. Në shumë raste kjo ka rezultuar në shkeljen e të drejtës të të akuzuarit për mbrojtje efektive.

Në fund, programi për gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtar, edhe pse komponentë e nevojshme për suksesin e gjithmbarshëm për luftimin e krimeve ndëretnike dhe krimin të organizuar gjatë periudhës pas konfliktit, prapë ballafaqohet me një numër të metash. Nëse disa nga rekomandimet e OSBE-së janë trajtuar, atëherë disa tjera janë injoruar. Kushtet joadekuate kontraktuale për gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar e pengojnë sistemin; procedura e ndarjes së lëndëve mund të jetë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare; dhe mungesa e angazhimit nga aspekti i përcjelljes së punës i ka pakësuar përfitimet afatgjata të programit. Këto probleme të mbetura të cilat kanë mundur të përmirësohen pa ndonjë përpjekje të madhe, e kanë lënë këtë program të hapur për kritika.

Kur kompetencat ligjore dhe gjyqësore fillojnë të kalojnë nga UNMIK-u në IPVQ-të, ky raport mund të shërbejë si një përkujtues i asaj se çfarë është arritur, dhe ndoshta çka është më me rëndësi, çfarë ka mbetur të bëhet.

KREU 1

HYRJE

I. SFOND

Ky shqyrtim është përgatitur nga Seksioni për monitorimin e sistemit juridik, që është pjesë e Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundim të ligjit (departamenti) në kuadër të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (Misioni i OSBE-së në Kosovë). OSBE funksionon nën ombrellën e Administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në cilësinë e Shtyllës për ndërtimin e institucioneve.

SMSJ e ka monitoruar sistemin e drejtësisë penale të administruar nga Kombet e Bashkuara (KB) që nga vitin 1999. Gjatë kësaj periudhe, SMSJ ka nxjerrë raporte me të cilat është analizuar sistemi juridik nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut dhe janë ndriçuar shqetësimet që kanë të bëjnë me gjykimin e drejtë dhe procedurën e rregullt gjyqësore. SMSJ i ka bërë mbi 190 rekomandime gjatë gjashtë viteve të fundit, të cilat nisen prej lirimit të personave të mbajtur në paraburgim në mënyrë joligjore dhe mbarojnë me sigurimin e pajisjeve për përkthim nëpër gjykatore. Këto rekomandime u janë drejtuar autoriteteve relevante, përfshirë institucionet ose aktorët relevantë ndërkombëtarë dhe të vendit, siç janë, PSSP, KFOR-i, DD i UNMIK-ut, institucionet ligjore dhe gjyqësore, kryetarët e gjykatave, prokurorët dhe avokatët mbrojtës. Pas publikimit të raporteve, SMSJ ka mbajtur takime me kryetarin e Gjykatës Supreme, kryetarët e gjykatave të qarkut dhe komunale, me prokurorinë, me përfaqësuesit e Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), dhe me aktorët brenda DD-së, me qëllim të diskutimit të mënyrave për rregullimin e problemeve të nënvizuara nga fusha e të drejtave të njeriut. Që nga janari i vitit 2005, SMSJ i ka shpërndarë edhe raportet e veta gjysmë-publike drejtpërsëdrejti gjykatave, prokurorive publike dhe Odës së Avokatëve të Kosovës, me qëllim të njoftimit për shqetësimet e vërejtura, dhe janë zhvilluar diskutime sipas kërkesës nga aktorët e lartpërmendur.

Në këtë shqyrtim analizohen zhvillimet dhe shqetësimet e mbetura nga fushat e caktuara me qëllim të pasqyrit të më të gjerë të sistemit të drejtësisë penale. Ky nuk është vlerësim gjithëpërfshirës i secilit rekomandim veç e veç. Kreu 2 i shqyrtimit merret me rekomandimet të cilat (së paku pjesërisht) janë trajtuar nga ana e autoriteteve. Kreu 3 i vështron rekomandimet të cilat asnjëherë nuk janë trajtuar si duhet dhe mangësitë përcjellëse të cilat vazhdojnë të qëndrojnë brenda sistemit juridik.

II. MANDATI I SEKSIONIT PËR MONITORIM TË SISTEMIT JURIDIK

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të KB-ve nr. 1244 e ka autorizuar Sekretarin e Përgjithshëm që ta themelojë praninë civile ndërkombëtare e cila në Kosovë do ta organizojë administratën e përkohshme. Një prej përgjegjësive kryesore të pranisë ndërkombëtare është “*mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut.*”² Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve, në raportin e vet të datës 12 korrik 1999, rolin udhëheqës për ndërtimin e institucioneve kuadër të UNMIK-ut ia ka caktuar OSBE-së dhe ka vënë në pah se një nga detyrat e shtyllës për ndërtimin e institucioneve duhet të jetë monitorimi i të drejtave të njeriut dhe ndërtimi i kapaciteteve. Ai gjithashtu e ka udhëzuar UNMIK-un të zhvillojë mekanizma të bashkërenditur me qëllim të lehtësimit të monitorimit të të drejtave të njeriut dhe funksionimit të rregullt të sistemit gjyqësor.³

Në Letrën e marrëveshjes, të datës 19 korrik 1999, të nënshkruar nga nënsekretari i përgjithshëm i KB-ve për operacione paqeruajtëse dhe kryesuesit të radhës të OSBE-së, deklarohet se OSBE duhet të zhvillojë mekanizma me të cilët sigurohet që gjykatat, tribunalet administrative dhe strukturat tjera gjyqësore të veprojnë në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe për drejtësinë penale.⁴ Në kuadër të OSBE-së, ky departament bartë përgjegjësinë e monitorimit dhe raportimit lidhur me sistemin gjyqësor nga këndi i të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Si njëri nga seksionet e departamentit, SMSJ i është dhënë detyra e monitorimit të lëndëve në sistemin

² Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 12 qershor 1999, para. 11/j.

³ “UNMIK-u do të ketë grupin e monitoruesve dhe këshilltarëve për të drejtat e njeriut të cilët do të kenë qasje të papenguar në të gjitha pjesët e Kosovës, për të bërë hetimet lidhur me cenimet e të drejtave të njeriut dhe për të siguruar se çështjet e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, janë adresuar përmes aktiviteteve të gjithmbarshme të misionit. Monitoruesit e të drejtave të njeriut, përmes zëvendës Përfaqësuesit Special për ndërtimin e institucioneve, ia konstatimet Përfaqësuesit Special. Konstatimet e monitoruesve të të drejtave të njeriut do të bëhen rregullisht publike dhe shkëmbehen, sipas nevojës, me mekanizmat e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, në konsultim me Zyrën e komisionarit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. UNMIK-u do të sigurojë raportim të bashkërenditur dhe aftësi të përgjigjes”. Lexo raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve para Këshillit të Sigurimit mbi administratën e përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, S/1999/779, 12 korrik 1999, paragrafi 87.

⁴ Qarkorja e drejtësisë 2001/15 Qasja e monitoruesve të OSBE-së në proceset gjyqësore dhe dokumentacionin gjyqësor, 6 qershor 2001, e riafirmuar faktin se monitoruesit gjyqësor të SMSJ-së kanë qasje në të gjitha proceset penale si dhe dokumentacionin përkatës me disa përjashtime. Kjo është ndryshuar me qarkoren e drejtësisë nr. 2004/6, 30 shtator 2004, e cila e ka vërtetuar se SMSJ ka qasje edhe në proceset civile dhe administrative si dhe dokumentacionin gjegjës gjyqësor në pajtim me marrëveshjen në mes të Shtyllës së I-rë të UNMIK-ut dhe OSBE-së. Kjo qarkore kishte për qëllim fuqizimin e të kuptuarit për gjyqësinë në lidhje me mandatin e OSBE-së dhe të sigurojë se monitoruesit gjyqësor mund t’i mbulojnë rastet në të gjitha proceset penale apo civile dhe administrative.

gjyqësor, vlerësimin të përshtatshmërisë së tyre me standardet ndërkombëtare dhe raportimin e çështjeve shqetësuese.

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut⁵ janë pjesë e ligjit në fuqi në Kosovë përmes, në mes tjerash, Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 – e cila i obligon bartësit e funksioneve publike në Kosovë që t’i respektojnë standardet e pranuar ndërkombëtare për të drejtat e njeriut – por edhe përmes Kornizës Kushtetuese⁶. Së këndejmi, gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë me standardet ndërkombëtare, OSBE-ja i shfrytëzon si bazë konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe interpretimet juridike të tyre.

⁵ Këto standarde ndërkombëtare përmenden hollësisht, në mes tjerash, në nenet 9, 10, 14 të Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike (PNDKP) dhe nenet 5 dhe 6 të Konventës evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (KEDNJ ose konventa evropiane).

⁶ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 për Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme, e miratuar me 15 maj 2001, kreu 3, neni 3.3, thekson se “dispozitat për të drejtat dhe liritë të parapara me këto instrumente [instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut] janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.”

KREU 2

SHQETËSIMET QË JANË TRAJTUAR

I. HYRJE

Në vitin 2004, OSBE-ja në raportin e vet ka dhënë kontekstin në vijim: “Me hyrjen e KB në Kosovë në vitin 1999, ende nuk ishte hequr pluhuri i konfliktit etnik i cili kishte pasuar pas sundimit komunist dhe dhjetë vite të represionit aktiv të brendshëm nga Beogradi. Krimi i organizuar ishte i përhapur ndërsa shërbimi policor ishte rrënuar. Nuk ekzistonte sistem gjyqësor funksional ndërsa sundimi i së drejtës thuhet se mungonte fare. Shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve publik aktiv – para fillimit të fushatës së bombardimeve të NATO-s tani kishin ikur. Forca ndërkombëtare ushtarake, KFOR-i ishte përgjegjëse për ruajtjen e ligjit dhe rendit”⁷. Pastaj, vazhdon duke përfunduar: “Para katër vitesh sistemi gjyqësor ishte i rrënuar. Që prej asaj kohë është transformuar në një sistem funksional, i cili ngërthen shumë norma dhe instrumente juridike moderne dhe progresive. Këto përmirësime janë produkt i përpjekjeve të jashtëzakonshme të bëra nga aktorët vendës dhe ata ndërkombëtar, përfshirë, gjyqtarët, prokurorët, avokatët mbrojtës si dhe ata të angazhuar në organe të ndryshme gjyqësore”⁸. Kreu 2 fokusohet në këto përpjekje duke i analizuar shqetësimet të cilat janë ngritur nga OSBE-ja dhe të cilat pastaj, në veçanti ose plotësisht janë trajtuar nga ana e autoriteteve.

Për të qenë më i përshtatshëm, ky kapitull ndahet në katër pjesë: zhvillimet institucionale, zhvillimet legjislativë, zhvillimet në praktikë dhe zhvillimet në programin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar. OSBE-ja nuk sugjeron se të gjitha reformat e përmendura më poshtë në tekst, ishin rezultat i drejtpërdrejtë i rekomandimeve pararendëse të OSBE-së; në disa raste autoritetet relevante vetëm se ishin në proces të shqyrtimit të reformave dhe rekomandimet e OSBE-së ishin bërë në po atë drejtim. Megjithatë, shumë prej reformave padyshim ishin bërë si përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj rekomandimeve të OSBE-së të dalura nga monitorimi dhe raportimi i saj. Reformat tjera janë bërë si reagim ndaj presioneve të ushtruara në kombinim, nga një numër i palëve të interesuara, përfshirë këtu edhe autoritetet vendore dhe ndërkombëtare që janë përgjegjëse për sistemin juridik.

⁷ Shqyrtimi i 6-të i sistemit të drejtësisë penale me titull “*Krimi, paraburgimi dhe dënimi*” (dhjetor 2004), më tutje në tekst: “Shqyrtimi i gjashtë”, f. 10.

⁸ “Shqyrtimi i gjashtë”, f. 13.

II. ZHVILLIMET INSTITUCIONALE

Me qëllim të rindërtimit të sistemit të drejtësisë penale dhe për ta ndihmuar funksionimin e drejtë dhe efektiv të tij, OSBE ka bërë një numër rekomandimesh me qëllim të krijimit, forcimit ose transformimit të institucioneve ligjore ose gjyqësore të Kosovës. Një përzgjedhje e institucioneve është paraqitur më poshtë.

i. Njësia e inspektimit gjyqësor dhe Këshilli gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës

Gjatë vitit 2000, përmes monitorimit të lëndëve me element ndëretnik (siç janë lëndët e krimeve të luftës), pikëpamja e OSBE-së ishte se, sikur përmes njëanshmërisë etnike ose paaftësisë, gjykatat kanë dështuar që t'i shqyrtojnë lëndët me zellin e duhur, që t'i ftojnë dëshmitarët relevantë dhe t'i analizojnë mospërputhjet e provave.⁹ Gjyqësori kishte nevojë për një mbikëqyrje më të shtuar. Në muajin korrik të vitit 2000, me qëllim të shtimit të nivelit të mbikëqyrjes së sistemit të drejtësisë penale, OSBE ka rekomanduar që PSSP-ja:

“të themelojë [...] një Zyrë për hetime gjyqësore (ZH Gj) brenda Departamentit të Drejtësisë. ZH Gj do të krijonte rregullat procedurale për shqyrtimin dhe hetimin e ankesave në mënyrë të drejtpërdrejtë. Si rezultat i hetimeve, ZH Gj do të mund të shqiptonte masa disiplinore ose do të shkarkonte gjyqtarët dhe prokurorët publik nga detyra ose do t'i përjashtonte nga shqyrtimi i rastit”¹⁰.

Në përgjigje të rekomandimit të dalë nga “Shqyrtimi i OSBE-së”, OSBE-ja dhe Departamenti administrativ i drejtësisë (DAD), e kishin krijuar një grup punues me qëllim të studimit të rekomandimeve si dhe për të përcaktuar veprimet e mëtutjeshme. DAD-i kishte pranuar se ekziston nevoja për një mbikëqyrje më të shtuar. Pas rekomandimeve të lartpërmendura, UNMIK-u e ka themeluar Njësinë e inspektimit gjyqësor (NJIGJ) dhe Këshillin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës (KGJPK).

NJIGJ në të cilën punojnë momentalisht 15 punëtorë ndërkombëtarë dhe 14 punëtorë vendorë, është përgjegjëse për kryerjen e inspektimeve, auditimeve (kontrollit të brendshëm) dhe hetimeve brenda sistemit gjyqësor të Kosovës, përfshirë edhe hetimin e pretendimeve për sjellje të pahijshme nga ana

⁹ Shih “Shqyrtimin e OSBE-së për sistemin e drejtësisë penale (1 shkurt 2000 - 31 korrik 2000), më tutje “Shqyrtimi i parë”.

¹⁰ “Shqyrtimi i parë, f. 76.

e gjyqtarëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve porotë¹¹. Seksioni i auditimit në kuadër të NJIGJ, i caktuar për vëzhgimin me kujdes të sistemit të gjykatave nga më shumë aspekte, ka filluar të funksionojë në vitin 2005. Pas hetimeve, NJIGJ mund t'ia paraqesë rastin e sjelljes së pahijshme këshillit disiplinor të KGJPK-së, i cili më pas ndërmer masat e përshtatshme kundër prokurorit ose gjyqtarit. Deri më sot, NJIGJ ka luajtur një rol të rëndësishëm në sistemin gjyqësor dhe ka reaguar pozitivisht ndaj shqetësimeve të ngritura nga OSBE-ja përmes hetimit të rasteve të mundshme të sjelljeve të pahijshme.

Këshilli gjyqësor dhe prokurorial i Kosovës është themeluar përmes Rregullores së UNMIK-ut 2001/8, dhe e zëvendëson Komisionin këshillëdhënës gjyqësor¹². Rregullorja thotë se KGJPK-ja “është përgjegjëse për ta këshilluar Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm për çështjet që kanë të bëjnë me emërimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe ndihmësgjyqtarëve (gjyqtarëve porotë) sipas nevojës, si dhe për të dëgjuar ankesat kundër cilitdo gjyqtar, prokuror ose ndihmësgjyqtari nëse ka të tilla”¹³. Gjithashtu, këshilli është kompetentë të vendosë lidhur me dënimet disiplinore si dhe për aprovimin e kodit të etikës për gjyqtarë, prokurorë dhe gjyqtarë porotë¹⁴. Gjatë mandatit të vet, KGJPK-ja ka vendosur mbi një numër rastesh të sjelljeve të pahijshme¹⁵. KGJPK është dëshmuar si një organ jetik për sistemin e drejtësisë penale. Pas kalimit të përgjegjësive nga fusha e drejtësisë edhe KGJPK-ja i është nënshtuar transformimit. Më 20 dhjetor 2005, është hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/52 për themelimin e Këshillit gjyqësor të Kosovës (KGJK). Kjo rregullore është miratuar si rezultat i riorganizimit të vazhdueshëm të sistemit juridik të Kosovës, “... për qëllim të ruajtjes të gjyqësisë të paanshme, të integruar, profesionale dhe të përgjegjshme”¹⁶. Në nenin 1 të Rregullores, është përcaktuar se Këshilli gjyqësor i Kosovës

¹¹ NJIGJ është themeluar përmes urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr 2002/4.

¹² Rregullorja e UNMIK-ut 1999/7, 7 shtator 1999, themelon Komisionin këshillëdhënës gjyqësor (KKGJ) me detyrën që të rekomandojë kandidatët për funksionet e gjyqtarit dhe prokurorit me mandat të përhershëm. Komisioni gjithashtu ka pasur autorizime të rekomandojë masa disiplinore, përfshirë edhe shkarkimin nga detyra të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

¹³ Shih Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/8 për themelimin e KGJPK-së, 6 prill 2001.

¹⁴ “Këshilli mund të vendos për sanksione disiplinore, ashtu siç janë parashkruar në nenin 7 dhe të largojë nga detyra gjyqtarët, prokurorët dhe ndihmësgjyqtarët dhe sipas nevojës t’i sugjerojë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm largimet e tilla. Me kërkesë të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të përgjithshëm, Këshilli mund të ofrojë këshilla edhe për çështje të tjera lidhur me sistemin gjyqësor.” Rregullorja e UNMIK-ut 2001/8, shih sipra futnotën 13.

¹⁵ Gjashtë raste për kryerje të veprës penale; 15 raste për pakujdesi në kryerjen e funksionit të gjyqtarit/prokurorit; shtatë raste të veprimtimit në kundërshtim me detyrat e gjyqtarit/prokurorit për të qenë të pavarur dhe paanshëm; tetë raste të vendosjes përmes sjelljes personale ose tjetër, në pozitë e cila nuk është e përshtatshme me kryerjen e detyrës së tij/saj, dhe nëntë raste të shkeljes së kodit të etikës dhe sjelljes profesionale. Shih raportin javor të Departamentit të Drejtësisë (29 nëntor – 5 dhjetor 2005).

¹⁶ Rregullorja e UNMIK-ut 2005/52 për themelimin e Këshillit gjyqësor të Kosovës.

(KGJK) themelohet si një organ profesional nën autoritetin e PSSP-së dhe e trashëgon KGJPK-në e cila do të shpërbëhet me themelimin e Këshillit gjyqësor.

ii. Instituti gjyqësor i Kosovës

OSBE në bashkëveprim me komunitetin ligjor të Kosovës e ka krijuar Institutin gjyqësor të Kosovës (IGJK). Ky institut zyrtarisht i ka filluar aktivitetet në gusht të vitit 1999, si seksion për trajnime gjyqësore në kuadër të Departamentit, ndërsa si IGJK është themeluar në shkurt të vitit 2000. Mandati i IGJK-së është t'i trajnojë gjyqtarët dhe prokurorët me qëllim të ngritjes të nivelit të aftësive të tyre profesionale dhe teknike. Me hyrjen në fuqi të propozim-ligjit, i cili ditët e fundit është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, IGJK do të krijohet si shkollë e pavarur e gjyqtarëve në kuadër të strukturës së përgjithshme qeveritare.

Gjatë gjashtë viteve të kaluara, OSBE i ka adresuar IGJK-së shumë rekomandime lidhur me lloje specifike të trajnimeve. Pothuajse në të gjitha rastet IGJK i ka mbajtur rregullisht këto trajnime dhe nga fushat e sugjeruara në rekomandime. Më poshtë janë paraqitur disa shembuj:

- Në shtator të vitit 2000, IGJK në bashkëveprim me ICTY, ka organizuar një seminar mbi të drejtën ndërkombëtare humanitare për gjyqtarët vendor dhe ndërkombëtar si dhe për prokurorët publik dhe për një grup të rëndësishëm të avokatëve mbrojtës. Krahas kësaj, në nëntor të vitit 2000 IGJK ka mbajtur edhe kurse njoftuese për gjyqtarët dhe prokurorët e ri. Këto seminare kanë trajtuar nenet 5 dhe 6 të KEDNJ-së¹⁷.
- Më 26/27 janar 2005, IGJK ka mbajtur një punëtori mbi Kodin e përkohshëm të procedurës penale të Kosovës ku janë trajtuar dispozitat mbi procedurën e shkurtër.¹⁸
- Në një diskutim të organizuar nga IGJK dhe të mbajtur më 20 shtator 2005 janë trajtuar çështjet e dënimeve, llogaritjes së dënimit dhe ndikimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese në

¹⁷ OSBE ka rekomanduar që IGJK të ofrojë më shumë trajnime gjithëpërfshirëse nga fusha e të drejtës ndërkombëtare humanitare në kontekst të të drejtës penale si për gjyqtarët vendor ashtu edhe për ata ndërkombëtar dhe për prokurorët. Shih "Shqyrtimi i dytë" i OSBE-së për sistemin e drejtësisë penale (1 shtator 2000 – 28 shkurt 2001), "Shqyrtimi i dytë", f. 97.

¹⁸ OSBE ka rekomanduar që IGJK si pjesë e trajnimit për gjyqtarë mbi procedurën penale, të ndriçojë ndryshimet e parashikuara në procedurën e shkurtër. Raporti tematik i OSBE-së "Administrimi i drejtësisë nga gjykatat komunale" (mars 2004), më tutje "Raporti për gjykatat komunale" f. 30.

masën e dënimit. Në këto takime OSBE i ka ngritur shqetësimet e veta lidhur me përdorimin joadekuat të rrethanave lehtësuese dhe rënduese¹⁹.

- IGJK i ka mbajtur dy punëtori mbi Ligjin e ri penal për të mitur. Punëtorja e parë është mbajtur më 10/11 mars 2005 dhe punëtorja e dytë është mbajtur më 12 korrik 2005²⁰.

Këto trajnime padyshim se kanë pasur ndikim pozitiv për gjyqtarët dhe prokurorët të cilët i kanë përcjellë ato. Si mesatare, përafërsisht diku rreth 25 gjyqtarë dhe/apo prokurorë kanë marrë pjesë nëpër secilën seancë trajnimi.

iii. Qendra burimore për mbrojtje penale juridike

Me qëllim të sigurimit të një barazie më të madhe midis palës akuzuese dhe palës mbrojtëse, në korrik të vitit 2000 OSBE ka rekomanduar:

“Të hapet një zyre për mbrojtje penale juridike e cila do të veprojë si qendër burimore dhe e dhënies së ndihmës për avokatët mbrojtës”²¹.

“Zyra e mbrojtjes”, do të përbëhet nga avokatët mbrojtës ndërkombëtar dhe vendor. Një zyre e tillë është parë si e rëndësishme për ngritjen e nivelit të barazisë “së armëve” midis prokurorisë dhe mbrojtjes, veçanërisht në proceset gjyqësore ku të pranishëm janë gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë. Në mënyrë të veçantë OSBE ka rekomanduar që në rastet e krimeve të luftës dhe rastet e motivuara etnikisht, kjo “Zyre” do të mund të ngritke përkrahjen materiale dhe përmbajtësore për mbrojtjen.

Një “Zyrë” e tillë është themeluar nga OSBE në bashkëpunim me OAK në vitin 2001, me emrin “Qendra burimore për mbrojtje penale juridike”. Ideja ishte të sigurohet ekspertiza e menjëhershme juridike për zbatimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në rastet individuale dhe fuqizimi i kapaciteteve në mesin e avokatëve mbrojtës të vendit. CDRC ka filluar të ofrojë shërbime

¹⁹ OSBE ka rekomanduar që IGJK të ofrojë trajnime mbi çështjet e caktimit të dënimit, duke ndriçuar nevojën për arsyetim të individualizuar dhe të hollësishëm të aktgjykimit si dhe për përdorimin adekuat të rrethanave lehtësuese dhe rënduese. “Shqyrtimi i gjashtë”, f. 62.

²⁰ OSBE ka rekomanduar që IGJK të vazhdojë të ofrojë trajnime për ligjin e ri penal për të mitur, për standardet ndërkombëtare në këtë lëmi, dhe përdorimin e masave alternative. “Shqyrtimi i gjashtë”, f. 63.

²¹ “Shqyrtimi i parë, f. 55.

në prill të vitit 2001 dhe e ka fituar statusin e OJQ-së më 3 maj 2001²². Që nga themelimi, CDRC u ka siguruar avokatëve mbrojtës qasje në instrumentet relevante ndërkombëtare si dhe materiale relevante si dhe u ka ndihmuar avokatëve vendor në përgatitjen e lëndëve. Kontributi i qendrës është dëshmuar të jetë mjaft i tejçmuar. Deri në shkurt 2005, CDRC-ja ka ofruar ndihmë profesionale për avokatët mbrojtës në 143 raste. Në gjashtë raste CDRC-ja ka ofruar ndihmë profesionale për aplikacionet e dërguara në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

OSBE-ja me keqardhje raporton se për shkak të problemeve të financimit CDRC-ja momentalisht funksionon me vetëm dy juristë dhe i është dashur t'i lë mënjanë shumicën e programeve të veta. Momentalisht qendra është e angazhuar në projektin e përbashkët me OAK për edukim të vazhdueshëm ligjor për anëtarët e OAK. Në fakt, CDRC-ja është duke koordinuar përgatitjet e përgjithshme rreth trajnimeve të CDRC-së për edukim të vazhdueshëm ligjor dhe ky partneritet tregon të jetë shumë i suksesshëm në kuptim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të anëtarëve të Odës.²³

iv. Shërbimi sprovues

Shërbimi sprovues është themeluar në vitin 2002. Në vitin 2004, roli i këtij shërbimi është paraparë me Kodin e përkohshëm penal të Kosovës (KPPK) edhe më të parashikohen përgjegjësi dhe detyra plotësuese për këtë shërbim. KPPK parashikon disa masa të reja të dënimeve alternative për të cilat përgjegjësinë e mbikëqyrjes e ka shërbimi sprovues, si p.sh puna në dobi të përgjithshme, gjysëm-liria, etj. Ky shërbim ka për detyrë të raportojë para organeve gjyqësore lidhur me vuajtjen e sanksionit të shqiptuar.

Në vitin 2004, shërbimi sprovues i ka shpërndarë 48 zyrtarë të shërbimit në tri rajone me qëllim të përcjelljes të ekzekutimit të dënimeve alternative. Mirëpo, përkundër mundësive për shfrytëzimin e shërbimit sprovues në shqiptimin e dënimeve alternative, gjykatat hezitonin t'i shqiptonin këto masa. Që nga tetori 2004, nuk ka pasur raste të shqiptimit të dënimit me kusht nën mbikëqyrjen e shërbimit sprovues; nuk ka pasur raste të dënimit me kusht të kombinuar me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme për të rriturit; dhe nuk ka pasur raste të zëvendësimit të burgimit me punë në

²² Raporti i OSBE-së: Qendra burimore për mbrojtje penale juridike, 28 maj 2001.

²³ Me vendim të bordit të OAK-së, që nga Nëntori 2005, CDRC është përgjegjëse për organizimin e trajnimeve për edukim të vazhdueshëm ligjor të cilat do të bëhen të detyrueshme atëherë kur Ligji mbi Avokatinë aprovohet.

dobi të përgjithshme. OSBE ka gjetur se gjyqtarët nuk ishin tërësisht të njoftuar për shërbimet e ofruara nga shërbimi sprovues. Për këtë arsye, në dhjetor të vitit 2004 OSBE ka rekomanduar që:

“Zyrat rajonale të shërbimit sprovues duhet të nxiten të vendosin kontakte me gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit komunal dhe të qarkut me qëllim të promovimit të një mirëkuptimi më të madh nga ana e gjyqësisë për shërbimet e ofruara nga shërbimi sprovues dhe përdorimit të masave alternative”²⁴.

Sipas gjykatave të qarkut dhe atyre komunale tani ka një bashkëpunim të mirë midis 46 zyrtarëve të shërbimit sprovues dhe gjykatave²⁵. Raportet e punës së shërbimit sprovues i dërgohen në kohë të duhur gjykatave dhe këto shërbime i ndihmojnë mjaft gjykatave. Ndërmjet 1 janarit 2005 dhe 1 dhjetorit 2005, mbi 1209 raporte nga shërbimi sprovues i janë dërguar prokurorëve dhe gjykatave²⁶. Deri më tani, shërbimi sprovues e ka përcjellë ekzekutimin e mbi 80 dënimeve alternative, përfshirë disa raste të punës në dobi të përgjithshme, mbikëqyrjen e shtuar nga shërbimi sprovues dhe disa masa tjera alternative²⁷. SMSJ rregullisht i përcjellë rastet në të cilat zyrtarët e shërbimit sprovues ofrojnë deklarata të qarta për kushtet sociale të kryerësve, nganjëherë duke rekomanduar shqiptimin e masave alternative. Shërbimi sprovues tani është dëshmuar të jetë një pjesë e rëndësishme përbërëse e procesit për rehabilitimin e delinkuentëve.

v. *Gjykatat*

a. *Numri i gjyqtarëve nëpër gjykata*

Numri i madh i lëndëve të pazgjidhura nëpër gjykata ka qenë dhe mbetet një nga problemet më të mëdha; në lëndët penale kjo mund të ndikojë në të drejtën e të akuzuarit për gjykim brenda kohës së arsyeshme dhe mundësinë e gjykatave për ta konstatuar të vërtetën, ngase vonesat mund të ndikojnë në disponuesmërinë e dëshmitarëve. Ka shumë shkaqe për vonesat²⁸. Një nga to është padyshim i vogël i personelit në gjykata. Në këtë drejtim, në tetor të vitit 2001, OSBE-ja ka rekomanduar që:

²⁴ “Shqyrtimi i gjashtë”, f. 63.

²⁵ Përbërja e shërbimit sprovues është: 24 juristë, 11 pedagogë, një psikolog dhe nëntë sociologë. OSBE është njoftuar nga shefi i shërbimit sprovues se punësimi është në vijim e sipër edhe për 23 punëtorë të ri prej të cilëve 15 do të jenë zyrtarë të shërbimit sprovues.

²⁶ Biseda me shefin e shërbimit sprovues është zhvilluar më 7 dhjetor 2005.

²⁷ Raporti i DD-së UNMIK (29 nëntor 2005 – 5 dhjetor 2005).

²⁸ Për numrin e madh të lëndëve të pazgjidhura dhe shtyrjet si rezultat i kësaj, gjyqtarët e fajësojnë numrin e pamjaftueshëm të gjyqtarëve nëpër gjykata. Nga 24 kryetarë të gjykatave komunale të cilët marrin pjesë në

“Emërimi i gjyqtarëve nëpër gjykatat komunale dhe ato për kundërvajtje, veçanërisht nëpër këto të fundit, duhet të bazohet në numrin ekzistues të lëndëve për secilën gjykatë, kështu që të mos ketë dallime midis numrit të lëndëve për një gjyqtar nëpër gjykata të ndryshme të Kosovës”²⁹.

Ky shqetësim është ngritur edhe një herë në raportin e OSBE-së për Administrimin e Drejtësisë në Gjykatat Komunale³⁰.

Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ua cakton obligimin autoriteteve gjyqësore që të organizojnë sistemin e tyre juridik në atë mënyrë që t’ju lejojë gjykatave ti përshtaten kërkesave që burojnë nga standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut³¹. Në vitin 1999, praktikisht nuk ekzistonte gjyqësia dhe nuk duhet nënvlerësuar përparimin e arritur nga UNMIK-u për plotësimin e posteve gjyqësore³². Mirëpo, gjatë dy viteve të fundit, nuk është bërë edhe aq sa duhet për të fuqizuar edhe më tej gjyqësorin përmes emërimit të gjyqtarëve të ri për postet e lira, përmes hapjes së vendeve të reja nëpër gjykatat e tej-ngarkuara, ose duke i rishpërndarë resurset midis gjykatave. Kjo ka ndikuar dëmshëm në aftësinë e gjykatave për ta reduktuar numrin e lëndëve të grumbulluara dhe për t’i shqyrtuar rastet më shpejtë.

Në kohën e fundit autoritetet kanë filluar të merren më seriozisht me çështjen e shpërndarjes joadekuate të gjyqtarëve. Në mars të vitit 2005, IGJK ka filluar trajnimin e 57 kandidatëve për postet gjyqësore dhe pas provimit dhe intervistës ata do të caktohen nga KGJPK të punojnë në

takimet rajonale të zhvilluara nga OSBE, 22 prej tyre janë ankuar për numrin e vogël të gjyqtarëve dhe për shpërndarje jo proporcionale të gjyqtarëve nëpër gjykata. Në realitet, numri i lëndëve të pazgjdhura është rezultat i një vargu problemesh që nga jo efikasiteti dhe administrimi i dobët i lëndëve nga vetë gjyqtarët. Shih “Raporti për gjykatat komunale”.

²⁹ “Shqyrtimi i tretë i sistemit të drejtësisë penale (tetor 2001), më tutje “Shqyrtimi i tretë”, f. 86.

³⁰ Raporti për gjykatat komunale, f. 30.

³¹ *Zimmermann dhe Steiner kundër Sëitserland*, KEDNJ, A 66 para. 29 (1983).

³² Nuk ka të dhëna statistikore për numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në vitin 1999. Sipas DAGJ në vitin 2000 numri i gjyqtarëve nëpër secilin nivel ishte: në gjykatat komunale – 137 gjyqtarë, në gjykatat e qarkut – 45 gjyqtarë, në Gjykatën Supreme – 14, në gjykatat komunale të kundërvajtjes – 115, në Gjykatën e lartë për kundërvajtje – 5 gjyqtarë. Në vitin 2005, ishin: në gjykatat komunale – 135 gjyqtarë, në gjykatat e qarkut – 46, në Gjykatën Supreme – 14 gjyqtarë, në gjykatat komunale për kundërvajtje – 96 dhe në Gjykatën e lartë për kundërvajtje - 5 gjyqtarë. Prokurorë në vitin 2005 ishin: prokuroritë komunale – 31 prokurorë, prokuroritë e qarkut – 19 dhe në Prokurorinë Publike të Kosovës ishin 4 prokurorë. Prokurorë në vitin 2005 ishin: prokuroritë komunale – 51 prokurorë, në prokuroritë e qarkut – 32 dhe 6 prokurorë në Prokurorinë Publike të Kosovës. Përderisa numri i gjyqtarëve në vitin 2005 është më i vogël se në vitin 2000, numri i prokurorëve në vitin 2005 është rritur, dhe kjo për shkak të rolit të ri të cilin e ka marrë ndjekja penale pas hyrjes në fuqi të Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës.

gjykatat komunale ose për kundërvajtje të cilat kanë numër të pamjaftueshëm³³. Më tutje, rishpërndarja e gjyqtarëve nëpër gjykata me gjasa do të shkojë krah-për-krah me ristrukturimin e sistemit të gjykatave i cili do të ndodhë atëherë kur të hyn në fuqi Ligji mbi Gjykatat.

Edhe pse sistemi gjyqësor do kishte funksionuar më mirë poqëse ky injektim dhe/apo rishpërndarje e gjyqtarëve do të kishte ndodhur vite më parë, prapë është një zhvillim për t'u përhëndetur dhe do të duhej ta zvogëlonte numrin e lëndëve të pazgjidhura.

b. Pjesëmarrja e pakicave në sistemin e drejtësisë

Pas konfliktit etnik ka barriera jashtëzakonisht të mëdha drejt krijimit të gjyqësisë multietnike. Kjo është më se e vërtetë edhe në rastin e Kosovës. Mungesa e pjesëtarëve të pakicave – serbëve, boshnjakëve, turqve, ashkalinjëve, romëve, egjiptianëve të Kosovës – në gjyqësi ka ndikuar dëmshëm në shkallën e besimit në sistemin gjyqësor në sytë e grupeve të pakicave. Në vitin 1999 OSBE ka deklaruar, “krijimi i sistemit gjyqësor i cili reflekton karakterin e llojllojshëm dhe multietnik është i rëndësishëm për ngritjen e shkallës së paanshmërisë të sistemit gjyqësor dhe zbatimin pa diskriminim të ligjit”³⁴.

Pas krijimit të sistemit emergjent të gjyqësisë (SEGJ) në vitin 1999, u bënë të dukshme vështirësitë për bindjen e pjesëtarëve të pakicave të marrin pjesë në sistemin gjyqësor. Ndërmjet qershorit 1999 dhe shtatorit 1999, PSSP ka emëruar gjithsej 55 gjyqtarë dhe prokurorë publik: 42 shqiptarë, 7 serbë, 4 boshnjakë, 1 turk dhe 1 rom të Kosovës³⁵. Mirëpo, duke e potencuar sigurinë si problem gjyqtarët serbë të Kosovës si dhe prokurorët kanë dhënë dorëheqje në tetor të vitit 1999, duke e lënë sistemin emergjent të gjyqësisë thuasje një-etnik. Janë bërë përpjekje për rekrutimin e gjyqtarëve nga pakicat, por shkalla e pjesëmarrjes ka mbetur relativisht e ultë. Në dhjetor 1999, OSBE është në raportin e vet gjysmë publik është shprehur³⁶ “[...] mungesa e serbëve të Kosovës në gjyqësor e pakëson besueshmërinë në sistemin gjyqësor dhe mund të rezultojë së paku në dukje të njëanshmërisë. Për këtë arsye, profesionistët ligjor – serbë të Kosovës – duhet të nxiten që të kthehen në sistemin gjyqësor. Duhet marrë hapa të duhur për t'i trajtuar shqetësimet e tyre që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen, për shembull, t'u ofrohen masa adekuate të sigurisë”. Shqetësimi lidhur

³³ Prej 57 kandidatëve, vetëm 6 (gjashtë) prej tyre do të caktohen në gjykatat për kundërvajtje.

³⁴ Raporti tematik i OSBE-së nr. 2: Zhvillimi i sistemit gjyqësor të Kosovës (10 qershor – 15 dhjetor 1999).

³⁵ “Shqyrtimi i parë”, f. 11.

³⁶ Raporti tematik i OSBE-së nr. 2 Zhvillimi i sistemit gjyqësor të Kosovës (10 qershor – 15 dhjetor 1999, f. 5.

me mungesën e pjesëmarrjes së pakicave në sistemin gjyqësor të Kosovës është ritheksuar në mars të vitit 2000³⁷ duke theksuar se është e nevojshme të përkrahet në mënyrë sistematike prania dhe pjesëmarrja efektive e përfaqësuesve të pakicave në sistemin gjyqësor. Në mars të vitit 2002, OSBE prapë ka rekomanduar:

“Autoritetet administrative gjyqësore duhet të emërojnë më shumë gjyqtarë dhe prokurorë nga grupet e pakicave (veçanërisht serbë) brenda sistemit gjyqësor”³⁸

OSBE përsëritet përpjekjet e mëdha dhe të vazhdueshme si dhe zotimin e shtyllës së I-rë të UNMIK-ut në shpërbërjen e strukturës së gjyqësisë paralele e cila është një nga arsyet për mungesën e gjyqtarëve dhe prokurorëve serb të Kosovës në sistemin e drejtësisë në Kosovë si dhe pengesë në themelimin e përbërjes multietnike në sistemin e drejtësisë.³⁹

Megjithatë, autoritetet kanë vazhduar të inkurajojnë rekrutimin e pakicave kudo në sistemin gjyqësor, gjë që ka çuar në një rritje të ngadalshme por të qëndrueshme. DD e ka krijuar Seksionin për integrim gjyqësor i cili e ka mandatin e rregullimit të problemeve rreth qasjes në drejtësi me të cilat ballafaqohen pakicat, monitorimin e trajtimit të pakicave nga sistemi gjyqësor dhe i trajton rastet e diskriminimit. Ky seksion ka qenë efektiv. Momentalisht janë 14 gjyqtarë -serbë të Kosovës dhe 17 gjyqtarë nga pakicat tjera, si dhe dy serbë të Kosovës si prokurorë dhe gjashtë tjerë nga grupet tjera të pakicave, të cilët shërbejnë në sistemin gjyqësor të Kosovës⁴⁰.

Krahas kësaj, UNMIK-ku i ka hapur zyret ndërlidhëse të gjykatave nëpër enklavat e pakicave me qëllim të lehtësimit të qasjes fizike në gjykata. Për shembull, dega e Gjykatës Komunale të Prishtinës/Priştina është hapur në Graçanicë/Gračanica; zyret ndërlidhëse të gjykatave janë hapur në Novobërdë/Novo Brdo, Gorazhdevc/Goraždevac, Vërbovc/Verbovac, Hoçë të Madhe/Velika Hoča, Priluzhë/Priluzje, Shillovë/Šilovo, Osojan/Osojane, Novak/Novake, dhe Mitrovicë/Mitrovica.

Autoritetet duhet të vazhdojnë me këto përpjekje me qëllim të angazhimit afatgjatë të gjyqësorit multietnik në Kosovë.

³⁷ Raporti i OSBE-së: “Trajtimi i pakicave nga sistemi gjyqësor”, f. 6.

³⁸ Raporti tematik i OSBE-së mbi “Administrimin e drejtësisë”(Mars 2002), f. 20.

³⁹ Raporti tematik i OSBE-së mbi “Administrimin e drejtësisë”(Mars 2002), f.8.

⁴⁰ Raporti javor i UNMIK-ut DD (20-27 Dhjetor 2005).

c. *Pajisjet e përkthimit*

Pas Rregullores së UNMIK-ut 2000/46,⁴¹ me të cilën gjuha angleze bëhet gjuhë zyrtare e gjykatës në procedurën e cila zhvillohet me pjesëmarrjen e gjyqtarëve ose prokurorëve ndërkombëtarë, gjykimet shpesh kryheshin në shqip, serbisht dhe anglisht. Gjykimet që zhvilloheshin pa përdorimin e pajisjeve për përkthim simultan ishin tepër të gjata. Prandaj, në mars të vitit 2002, OSBE ka rekomanduar që:

“Me qëllim të shkurtimit të vonesave, urgjentisht duhet të instalohen pajisjet për përkthim simultan nëpër gjykatat në të cilat i kryejnë detyrat e veta gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë”⁴².

Sot, të gjitha sallat e gjykimit nëpër rajone, përveç Gjykatës së Qarkut të Pejës/Peć, janë pajisur me pajisjet për përkthim simultan. Vonesat për shkaqe të përkthimit tanimë janë reduktuar në masë të konsiderueshme.

d. *Shpërndarja e vendimeve të Gjykatës Supreme*

Në dhjetor 2004, OSBE ka bërë me dije se në shumë raste arsyetimet e vendimeve të gjykatave mbi dënimin nuk bëhen në përputhje me dispozitat ligjore⁴³. Aktgjykimeve ju mungojnë vlerësimet e hollësishme dhe të individualizuara për rrethanat e rëndësishme në lidhje me veprën penale dhe kryerësin, ose ju mungon vlerësimi i duhur i rrethanave lehtësuese dhe rënduese. OSBE ka nxitur Gjykatën Supreme të jetë më e guximshme në vendimet e veta të ankesës dhe ka rekomanduar që Gjykata Supreme të:

“Udhëzoj gjykatat më të ulëta që aktgjykimet dhe vendimet mbi caktimin e dënimit të përmbajnë arsyetim të detajuar dhe të individualizuar”⁴⁴.

Mirëpo, për të pasur efekt edhe përtej rastit konkret, të gjithë avokatët dhe gjyqtarët do duhej të kishin qasje më të lehtë në vendimet e Gjykatës Supreme Në vitet 2002 dhe 2003, Qendra Ligjore e

⁴¹ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/46 për përdorimin e gjuhëve në gjykimet në të cilat marrin pjesë gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë, e shpallur në fuqi më 15 gusht 2000.

⁴² Raporti tematik i OSBE-së mbi “Administrimin e drejtësisë”, f. 18.

⁴³ “Shqyrtimi i gjashtë” f. 46.

⁴⁴ “Shqyrtimi i gjashtë” f. 62.

Kosovës në bashkëpunim me Fondacionin Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), publikoi dy vëllimet e para të aktgjyqimeve së Gjykatës Supreme të Kosovës. Ky proces i publikimit kërkohej të jetë i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm. Prandaj, OSBE më tutje ka rekomanduar që:

“Departamenti i administratës gjyqësore të sigurojë që të gjitha aktgjykimet e Gjykatës Supreme të publikohen dhe të jenë të qasshme për gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve”⁴⁵.

Është trimëruar fakti se në bazë të “Marrëveshjes së mirëkuptimit” të nënshkruar ndërmjet Qendrës juridike të Kosovës dhe Gjykatës Supreme, me datë 20 korrik 2005, mëtohet publikimi i “Buletinit” të Gjykatës Supreme. Në të duhet të përfshihen të gjitha qëndrimet dhe vendimet e Gjykatës Supreme që nga 6 prilli 2004, e deri më sot⁴⁶. Vëllim i parë pritet të publikohet në çerekun e dytë të vitit 2006 dhe do t’i shpërndahet gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve mbrojtës. Ky projekt financohet nga Zyra e SHB-ve.

Publikimi dhe shpërndarja e vendimeve të Gjykatës Supreme në gjykatat më të ulëta duhet të shndërrohet në praktikë të rregullt.

III. ZHVILLIMET LEGJISLATIVE

i. Qarkoret e drejtësisë

Qarkoret e drejtësisë i lëshon drejtori i DD-së; ato janë dokumente formale, udhëzime të brendshme për organet gjyqësore. Edhe pse gjykatat dhe prokuroritë nuk i obligohen gjithherë këtyre udhëzimeve, qarkoret gjyqësore janë shfrytëzuar rregullisht nga DD si mënyrë e përshtatshme për të ndikuar në praktikën ekzistuese. Është e kuptueshme se për çështje administrative DD është përpjekur t’i largohet përdorimit të një opsioni më të ngadaltë pra, të shfrytëzimit të urdhëresës administrative⁴⁷. Por, DD duhet të ketë kujdes dhe mos t’i uzurpojë autorizimet e organit ligjvënës dhe Gjykatës Supreme duke lëshuar qarkore gjyqësore me të cilat rregullohet ose interpretohet

⁴⁵ “Shqyrtimi i gjashtë” f. 62.

⁴⁶ Vëllimi i parë është në proces të përfundimit dhe përmban 141 aktgjyqime të Gjykatës Supreme të shpallura gjatë periudhës prej 6 prillit 2004 deri në 6 prill 2005.

⁴⁷ Urdhëresat administrative duhet të lëshohen nga PSSP.

ligji⁴⁸. DD ka lëshuar një numër qarkoresh gjyqësore me qëllim të adresimit të shqetësimeve të ngritura nga OSBE, për shembull:

a. Vendimet mbi paraburgimin

Që nga fillim i programit të vetë monitorues, OSBE ka vërejtur se shumë, nëse jo të gjitha, vendimet mbi paraburgimin ishin sipërfaqësore dhe joadekuate. Prandaj në korrik të vitit 2000, OSBE kishte rekomanduar:

“[Q]ë PSSP ta rishikojë ligjin në fuqi në lidhje me shqyrtimin e vendimeve mbi paraburgimin, ashtu që, në mes tjerash, vendimi të ketë edhe pjesën e arsyetimit dhe bazat për vendimin mbi zgjatjen e paraburgimit”⁴⁹.

Në përgjigje të kësaj, DAD (pararendësi i DD-së) më 19 dhjetor 2000, pati lëshuar qarkoren e drejtësisë nr. 2000/27, me të cilën i përkujton të gjithë gjyqtarët se të gjitha vendimet mbi paraburgimin duhet të merren të gjitha mbi bazën e një vendim të shkruar dhe plotësisht të arsyetuar. Fatkeqësisht, kjo qarkore ka pasur shumë pak efekt – në dhjetor të vitit 2004 OSBE ka publikuar një raport tjetër përbajtësor me të cilin shfaqen të njëjtat shqetësime të cilat e dëmtojnë sistemin e drejtësisë penale në të gjitha nivelet e gjykatave⁵⁰.

b. Masat e sigurimit për personat e sëmurë mental

Në tetor të vitit 2001, OSBE ka theksuar se problemet lidhur me trajtimin e të sëmurëve mental në kuadër të sistemit të drejtësisë penale. “Masat e sigurimit” janë shfrytëzuar që të mbahen në paraburgim personat e sëmurë mental, të cilëve ju nevojitet ndihma mjekësore por të cilët nuk janë akuzuar për asnjë vepër penale⁵¹. OSBE ka rekomanduar që:

⁴⁸ Kjo është bërë së paku në një rast. Për shembull, më 19 mars 2003, DAD ka lëshuar qarkoren e drejtësisë nr. 2003/1 mbi vlefshmërinë e patentave për shoferë të lëshuara nga autoritetet e Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ), me të cilën udhëzohen autoritetet e prokurorisë dhe gjykatave se si të veprojnë në rastet e patentave për shoferë të lëshuara ose të vazhduara nga autoritetet e RFJ-së, duke iu kërcënuar gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët nuk veprojnë në pajtim me këtë qarkore se do të paraqiten në Njësinë e inspektimit gjyqësore dhe se do t’i nënshtrohen masave disiplinore të cilat mund të rezultojnë edhe me shkarkim.

⁴⁹ “Shqyrtim i parë” f. 42.

⁵⁰ “Shqyrtimi i gjashtë”.

⁵¹ “Shqyrtim i tretë” f. 42.

“DAD duhet të lëshojë qarkoren mbi zbatimin e Ligjit të procedurës jo-kontestimore lidhur me paraburgimin e personave të sëmurë mental dhe për të konfirmuar se ndihma juridike do të ofrohen për të gjitha rastet”⁵².

Pas këtij rekomandimi, DAD pati lëshuar qarkoren e drejtësisë nr. 2001/20 mbi zbatimin e Ligjit për paraburgimin e personave në Institucionin e neuropsikiatrisë (Ligji mbi procedurën jo-kontestimore, 1986 nenet 45-55). Në këtë qarkore thuhet se të gjitha seancat për këtë çështje duhet të mbahen në gjykatat komunale, para kolegjit prej së paku tre gjyqtarëve dhe paraqet përcaktohen kushtet sipas të cilave mund të caktohet paraburgimi dhe kohëzgjatja e tij.

c. *Programi për mbrojtjen e dëshmitarëve*

Mbrojtja e dëshmitarëve nga kërcënimet ose frikësimet ka qenë dhe mbetet njëra nga sfidat më të mëdha për autoritetet gjyqësore të Kosovës⁵³. Hulumtimi i kryer nga OSBE tregon se aktorët e gjyqësisë nuk dinin për këto mjetet në disponim për mbrojtjen e dëshmitarëve, e veçanërisht për Njësinë për mbrojtjen e dëshmitarëve (NJMD), e cila është pjesë e strukturës operative të UNMIK-ut. Përshtatshëmrisht, OSBE rekomandon që:

“DAD të lëshojë një qarkore të drejtësisë për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët me të cilën përcaktohet roli i NJMD-së dhe të sigurohen objektet dhe lehtësirat të cilat i vihen në disponim programit për mbrojtjen e dëshmitarëve”⁵⁴.

DAD ka lëshuar me kohë qarkoren e drejtësisë 2003/5 mbi programet për mbrojtjen e dëshmitarëve, me të cilën sqarohet procedura të cilën duhet ndjekur NJMD në lidhje me programin për mbrojtjen e dëshmitarëve. Qarkorja i përshkruan detyrat dhe obligimet e NJMD dhe parashikon që NJMD mundet që me kërkesën e prokurorit ose gjyqtarit të parashikojë edhe masa alternative për hyrjen në program. Përmes qarkores DD ka përcaktuar marrëdhënien e strukturuar dhe të bashkërenditur midis NJMD-së, prokurorëve dhe gjykatave. Megjithatë, përkundër këtyre përpjekjeve, mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare dhe vështirësitë për zhvendosjen e dëshmitarëve në vendet e treta, në mënyrë të vazhdueshme e pengojnë zbatimin e plotë të programit.

⁵² “Shqyrtim i tretë” f. 46.

⁵³ Shqyrtimi i pestë i OSBE-së për sistemin e drejtësisë penale: “Mbrojtja e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale”, “Shqyrtimi i pestë”.

⁵⁴ “Shqyrtimi i pestë”, f. 26.

ii. Ligjet

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1 mbi autorizimet e administratës së përkohshme në Kosovë, duke iu referuar Rezolutës 1244, i japë PSSP-së fuqinë e nxjerrjes së ligjeve. Gjatë monitorimit të kryer nga OSBE-ja, janë vërejtur raste kur është parë e nevojshme nxjerrja e ligjeve të reja ose ndryshimit të atyre ekzistuese me qëllim të sigurimit të përputhjes së legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Prandaj, OSBE ka rekomanduar disa ndryshime ligjore. Autoritetet i janë përgjigjur pozitivisht një numër rekomandimesh të tilla. Më tutje në tekst janë shqyrtuar dy prej dispozitave më të rëndësishme.

a. Zbatimi i instrumenteve për të drejtat e njeriut

Menjëherë pas përfundimit të armiqësive gjatë verës së vitit 1999, ekzistonte nevoja për sqarimin e ligjit në fuqi. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24, e shpallur më 12 dhjetor 1999, ka paraparë katër burime të mundshme juridike për ligjin në fuqi në Kosovë:

- i. Ligji në fuqi në Kosovë siq ekzistonte më 22 mars 1989;
- ii. Rregulloret e UNMIK-ut dhe aktet nënligjore të tyre;
- iii. Ligji në fuqi në Kosovë, ndërmjet 22 marsit 1989 dhe 12 dhjetorit 1999 (data e hyrjes në fuqi të Rregullores 1999/24) për dispozitat që janë më të favorshme për të pandehurit nëse e plotëson boshllëkun ku nuk ka ekzistuar asnjë ligj nga marsi i vitit 1989 dhe nëse është jodiskriminues;
- iv. Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të reflektuara në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Rregulloret kishin përparësi zbatimi ndaj legjislacionit të vitit 1989, por hierarkia në mes të burimeve tjera juridike nuk ishte qartësuar dhe në veçanti, nuk është theksuar në mënyrë të shprehur përparësia e legjislacionit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut ndaj ligjeve vendore. Në korrik të vitit 2000, OSBE ka rekomanduar që:

“PSSP-ja të lëshojë një urdhëresë administrative me të cilën vërtetohet se:

- i. Legjislacioni ndërkombëtar për të drejtat e njeriut është suprem ndaj të gjitha ligjeve tjera;
- ii. Gjyqtarët dhe prokurorët publik janë të obliguar të mos i zbatojnë dispozitat e LPP të RFJ-së⁵⁵ të cilat janë në kundërshtim me këto standarde;
- iii. Në harmoni me këto obligime, gjyqtarët dhe prokurorët publik duhet t'i shfrytëzojnë standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për zgjidhjen e çështjeve të cilat nuk trajtohen përmes LPP të RFJ-së⁵⁶.

Nuk është lëshuar asnjëherë një urdhëresë administrative e kësaj natyre. Mirëpo, kjo çështje shqetësuese është trajtuar përmes Kornizës Kushtetuese e cila ka hyrë në fuqi më 15 maj 2001⁵⁷. Neni 3.1 thotë se “të gjithë personat në Kosovë gëzojnë, pa diskriminim të asnjë lloji dhe në barazi të plotë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, dhe se dispozitat për të drejtat dhe liritë e parashtruara në këto instrumente aplikohen drejtpërsëdrejti në Kosovë⁵⁸. Rrjedhimisht, është bërë e qartë se çdo institucion, organ administrativ, organizatë ose “prani” lokale ose ndërkombëtare në Kosovë, është i obliguar të respektojë dispozitat e legjislacionit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

b. Kodi i përkohshëm penal dhe i procedurës penale

Rregullorja 1999/24 për ligjin në fuqi në Kosovë ka shërbyer si një shpjegues i dobishëm i një varg çështjesh, por nuk e ka tharë tërësisht moçalin juridik. Në korrik të vitit 2000 OSBE ka theksuar se, me gjithë se legjislacioni ekzistues penal i Kosovës në përgjithësi është në përputhje me standardet ndërkombëtare, prapë shumë prej dispozitave të tij nuk janë⁵⁹. Me qëllim të sqarimit të plotë të ligjit dhe përafrimit të tij me standardet evropiane, UNMIK-u kishte vendosur ta hartojë një ligj tërësisht të ri penal. Ky proces kishte filluar në vitin 2000. Në nëntor të vitit 2001, Këshilli i përbashkët konsultativ për çështje legjislative, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, i kishte finalizuar draftet e të dy kodeve. Procesi kishte përfutuar edhe nga kontributi i OSBE-së, UNICEF-it, Odës së

⁵⁵ Ligji i procedurës penale i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

⁵⁶ Për shembull, nenet të cilat duket se janë në kundërshtim me KEDNJ-në, janë neni 74 i LPP RFJ, i cili i lejonte gjyqtarit hetues të ndërhyjë në komunikimin e të pandehurit me avokatin e vet, neni i 152 LPP RFJ i cili i lejonte policisë të paraburgosë dëshmitarët e vendit të ngjarjes deri në gjashtë orë deri në arritjen e gjyqtarit hetues. Ky nen ishte në kundërshtim me KEDNJ nga se paraburgimi për shkak të sjelljes para gjyqtarit hetues të dëshmitarit nuk është vetvetiu arsye e vlefshme për mbajtjen në paraburgim sipas KEDNJ neni 5(1). Shih “Raporti i parë”, f. 18.

⁵⁷ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 për Kornizën Kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë.

⁵⁸ Shih Kornizën Kushtetuese, 3.3 “Dispozitat mbi të drejtat dhe liritë e parapara me këto instrumente janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë [...]”

⁵⁹ “Shqyrtim i parë” f. 17.

avokatëve amerikanë, Iniciativa ligjore për Evropën Qendrore dhe Euro-Aziate (ABA CEELI), dhe profesionistët dhe akademikët e Kosovës në fushën e drejtësisë.

Por, procesi i finalizimit ishte i ngadalshëm. Shkeljet e të drejtave të njeriut, siç janë pamundësia për kundërshtimin e ligjshmërisë së paraburgimit gjatë secilës fazë të procedurës, ka vazhduar të vërehet edhe më tutje, gjë që nëse të dy kodet do të kishin hyrë në fuqi, kjo nuk do të kishte mundur të ndodh. Në shtator të vitit 2001, OSBE ka rekomanduar që, “menjëherë të hyjnë në fuqi Kodi penal dhe Kodi i procedurës penale”⁶⁰. Përfundimisht, në fillim të vitit 2003, të dy kodet i janë dërguar Zyrës së Kryeministrit nga UNMIK-u për shqyrtim si nga Qeveria ashtu edhe nga Kuvendi i Kosovës, dhe më 7 maj 2003 Komisioni për çështje juridike, legislative dhe Kornizë Kushtetuese i ka shqyrtuar kodet penale dhe i ka paraqitur rekomandimet e veta para Kuvendit të Kosovës⁶¹. Të dy kodet kanë hyrë në fuqi më 6 prill 2004.

IV. ZHVILLIMET NË PRAKTIKË

i. Gjykatat

OSBE ka ngritur çështje edhe lidhur me praktikën gjyqësore të cilës i kanë munguar standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Përkundër shqetësimeve të vazhdueshme (shih kreun IV), megjithatë ka pasur zhvillime inkurajuese në gjykatat e Kosovës. Këto mund të maten duke i krahasuar me shkeljet e të drejtave të njeriut të vrojtuar në vitin 1999/2000 me ato të vitit 2005. Këto përmirësime janë bërë për shkak të angazhimeve në ndërtimin e kapaciteteve siç kanë qenë trajnimet dhe punëtoritë, ndryshimet substanciale të ligjit në fuqi, si dhe angazhimet brenda gjykatave nga vetë gjyqtarët. Shembujt e kësaj janë paraqitur më poshtë:

a. Trajtimi i pakicave në sistemin gjyqësor

Paanshmëria gjyqësore është pjesë jetike e secilit sistem gjyqësor. Në periudhën pas konfliktit në Kosovë, kjo ka qenë çështje posaçërisht akute. Në korrik të vitit 2000, OSBE kishte vërejtur:

“Klima e gjatë dhe e vazhdueshme e konfliktit etnik ka ndikuar rëndë në paanshmërinë objektive të gjykatave dhe ngritë shqetësimet lidhur me objektivitetin e kolegjeve të

⁶⁰ Shqyrtimi i katërt i sistemit të drejtësisë penale shtator 2001-shkurt 2002) më tutje në tekst: “Shqyrtimi i katërt”, f. 58.

⁶¹ “Shqyrtim i pestë”, f. 53.

caktuara gjyqësore. Reagimi i disa autoriteteve relevante ka qenë reaktiv dhe *ad hoc* – duke rezultuar në trajtim jo të barabartë të të pandehurve para gjykatave dhe mohim të mundësive të duhura për përgatitjen dhe paraqitjen adekuate të mbrojtjes⁶².

Këto shqetësime janë trajtuar pjesërisht nga UNMIK-u përmes programit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë (shih pjesën e poshtme). Por, kjo vetvetiu nuk i ka shuar të gjitha shqetësimet lidhur me paanshmërinë në radhët e gjyqtarëve vendës. OSBE ka monitoruar për së afërmi rastet ku pakicat etnike ishin të përfshira. Në mes të vitit 2001 dhe 2005 OSBE ka vërejtur se nuk kishte pasur raportime nga monitoruesit e gjykatave nga të cilat do të shihej se nga rastet e monitoruara ka ndonjë dyshim mbi njëanshmërinë e trupave gjykues⁶³. Këto janë shenja inkurajuese. Nga janari deri në dhjetor të vitit 2005, OSBE ka monitoruar 81 raste ku pakicat etnike ishin të përfshira dhe nuk është raportuar asnjë rast i njëanshmërisë etnike në rastet e monitoruara⁶⁴. Njësia e inspektimit gjyqësor e DD-së nuk i'a ka përcjellë asnjë rast KGPK-së lidhur me ndonjë pretendim për rast të njëanshmërisë etnike kundër ndonjë gjyqtari⁶⁵. Gjithashtu, duhet të merret parasysh se shumë prej rasteve të profilit më të lartë me elementin ndëretnik ende shqyrtohen nga gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë. OSBE-ja konsideron se prezenca e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar në sistemin ligjor të Kosovës edhe më tej është shumë i nevojshëm për shkak të “[...] pranisë së vazhdueshme të kanosjes së sigurisë që do të mund t’a sfidoj pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit dhe të pengoj aftësinë e gjyqësorit që në mënyrë të duhur të bëjë ndjekjen penale të krimeve të cilat në masë të madhe e dëmtojnë procesin e paqës dhe themelimin e plotë të sundimit të ligjit në Kosovë.”⁶⁶

b. Viktimat e sulmit seksual

Në vitin 2000, SMSJ ka monitoruar rastet penale të cilat kanë të bëjnë me veprat penale kundër grave, veçanërisht veprat penale të natyrës seksuale. Janë vërejtur në mënyrë shqetësuese qëndrimet joprofessionale të policisë, prokurorisë dhe gjyqësisë përkritazi me viktimat, gjë që është në

⁶² “Shqyrtimi i parë” f. 58.

⁶³ Njësia e inspektimit gjyqësor e ka informuar OSBE-në se nuk kishte pasur raste të ankesave për njëanshmëri etnike gjatë vitit 2005.

⁶⁴ Në Prishtinë/Priština ishin monitoruar 11 raste me përfshirje të pakicave, në Pejë/Peć ishin monitoruar katër raste, në Gjiilan/Gnjilane tetë raste, në Prizren nëntë raste dhe në Mitrovicë/Mitrovica ishin monitoruar 49 syresh.

⁶⁵ Informata e marrë nga NJIGJ më 22 dhjetor 2005.

⁶⁶ Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/50 që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/64, siq është ndryshuar, mbi Caktimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Ndërkombëtar dhe/apo Ndërrimin e Vendit, të miratuar me 12 Dhjetor 2005

kundërshtim me standardet ndërkombëtare⁶⁷. Për shembull, në një numër rastesh kryetari i kolegjit ka bërë pyetje joadekuate, është dukur të jetë i anshëm kundër viktimës dhe nuk ka shfaqur konsiderata lidhur me jetën private të viktimës. Prokurorët bënin shumë pak për ta parandaluar ngacmimin e viktimës dhe avokatët e tyre ishin rrallë herë të pranishëm⁶⁸. Problemi ishte veçanërisht i mprehtë në relacion me viktimat të moshës së mitur. Në korrik të vitit 2000, OSBE ka rekomanduar që:

“IGJK të ofrojë trajnime plotësuese për gjyqtarë, prokurorë publik dhe avokatë mbrojtës si dhe për organet e zbatimit të ligjit, mbi trajtimin e dhur dhe marrjen në pyetje të viktimave/dëshmitarëve në rastet e dhunës seksuale”⁶⁹.

Aftësia e gjyqtarëve dhe prokurorëve për t’i trajtuar me ndjeshmëri dhe maturi rastet e dhunës seksuale është rritur me vendosmëri. Gjatë vitit 2005, OSBE ka vërejtur vetëm pak raste në të cilat gjykatat kanë dështuar të sillen në mënyrë të përshtatshme⁷⁰. Problemet e izoluara janë vërejtur, por nuk janë më sistematike. Për më tepër, përmes Ligjit penal për të mitur tani parashikohen masa plotësuese mbrojtëse për të miturit, the tani të gjitha rastet me viktimat e mitur të veprave penale seksuale, shqyrtohen nga kolegjet për të mitur⁷¹.

c. *Qasja në avokatin mbrojtës*

Legjislacioni ndërkombëtar për të drejtat e njeriut parashikon të drejtën e qasjes në avokatë mbrojtës për të dyshuarit dhe të pandehurit. Është fundamentale që gjykatat t’i mbrojnë këto të drejta. Mirëpo, në vitin 2000, OSBE kishte identifikuar një numër shkeljes të kësaj të drejte dhe ka

⁶⁷ Neni 4 (c) i *Deklaratës së KB-ve mbi eliminimin e dhunës kundër grave*, parashikon obligimin pozitiv për organet shtetërore të “kenë kujdes të posaçëm për parandalimin, hetimin dhe në pajtim me legjislacionin vendor, të dënojë aktet e dhunës kundër grave, çoftë kur këto akte kryhen nga shteti ose nga personi privat”.

⁶⁸ “Shqyrtim i parë”, f. 79-86.

⁶⁹ “Shqyrtim i parë”, f. 37.

⁷⁰ Raporti mujor i HR/RoL departamentit të OSBE-së, shkurt 2005.

⁷¹ Shpallur në fuqi përmes Rregullores së UNMIK-ut 2004/8 Ligji penal për të mitur (LPM), me datë 20 prill 2004. Neni 141 i ligjit për të mitur parashikon që kolegji gjyqësor për të mitur dhe gjyqtari për të mitur do t’i gjykojë personat madhor për veprat penale të caktuara të cilat kryhen ndaj fëmijëve. Kjo dispozitë ka hyrë në fuqi me qëllim që të miturve që kanë qenë viktimat të verave të caktuara penale t’ju sigurohet një lloj i mbrojtjes speciale nga ana e sistemit penal në pajtim me standardet ndërkombëtare të aplikueshme.

vërejtur se, “në shumë raste gjykatat kanë dështuar të ofrojnë përfaqësimi ligjor, përkundër faktit se të pandehurit ballafaqoheshin me mundësinë e dënimit me burg”⁷². Ky dështim mbizotëronte në rastet kur akuzoheshin gratë e huaja për prostitucion, shumë prej të cilave pretendonin se ishin viktima të trafikimit. Në vitin 2000, OSBE kishte intervistuar të paraburgosurit anekënd Kosovës dhe kishte konstatuar se asnjëri nuk i ishte dhënë e drejta e qasjes në avokatin mbrojtës para se kryerjes së seancës së parë të dëgjimit⁷³. OSBE kishte rekomanduar që:

“Gjykatat duhet të sigurojnë që seancat dëgjimore të paraburgimit të jenë efikase dhe që i paraburgosuri të ketë qasje në një gjyq për ankesa që në mënyrë të duhur t’u sfidoj çdo urdhër për vazhdim të paraburgimit”.

Monitorimi i praktikave aktuale tregon se gjykatat shprehimisht kanë përparuar. Tani shumë rrallë mund të vërehet që gjykata mos t’i mundësojë të pandehurit të drejtën për të pasur qasje në avokat mbrojtës, respektivisht të ketë qasje në gjyq për ankesa në mënyrë që t’i sfidojë urdhëresat për paraburgim.

ii. Paraburgimet jashtë-gjyqësore

a. Paraburgimet me vendim ekzekutiv të PSSP

Në mesin e vitit 1999, PSSP filloi të shfrytëzojë autoritetin e tij ekzekutiv për të urdhëruar paraburgimet jashtë-gjyqësore. PSSP kishte urdhëruar paraburgimin e personave për të cilët ai kishte dyshuar se kishin kryer vepra penale dhe identiteti i të cilëve nuk kishte mundur të vërtetohet, të cilët do të mund të iknin, të shkatërrojnë dëshmitë, pengojnë hetimet, ose kur vepra penale do të përsëritej prapë. Shumica e këtyre të arrestuarve sipas urdhrit ekzekutiv tanimë ishin paraburgosur nga gjykatat (përfshirë këtu edhe nga gjyqtarët ndërkombëtar). PSSP, në vitet 2000 dhe 2001 kishte urdhëruar paraburgimin në gjashtë raste. OSBE-ja kishte konsideruar se këto paraburgime jashtë-gjyqësore ishin të paligjshme; nuk kishte pasur asnjë bazë ligjore për të marrë këto vendime dhe se nuk kishte pasur asnjë mjet në dispozicion për shqyrtim gjyqësor.⁷⁴ Veç kësaj, urdhrat ekzekutiv

⁷² “Shqyrtim i parë”, f. 17. Gjithashtu shih raportin e SMSJ-së nr. 7: Qasja në mbrojtje efektive, faza e parë: arrestimi për seancën e parë për vendosje mbi paraburgimin, 23 maj 2000.

⁷³ Shih raportin e SMSJ-së nr. 7: Qasja në mbrojtje efektive, faza e parë: arrestimi për seancën e parë për vendosje mbi paraburgimin, 23 maj 2000.

⁷⁴ Nenet 9 dhe 14 të PNDPCP dhe neni 5 dhe 6 të KEDNJ, parasheh kornizën e mbrojtjes së personave që janë pre e arrestimit të çfarëdo lloji ose paraburgimi. Neni 9 (1) citon: “Secili ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë së

ishin llogaritur të kenë bërë ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësisë. Në prill të vitit 2001, OSBE-ja kishte deklaruar:

“Është aspekt fundamental i ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut se një person i privuar nga liria të ketë mundësi të sfidojë ligjshmërinë e paraburgimit të tij/saj. Shqyrtimi gjyqësor i paraburgimeve ekzekutive do të sigurojë se ato nuk janë arbitrare.”⁷⁵

Në një përpjekje për rregullimin e çështjes së paraburgimit, më 25 gusht 2001, UNMIK-u kishte miratuar/nxjerrë Rregulloren 2001/18 mbi themelimin e Komisionit për shqyrtimin e paraburgimeve jashtëgjyqësore të bazuara në urdhra ekzekutiv. Rregullorja parashikon mekanizmat e shqyrtimit të paraburgimeve të urdhëruara nga PSSP. Megjithatë, siç kishte vërejtur OSBE-ja, Komisioni për shqyrtimin e paraburgimeve kishte qenë plotësisht jo adekuat për shkak të mungesës së pavarësisë së tij.⁷⁶ Ishin bërë edhe më shumë. Në raportin e saj të madh vijues të tetorit 2001, OSBE kishte rekomanduar që:

“[P]raktika e paraburgimeve jashtëgjyqësore mundet të zëvendësohet lehtë me inicimin e një sistemi-mekanizmi i cili lejon që të bëhet dëgjimi i dëshmimeve të ndjeshme brenda vet sistemit të drejtësisë penale, dhe njëkohësisht duke respektuar të drejtat e të pandehurit për ta sfiduar paraburgimin.”

Në vitin 2001, DD kishte implementuar një iniciativë ku njëri prej personelit të Departamentit, i cili kishte arritur që të merrte leje sigurie, kishte shqyrtuar materialin e ndjeshëm ose materialin sekret. Megjithatë, PSSP-të e ardhshëm kishin ngurruar që zyrtarisht të heqin dorë nga përdorimi i paraburgimeve jashtëgjyqësore dhe kishin lënë mundësinë që t’a përdorin këtë mekanizëm në të ardhmen. Pa marrë parasysh këtë të dhënë të sipërpërmendur, praktika e tanishme e paraburgimeve

personit të tij. Askush nuk duhet të jetë objekt i një arrestimi ose burgimi arbitrar. Askush nuk duhet të privohet nga liria, përveç për arsye dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj. Neni 5 (1) i KEDNJ. E drejta për të pasur të drejtë të sfidohet çdo paraburgim para një trupi gjykues me autorizim që të urdhërojë ose të lirojë (*habeas corpus*) është e drejtë fundamentale dhe është parim i patjetërsueshëm i ligjit ndërkombëtar, të zbatueshme edhe në gjendjen e jashtëzakonshme. Shih Shqyrtimin e tretë të OSBE-së të sistemit të gjyqësisë penal (tetor 2001), më tej: Shqyrtimi i tretë, faqe 34.

⁷⁵ Shqyrtimi i dytë, faqe 17.

⁷⁶ Komisioni i themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/18 kishte qenë një organi ad-hoc i gjyqësisë, jashtë sistemit gjyqësor, anëtarët e të cilit ishin zgjedhur dhe të emëruar nga ana e PSSP-së. Kështu, nuk kishte mundësi që ai të quhet tribunal sipas 6 të KEDNJ dhe parimit 5 të parimeve themelore të pavarësisë së pavarësisë e qartë mbi ekzekutivin diskualifikon atë organ të jetë i pavarur (shih *Findlay kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykate evropiane për të drejtat e njeriut, Gjykimi i 25 shkurtit 1997, para 73). Komisioni thjesht kishte uzurpuar juridiksionin e gjykatave të; nuk kishte ofruar një “shqyrtim të pavarur gjyqësor” të paraburgimeve, siç kërkohet me ligjin ndërkombëtar. Shqyrtimi i tretë, fq. 34.

jashtëgjyqësore nuk aplikohet. PSSP nuk kishte urdhëruar paraburgimet jashtëgjyqësore që nga data 19 dhjetor 2001.

b. Paraburgimet jashtëgjyqësore nga KFOR-i

Sipas Rezolutës së KSKB 1244, KFOR-i ka përgjegjësi për “sigurinë dhe rendin publik.” Prej vitit 1999, KFOR-i kishte paraburgosur personat të cilët i kishte konsideruar të jenë kërcënim “për mjedisin e sigurt” (nganjëherë e kishte bërë këtë pa urdhër të ligjshëm të lëshuar nga gjyqtari).⁷⁷ Personat ishin paraburgosur në bazën ushtarake të SHBA-së në Kampin Bondstill. Numri i përgjithshëm i të paraburgosurve nga ana e KFOR-it ishte rreth 3600 persona. Dhe gati në të gjitha rastet, OSBE-ja kishte konsideruar se këto paraburgime jashtëgjyqësore kishin qenë të paligjshme dhe të padrejta, pasi që sistemi i rregullt gjyqësor kishte pasur kapacitet të merret me këto raste.⁷⁸ Në korrik të vitit 2000 OSBE kishte rekomanduar që:

“Urdhri i COMKFOR-it për paraburgim duhet të ndërpritet deri në atë kohë sa ato mund të shqyrtohen në mënyrë të përshtatshme nga gjykata.”⁷⁹

Që nga atëherë janë bërë një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve për të njëjtën gjë.⁸⁰ Megjithatë, KFOR kishte vazhduar të argumentojë se paraburgimet jashtëgjyqësore kishin qenë të arsyeshme dhe relativisht deri në kohët e fundit kishte vazhduar ende të paraburgosë persona.⁸¹

Tani kjo praktikë duket se është ndërprerë. Me përjashtim të paraburgimeve të arsyeshme që ishin bërë gjatë trazirave të marsit 2004, tani për tani OSBE nuk ka dijeni se është bërë ndonjë paraburgim i paligjshëm nga ana e KFOR-it.

c. Mekanizmi habeas corpus

⁷⁷ Letra e dërguar nga KFOR-I në adresë të shefit të Misionit të OSBE-së në Kosovë, 6 shtator 2001.

⁷⁸ Dy brenga kryesore janë mungesa e bazave të qarta ligjore për paraburgim që janë në përputhje me ligjin ndërkombëtar, si dhe mungesa e shqyrtimit gjyqësor të paraburgimeve. Megjithatë, OSBE kishte konsideruar se një numër i kufizuar i paraburgimeve gjatë trazirave të marsit 2000 kishin qenë të arsyeshme në ato rrethana (KFOR-i kishte paraburgosur demonstruesit për një kohë të caktuar kohore para se ata t’i dorëzojnë ata në autoritetet e rregullta gjyqësore).

⁷⁹ Shqyrtimi i parë, faqe 42.

⁸⁰ Shqyrtimi i katërt, faqe 45, Shqyrtimi i katërt, faqe 51, Shqyrtimi i pestë, faqe 34.

⁸¹ Sipas KFOR-it, e drejta e tyre për të paraburgosur persona ishte dhënë me Rezolutën 1244, që i kishte dhënë mandat KFOR-it të “ruaj sigurinë dhe rendin publik për një kohë derisa prezenca civile ndërkombëtare mund ta merr përgjegjësinë për këtë detyrë.” (Para. 9(d)). KFOR-i kishte argumentuar se policia civile dhe sistemi gjyqësor nuk mund t’ia dalin me sigurinë dhe rendin publik..

Mungesa e mekanizmit për *habeas corpus* ka qenë një boshllëk serioz për mbrojtjen ligjore të paraburgosurve, në veçanti ata të paraburgosur në mënyrë joligjore me urdhër ekzekutiv të KFOR-it të cilët nuk kanë pasur mbështetje nga gjykatat. Në korrik të vitit 2000, OSBE-ja kishte rekomanduar që:

“[...]UNMIK-u të themelojë një mekanizëm të përshtatshëm nëpërmjet të cilit të gjithë personat e paraburgosur në Kosovë mund të sfidojnë ligjshmërinë e arrestimit dhe paraburgimit të tyre në çdo kohë.”⁸²

Katër vite pas këtij rekomandimi, më në fund ishte paraqitur mekanizmi *habeas corpus* me legjislacionin e ri penal. Në nenin 286 paragrafi 2 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (KPPP), është e paraparë se në çdo kohë i paraburgosuri ose avokati i tij/saj mund të parashetrojë ankesë para çdo gjyqtar të procedurës paraprake ose kryetari të trupit gjykues, në mënyrë që të përcaktohet ligjshmëria e paraburgimit. Ky ishte zhvillim i mirëpritur edhe pse i vonshëm.

iii. Mbrojtësit

Avokati mbrojtës luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në çdo sistem ligjor. Në periudhën pas konfliktit, vendet në tranzicion siç është Kosova, një gjë e tillë është në veçanti e rëndësishme. Por ndikimi i avokatit mund të shtrihet edhe përtej mbrojtjes së të drejtave të njeriut në rastet individuale-prezantimi i mirë i argumenteve nga avokati i shtyn gjyqtarët dhe prokurorët që t’i ngrisin standardet e tyre në përgjithësi. Kjo në veçanti është e vërtetë sa i përket zbardhjes së përgjegjësisë shtesë të avokatit sipas KPPPK.⁸³ Kështu, nga perspektiva e të drejtave të njeriut, avokati mbrojtës ka potencial të luaj rolin kyç në zhvillimin e sistemit penal. Për këto arsye, OSBE ka qenë e gatshme të punojë me mbrojtësit duke filluar nga analiza e efikasitetit,

⁸² “Shqyrtimi i parë”, faqe 40.

⁸³ OSBE-ja kishte vëzhguar se: “sipas KPPP, roli i palës mbrojtëse është më shumë kontradiktor sipas natyrës, që kërkon më shumë qasje më të thellë dhe pro-aktive në rastet në krahasim me atë se si ishte paraparë sipas kodit të mëparshëm procedural. Në të shumtën e rasteve, këto zhvillime kërkojnë më shumë angazhim të avokatit, kontakte më të afërta me klientët, tentime për hetimet të hollësishme, si dhe më shumë argumente specifike dhe përkrahëse për rast, që do t’i mundësonin të akuzuarit dhe avokatit që të ndërtojnë një mbrojtje më të mirë”. Shqyrtimi i gjashtë, faqe 68.

duke ngritur shqetësimet e vrojtura përmes monitorimit si dhe duke sugjeruar zgjidhje të mundshme.⁸⁴

Gjatë pesë viteve, OSBE-ja ka vëzhguar raste në të cilat avokati mbrojtës kishte dështuar t'i mbrojë të drejtat e klientit të tij dhe kishte shkelur kodin vendor të mirësjelljes.⁸⁵ Kjo ka shpjer deri te shkelja e të drejtës së të akuzuarit për mbrojtje efikase.⁸⁶ Këto shqetësime fillimisht ishin nënvizuar në korrik të vitit 2000⁸⁷ kur OSBE-ja kishte vërejtur se “në gjykimet e monitoruara nga SMSJ, avokatët mbrojtës më shumë ishin dukur të jenë vetëm palë e pranishme, se sa avokat i cili do të duhej të ishte në mënyrë aktive i angazhuar në përfaqësimin efikas të klientit të tij/saj.”⁸⁸ Raportet pasuese të OSBE-së kanë theksuar kapituj të veçantë që i dedikohen shqetësimeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen.⁸⁹ Dhe si përgjigje ndaj këtyre rekomandimeve, OAK, si dhe disa avokatë dhe autoritetet tjera kanë bërë përpjekje për të ngritur standardet e mbrojtjes, ose të sigurojë kushte më të mira për punën e mbrojtjes. Kështu, edhe pse mbesin shumë brenga (shih kapitullin III), ka pasur disa përparime në praktikë, si dhe disa hapa pozitiv institucional. Dhe është bërë një përzgjedhje si vijon:

a. Oda e Avokatëve të Kosovës

Në korrik të vitit 2000,⁹⁰ OSBE kishte rekomanduar që të përpilohet Kodi i etikës profesionale:

⁸⁴ OSBE-ja që nga 1 janari 2005 ka filluar që t'i shpërndajë anëtarëve të OAK raportet mujore në të cilat identifikohen mangësitë të aktorëve gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe avokatët. Këto raporte mujore ofrojnë rekomandime për t'i përballuar praktikat e parregullta. LSMS kishte pasur disa takime me përfaqësuesit OAK për të diskutuar për këto brenga.

⁸⁵ Standardet relevante janë të ruajtura/dhëna me ligjin vendor si dhe me Kodin kosovar të etikës profesionale të avokatëve (shih nenet 12 dhe 69- 77 KPPP; nenet 11 dhe 67 -75 KPP të RFJ-së; nenet 2 (d) dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/28 Mbi të drejtat e personit të arrestuar nga ana e autoriteteve për zbatimin e Policisë). Këto dispozita e obligojnë avokatin që të luajnë pjesën e tyre në mënyrë aktive gjatë procedurave në mënyrë që të sigurohet se mbrohen të drejtat dhe interesat e klientëve të.

⁸⁶ E drejta themelore për përfaqësim ligjor të personave të akuzuar për vepra penale epet me nenin 5 dhe 6 të KEDNJ dhe me nenet 9 dhe 14 të PNDCP. Dokumentet tjera relevante ndërkombëtare janë Rregullat minimale të standardeve për trajtimin e të burgosurve si dhe Parimet themelore të rolit të avokatëve. E drejta për përfaqësim ligjor zbatohet në të gjitha shkallët e procedurave penale dhe është prej një rëndësie të veçantë kur të burgoset ndonjë person, për të siguruar se respektohet parimi i korrektesisë dhe barazisë së armëve. Kur të ofrohet ndihma juridike, autoritetet relevante janë të obliguara që të ndihma e tillë të jetë (*Artico kundër Italisë*, KEDNJ, 13 maj 1980, para. 33).

⁸⁷ Raportet e LSMS numër 7 dhe 8 Mbi qasjen në avokat efikas, të datës 23 qershor dhe të korrikut 2000.

⁸⁸ Shqyrtimi i parë, faqe 49.

⁸⁹ Shih për shembull, Shqyrtimin e parë, neni 5: e drejta për avokat, faqe 45-57; Shqyrtimi i dytë, neni 4: e drejta për përfaqësim efikas, faqe 37-40; Shqyrtimi i katërt, neni: e drejta për përfaqësim ligjor, faqe 19-31; Shqyrtimi i pestë, neni 4 (D): Qasja në avokat efikas mbrojtës, faqe 45-50; Shqyrtimi i gjashtë, Kapitulli mbi të drejtën e mbrojtjes efikase, faqe 68-72.

⁹⁰ Shqyrtimi i parë, faqe 55.

“Duhet të nxirret kodi i cili ofron udhëzues për mirësjelljen dhe përgjegjësitë e prokurorëve dhe avokatëve, veçanërisht avokatët mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare.”

Për më shumë se pesë vite më vonë, më 11 qershor 2005, Kuvendi i OAK-së kishte aprovuar Kodin e etikës profesionale për avokatë, i cili kishte qenë pasardhës i Kodit të etikës profesionale të avokatëve i datës 30 gusht 2001, i cili ishte aprovuar nga i njëjti organ. Ky kod paraqet parimet themelore dhe ka për qëllim rregullimin e fushave siç janë besueshmëria profesionale, marrëdhëniet e avokatit me klient, përgjegjësia e avokatit në rastet penale, marrëdhëniet e avokatit me OAK-në, shpenzimet e përfaqësimit, etj. Është shumë herët të flitet për dobitë e këtij kodi, por OSBE-ja shpreson se rregullorja e posaçme e cila ofrohet me këtë kod do të ndihmojë që të ngritën standardet në Odën e Avokatëve.

Por, vet Kodi i etikës nuk mjafton për të ngritur standardet e mbrojtjes. Gjithashtu kërkohen trajnime intensive. Kështu, në tetor 2001, OSBE kishte rekomanduar që:

“I gjithë personeli relevant, përfshirë gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët mbrojtës, duhet të marrin pjesë nëpër trajnimet praktike për rolet dhe përgjegjësitë e tyre në mënyrë që të sigurohet se të drejtat e të akuzuarit janë të përkrahura me një mbrojtje efektive si gjatë fazës hetimore, ashtu edhe gjatë asaj të shqyrtimit kryesor.”⁹¹

Si përgjigje ndaj kësaj, OAK kishte mbajtur një numër trajnimesh, seminare dhe punëtori, shpeshherë në bashkëpunim me OSBE-në.⁹² Oda e ka themeluar një Komision të veçantë për edukimin e vazhdueshëm ligjor e i cili sajoi programe trajnuese. Në mars 2004, Komisioni kishte adoptuar rregullat fundamentale për Edukimin e vazhdueshëm ligjor, në bazë të së cilave të gjithë avokatët e regjistruar do të përfshihen në programet trajnuese të akredituara dhe se do të ofrohen ligjerata të veçanta për anëtarët e minoriteteve dhe për gratë. Faktikisht, edhe pse edukimi i

⁹¹ Shqyrtimi i tretë, faqe 31.

⁹² OSBE dhe OAK kishin zhvilluar programin për "Edukimin e vazhdueshëm" (EV) për anëtarët e sapo licencuar të OAK. Kishte mbajtur 14 seanca që nga shtatori i vitit 2004 deri në qershor 2005 për 50 avokatë të cilët ishin bërë anëtarë të OAK. Projekti për "Trajnimin e trajnerëve për OAK"-i cili ishte sponsoruar nga OSBE-ja, parasheh trajnim tre ditor për trajnerët e zgjedhur për shkathhtësitë prezantuese dhe për metodat e prezantimit interaktiv. Trajnerët të cilët i përmbushin programet do të angazhohen në OAK si ligjërues në edukimin e vazhdueshëm ligjor. Më tutje, OSBE dhe OAK kishin sajuar kurse profesionale trajnuese për të diplomuarit e juridikut të cilët janë në periudhën si praktikantë. Ishin mbajtur 21 seanca trajnuese në vitin 2005 në dobi të 20 praktikantëve të OAK dhe 10 praktikantë gjyqësor të Asociacionit të Gjyqtarëve të Kosovës.

vazhdueshëm ligjor nuk është obligativ (pasi ende nuk është nxjerrë Ligji mbi avokaturën), kjo është njëra nga kërkesat e planit për implementimin e standardeve për Kosovën.⁹³

Së voni, anëtarët e lartë të OAK kanë punuar për së afërmi me OSBE-në për t'i adresuar shqetësimet e ngritura në raportet OSBE-së. Nënkryetari i OAK-së dhe udhëheqësi i “Komisionit për edukimin e vazhdueshëm” kanë deklaruar:⁹⁴

“Duke pasur parasysh nevojën për kompetencë, profesionalizëm dhe etikë, OAK tani është duke i zhvilluar programet të cilat do të sigurojnë njohuri profesionale për avokatët dhe do të ngritë respektin e tyre ndaj etikës.⁹⁵ [...] Raportet e SMSJ-së paraqesin një instrument të spikatur për identifikimin e nevojave për edukim të vazhdueshëm ligjor për avokatët.”

Komisioni për edukim të vazhdueshëm ligjor e kishte dedikuar një “koordinator” për të analizuar pjesët e shqyrtimeve të OSBE-së dhe pastaj ta njoftojë Komisionin për mangësitë e avokatëve mbrojtës të nënvizuara në ato shqyrtime. Komisioni i shfrytëzon këto të dhëna për të sajuar programet edukative.⁹⁶

Në anën tjetër, përkrahja e çmuar profesionale e ofruar nga CDRC-ja ka ndihmuar në zhvillimin dhe përf forcimin e mëtejshëm të profesionalitetit të avokatëve mbrojtës.

Gjatë këtyre gjashtë viteve të fundit që nga rithemelimi i saj më 29 prill 2000, OAK gradualisht ishte zhvilluar në një asociacion të mirëfilltë dhe efikas për përkrahjen dhe rregullimin e odës së avokatëve mbrojtjes. Kjo ka zgjatur, por OAK më në fund dëshmohej të jetë një forcë e rëndësishme për zhvillimin e përfaqësimit të mbrojtjes efikase.

b. Avokati mbrojtës

⁹³ Standardi për Sundimin e Ligjit 10.5.

⁹⁴ Letër nga i nderuari Musa Dragusha për LSMS, data 20 prill 2005.

⁹⁵ Programet: edukimin e vazhdueshëm intensiv për avokatët e rinj, si dhe ato obligative..

⁹⁶ “Bazuar në mungesat e avokatëve gjatë përfaqësimit të rasteve në procedurat ligjore që ishin identifikuar nga monitoruesit e LSMS dhe që ishin publikuar në raportet periodike, Komisioni për edukim të vazhdueshëm ligjor i identifikon nevojat për programe edukative.” Letër nga i nderuari Musa Dragusha për LSMS, data 20 prill 2005.

Krahas kësaj, avokatët mbrojtës kishin bërë përpjekjet për të ngritur standardet e tyre, pjesërisht duke mësuar nga të metat e nënvizuara në raportet e SMSJ-së.⁹⁷ OAK kishte theksuar se:

“Nën rrethanat kur, si në këtë rast në Kosovë, ka një mungesë e komentareve të ligjeve, qasja në literaturë juridike dhe në internet është e kufizuar, nuk ekziston ende ndojnë publikim për praktikë gjyqësore apo bazë të të dhënave ligjore, raportet e SMSJ-së po bëhen një prioritet dhe jashtëzakonisht të dobishme, referenca të vlefshme, dhe për avokatët mbrojtës një mjet i shkëlqyeshëm për të përkrahur ankesat e tyre dhe të sfidojnë praktikatat e paqëndrueshme gjyqësore.”

OSBE kishte vërejtur përmirësimet në përfaqësimin kualitativ në një numër të konsiderueshëm të fushave. Monitoruesit e OSBE-së kishin vërejtur më pak raste të mos aktivizimit të avokatëve mbrojtës në lidhje me marrjen në pyetje të dëshmitarëve të prokurorisë, iniciativa për ngarkimin e masave alternative për dënim dhe paraburgim dhe përdorimin më të shpeshtë të praktikave gjyqësore ndërkombëtare të drejtave të njeriut, që të përkrahin argumentet e palës mbrojtëse. Për shembull, KPPPK kishte dhënë një mori opsionesh për dënimet alternative. Megjithatë, gjatë gjashtë muajve të parë të zbatimit të kodeve të reja, mbrojtja duket se ka qenë e pa vullnetshme që të kërkojë nga gjykata që t’i referohet atyre (dënimet alternative). Kështu, në dhjetor të vitit 2004, OSBE-ja kishte rekomanduar që:

“Kur të jetë e përshtatshme, avokati mbrojtës duhet ta nxis gjykatën që të merr parasysh alternativat e burgimit në raste të shpalljes fajësisë përmes aktgjykimit, dhe të paraqes rrethanat lehtësuese relevante.”⁹⁸

OSBE-ja kishte vërejtur zhvillime pozitive pasi avokatët mbrojtës kishin propozuar që të përdoren alternativat për burgim. Në shumë raste, gjykatat kishin zbatuar masat alternative.

c. Autoritetet tjera

OSBE e pranon se avokatët mbrojtës duhet shpesh të punojnë në kushte të vështira, të cilat e bëjnë më të vështirë që ata ta përdorin potencialin e tyre të plotë për të përfaqësuar klientët e tyre

⁹⁷“Avokatët kishin filluar të përdorin të gjeturat e raporteve si mjet të tyre që përkrahnin veprimtaritë e tyre posaçërisht në rastet e burgosjeve.” Letër nga i nderuari Musa Dragusha për LSMS, qershor 2005.

⁹⁸ Shqyrtimi i gjashtë, faqe 72.

denjësisht. Kështu, OSBE ka bërë një numër rekomandimesh te autoritetet relevante me qëllim të përmirësimit të kushteve për avokatët mbrojtës.

OSBE kishte vërejtur se neni 74 (2) i KPP të RFJ-së, i cili i jep autorizim gjyqtarit hetues për të monitoruar dhe kufizuar komunikimin e të pandehurit me avokatin e tij/saj ishte në kundërshtim me standardet ndërkombëtare që mbrojnë besueshmërinë e komunikimeve të tilla. Autoritetet të cilat e kanë zbatuar këtë dispozitë kanë pasur ndikim kundërshtues në dhënien e mundësisë së avokatit për të ofruar mbrojtje efikase. Kështu, në korrik të 2000, OSBE kishte rekomanduar:

“KFOR, policia e UNMIK-ut dhe kolegjet penale të UNMIK duhet të sigurojnë që i akuzuari dhe avokati mbrojtës të kenë mundësi që të komunikojnë lirshëm, pa ndonjë kufizim kohor ose kufizim tjetër, në të gjitha fazat e procesit penal. I akuzuari dhe avokati i tij/saj mbrojtës duhet të kenë garanci për komunikime konfidenciale, si në formën me shkrim, ashtu edhe gojarisht në të gjitha fazat e procesit penal. Komunikimet mund të bëhen brenda objektit, por jo edhe në prezencën e të tjerëve që do të mund të dëgjonin bisedën. Gjykatat dhe UNMIK-u duhet të sigurojnë hapësirat e domosdoshme për komunikime të tilla. Duhet të ndërrohen, ose të shfuqizohen dispozitat e ligjit vendor që i shkelin standardet ndërkombëtare, posaçërisht neni 74 (2) i KPP i RFJ-së.”⁹⁹

Fillimisht, autoritetet nuk kishin vepruar asgjë në lidhje me këto rekomandime dhe problemet kishin vazhduar të përsëriten. Në tetor të vitit 2001, OSBE kishte përsëritur rekomandimet e saja dhe kishte theksuar se “nuk duhet të zbatohet neni 74(2) i KPP RFJ.”¹⁰⁰ Më në fund, DD kishte lëshuar në qarkore të sistemit gjyqësor 2002/2 për politikën e autorizimeve për t’i autorizuar vizitat e avokatëve të cilët dëshirojnë të vizitojnë klientët e tyre nëpër qendrat e paraburgimit/burgje. Kjo qarkore siguron që, për shkak të mospërputhjes së nenit 74(2) i KPP RFJ me standardet ndërkombëtare të njohura për të drejtat e njeriut, avokati mbrojtës duhet vetëm një herë t’a prezantojë autorizimin pranë autoriteteve të qendrës së paraburgimit e më pastaj ai do të ketë mundësi që të takohet lirshëm me klientin e tij/saj. OSBE ka vërejtur se praktika e tanishme që zbatohet nga ana e qendrave të paraburgimit, në përgjithësi është se avokati mbrojtës duhet që vetëm njëherë t’a prezantoj autorizimin e tij/saj pranë autoriteteve të qendrës së paraburgimit; kohëzgjatja e vizitës nuk është e kufizuar dhe komunikimi në mes avokatit mbrojtës dhe palës së

⁹⁹ Shqyrtimi i parë, faqe 55.

¹⁰⁰ Shqyrtimi i tretë, 31.

tij/saj është konfidenciale që do të thotë, në pamje por jo edhe në rrezen e dëgjimit të personelit të qendrës së paraburgimit.¹⁰¹

VII. ZHVILLIMI I PROGRAMIT PËR GJYQTARË DHE PROKURORË NDËRKOMBËTAR

Që nga qershori i vitit 1999, UNMIK-u ka pasur përgjegjësinë për të krijuar gjyqësinë kompetente, të pavarur dhe të paanshme në të cilën njerëzit nga të gjitha bashkësitë etnike do të ndjehen të përfaqësuar. Kjo nuk ishte edhe një detyrë e lehtë menjëherë pas konfliktit ku ishte paraqitur një mosbesim i gjerë ndërmjet komuniteteve. Kishin qenë dy pengesa kryesore për të krijuar një gjyqësi kompetente, dhe të përzier me shumë etnicitete: e para, gjetja e gjyqtarëve shqiptarë me përvojë për t'i rekrutuar ata;¹⁰² dhe e dyta, bindja e praktikantëve të komunitetit serb për të marrë pjesë. Në fazën e parë të punësimit, ishin rekrutuar vetëm shtatë serbë të Kosovës. Megjithatë, diku në tetor 1999, të gjitha ata kishin dhënë dorëheqje (duke theksuar ase nuk kishin siguri dhe ishin të diskriminuar). Kjo e kishte lënë gjyqësinë mono etnike dhe të papërvojë që të merret me krimet e motivuara etnike, përfshirë edhe krimet e luftës¹⁰³. Duhet të adresohet edhe çështja e paraqitjes potenciale e anshmërisë të mundshme apo reale gjyqësore. Prezantimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve etnikisht neutral përbrenda sistemit ligjor penal të vendit u bë një opsion.

¹⁰¹ Për shembull, në Qendrën e paraburgimit në Prishtinë/Priština, avokati mbrojtës duhet të merr lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake për të takuar klientin e tij. Kjo është në përputhje me nenin 294 të KPPPK. Si të jepet leja, avokati mbrojtës mund të vizitojë qendrën e paraburgimit pa kërkuar autorizim tjetër. Në lejen e vizitës është e theksuar se a do të bëhen takimet me klientin në prezencën e gardianëve apo jo, në objektin brenda por jo edhe në spektrin e dëgjimit. Në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë/Mitrovica janë të njëjtat rregulla dhe komunikimi në mes avokatit mbrojtës dhe klientit janë konfidenciale, përveç në rastet e veçanta, për shkaqe sigurie, gardianët mund të jenë prezent në dhomë, por jo edhe afër në spektrin e dëgjimit.

¹⁰² Kjo ka qenë problem për shkak se disa shqiptarë të Kosovës kishin praktikuar ligjin që nga viti 1989 për shkak se ata kishin qenë që dëbuar nga sistemi i regjimit të mëparshëm serb. Dhe ata shqiptarë të Kosovës të cilët kishin punuar gjatë viteve të 90' ta, pas konfliktit komuniteti shqiptar i kishte shpallur ata.

¹⁰³ Këshilli teknik konsultativ mbi shërbimin gjyqësor dhe prokurorial (TAC orig), i themeluar në Shtator të vitit 1999, në raportin e tij datuar 13 Dhjetor 1999 rekomandoi themelimin e një tribunali vendor me jurisdiksion mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera serioze të ligjit humanitar ndërkombëtar si dhe krimeve serioze etnikisht të motivuara. Gjykata e propozuar ishte quajtur "Gjykata e Kosovës për Krime të Luftës dhe Krime Etnike" (KËECC Orig.). Projekti për themelimin e gjykatës së tillë ishte braktisur në Shtator të vitit 2000, pjesërisht për shkak të qështjeve të financimit dhe vështirësive rreth gjetjes së lokacioneve të përshtatshme por mbi të gjitha për shkak se Programi për Gjyqtarë dhe Prokurorë Ndërkombëtar tregoj të jetë i suksesshëm.

Në fillim të dhjetorit 1999, OSBE-ja kishte rekomanduar që edhe gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar të përfshihen në të njëjtën mënyrë në sistemin gjyqësor penal të vendit, në mënyrë që ata të merren me rastet e krimeve të luftës dhe ato ndër-etnike:

“Përfshirja e pjesëmarrjes së gjyqtarëve ose prokurorëve ndërkombëtar: Në fazat e hershme të themelimit të sistemit të ri gjyqësor në Kosovë, gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar mund të ndihmojnë në shpërndarjen dhe përmirësimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Pjesëmarrja e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar veçanërisht mund të jetë e dobishme në kolegjet vendore në rastet e shkeljeve të ligjit ndërkombëtar humanitar.”¹⁰⁴

OSBE konsideronte se përvoja dhe neutraliteti etnik i gjyqtarëve ndërkombëtar do të paraqiste një respekt më të madh për norma të gjyqimit të drejt dhe do t'i garantonte serbëve të Kosovës se, gjyqimet për krime të luftës do të bëhen drejt.

UNMIK-u në mënyrë të kujdesshme i kishte përfshirë gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar në sistemin vendor. Fillimisht, në shkurt të vitit 2000, UNMIK-u e kishte emëruar një gjyqtar ndërkombëtar dhe një prokuror ndërkombëtar në Mitrovicë/Mitrovica, për t'u marr me ata persona të arrestuar për konfliktet etnike në fillim të vitit 2000. Kur në pranverën e vitit 2000, të burgosurit serbë të Kosovës kishin hyrë në grevë urie si protestë kundër paraburgimit të zgjatur dhe kishin kërkuar që rastet e tyre të dëgjohej nga ana e gjyqtarëve ndërkombëtar, UNMIK-u kishte filluar të zgjerojn programin dhe kishte rritur numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar.¹⁰⁵

Megjithatë, OSBE-ja kishte vërejtur shqetësimet për mënyrën se si janë administruar gjyqimet e natyrës ndër-etnike nga gjyqtarët dhe prokurorët shqiptar të Kosovës. Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar kishte qenë i pamjaftueshëm që të merreshin me çështjen e anshmërisë së mundshme apo reale gjyqësore.¹⁰⁶ Prandaj, në tetor të vitit 2000 OSBE-ja kishte rekomanduar:

“Rastet të cilat përfshijnë akuza për krime të luftës, krimet e rënda të motivuara etnikisht ose veprat tjera politikisht të ndërlidhura duhet të ndiqen nga prokurorët ndërkombëtar dhe

¹⁰⁴ Raporti 2-Zhvillimi i sistemit gjyqësor në Kosovë (10 qershor deri 15 dhjetor 1999), 17 dhjetor 1999.

¹⁰⁵ Kjo ishte arritur nëpërmjet rregullores së UNMIK-ut 2000/34 që e kishte ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2000/06 të 15 shkurtit 2000 mbi emërimin dhe shkarkimin nga zyra e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, kishte hyrë në fuqi më 29 maj 2000.

¹⁰⁶ Shih diskutimin në raportin e parë, faqe 58-75.

të kryesohen nga një gjyqtar i vetëm ndërkombëtar ose me një koleg të përbërë nga shumica gjyqtarë ndërkombëtar.”¹⁰⁷

OSBE gjithashtu kishte vërejtur se kolegjet gjykuese ishin përbërë nga pesë gjyqtarë (dy profesional dhe tre ndihmës) dhe se “shpërndarja e barabartë e votimeve për të gjithë gjyqtarët seriozisht kishte reduktuar ndikimin e vërtetë që do të mund të kishin gjyqtarët ndërkombëtar për ndonjë aktgjykim potencial që ka qenë i motivuar në baza etnike.”¹⁰⁸

Nga fundi i vitit 2000, ishin caktuar dhjetë gjyqtarë ndërkombëtarë dhe tre prokurorë ndërkombëtarë në tërë Kosovën për t’u marrë kryesisht me rastet e krimeve të luftës. Megjithatë, pasiqë ishte vetëm një gjyqtar ndërkombëtar në kolegjin e përbërë prej pesë anëtarëve, problemi i gjyqtarëve ndërkombëtar të cilët mbivotohen, ka lënë një anshmëri potenciale etnike të pazgjedhur. Si përgjigje ndaj kësaj, në Dhjetor 2000 ishte nxjerr Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 mbi emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar ose ndërrimit të vendit (Rregullorja 64). Rregullorja i kishte dhënë autoritet UNMIK-ut që t’i caktojë rastit tre gjyqtarë profesional dhe me minimum dy gjyqtarë ndërkombëtarë.¹⁰⁹ PSSP kishte autoritet të plotë të caktojë gjyqtarë ose prokurorë ndërkombëtar atëherë kur ishte “e domosdoshme për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësisë ose të sigurojë administrimin e drejtë të gjyqësisë.” Prokurorëve ndërkombëtarë iu kishte dhënë liri të gjerë të veprimit që të merr përsipër çdo rast vendor i cili është i pezulluar. Miratimi i Rregullores 64 është bërë krahas heqjes së mangësive fillestare në program dhe procedurë përderisa procedura mbetet aktive ende edhe sot e kësaj dite.¹¹⁰

Që nga miratimi i Rregullores 64, të gjitha rastet e krimeve të luftës ishin dëgjuar nga një kolegji/panel i përbërë nga (së paku) shumica e gjyqtarëve ndërkombëtarë. Deri më sot, 502 raste janë ndjekur penalisht nga prokurorët ndërkombëtarë. Edhe pse programi ka mundur të jetë më efikas, ka qenë një komponentë vitale për rastet e motivuara ndër-etnike, dhe së voni, krimi i organizuar në ambientin e pas konfliktit.

¹⁰⁷ Shqyrtimi i parë, faqe 75.

¹⁰⁸ Shqyrtimi i parë, faqe 70.

¹⁰⁹ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 mbi emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë si dhe ndërrimi i vendit, që ishte miratuar më 15 dhjetor 2000.

¹¹⁰ Për më shumë detaje të programit GJPN shih: “si është ballafaquar Administrata e përkohshme e Kombeve të Bashkuara me çështjen e anshmërisë etniken gjyqësi” nga Richard Rogers (Strategjia për drejtësinë tranzicionale në ish-Jugosllavi, Qendra për ligje ndërkombëtare, 2005).

KAPITULLI 3

SHQETËSIMET TË CILAT NUK JANË ADRESUAR

I. PARATHËNIE

Në raportet e veta, OSBE-ja vazhdimisht ka ngritur shqetësime dhe ka raportuar për shkeljet e të drejtave të njeriut të vrojtuar në sistemin ligjor. Ka theksuar se si gjyqtarët vendor, ashtu edhe ata ndërkombëtarë vazhdimisht e shkelin ligjin e aplikueshëm duke përfshirë edhe dispozitat për të drejtat e njeriut; avokatët mbrojtës dështojnë të përfaqësojnë denjësisht klientët e tyre; OAK ka mungesë të kontrollit mbi anëtarët e saj; pagesat për avokatët dhe ekspertët e caktuar *ex officio* janë dukshëm të ngadalshme; mungojnë objekte të përshtatshme për të pandehurit të mitur dhe ata që janë me aftësi të kufizuara mendore; është evidente ngacmimi i dëshmitarëve dhe gjykatat nuk kanë pajisje për të ofruar masa mbrojtëse; dhe, ajo që është më brengosëse mbi të gjitha, UNMIK-u sapo ka filluar së voni të implementojë strategjinë e saj kalimtare me të cilën kompetencat për çështje gjyqësore t'i dorëzohen aktorëve dhe institucioneve vendore.”¹¹¹ Ky kapitull (3) fokusohet në shqetësimet të cilat janë ngritur nga OSBE-ja, porse nuk janë adresuar në mënyrë adekuate nga ana e autoriteteve, apo mund të themi se fare jo.

Kapitulli 3 është vazhdimësi e njëjtë strukturale sikurse edhe kapitulli i mëparshëm. Është e ndarë në katër pjesë: shqetësimet që ndërlidhen me institucione; çështjet legjislative; shqetësimet që kanë të bëjnë me praktikën; si dhe shqetësimet që kanë të bëjnë me programin për gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë.

II. SHQETËSIMET QË KANË TË BËJNË ME INSTITUCIONET

i. Gjykatat

a. Mungesa e zyrave

Shqetësimet që kanë të bëjnë me mungesën e hapësirës si në zyrat e gjykatave, ashtu edhe sallave të gjykimit janë raportuar nga OSBE-ja në mars të vitit 2002.¹¹² Në mars të vitit 2004, OSBE prapë kishte raportuar,¹¹³ se shumë raste të gjykimeve në Gjykatat Komunale mbahen në zyrat e Kryetarit

¹¹¹ Shqyrtimi i gjashtë, faqe 13.

¹¹² Raporti mbi “Administrimin e drejtësisë (mars 2002), faqe 18.

¹¹³ Raporti për gjykatat komunale, faqe 25.

të trupit gjykues. Këto zyra nuk janë të dedikuara për t'i mundësuar publikut të marr pjesë, duke pasur parasysh se prezenca e personelit të gjykatës, palët në procedurë dhe përfaqësuesit e tyre e mbushin kapacitetin e zyrave duke shkelur kështu të drejtën e të akuzuarit për gjykim publik. OSBE ka shprehur shqetësimin për situatën sa i përket hapësirës së pamjaftueshme për punë dhe mungesa e sallave të gjykimit nuk është përmirësuar.

b. Pagat

Niveli i ultë i pagave për një kohë të gjatë ka qenë burim i pakënaqësive në gjyqësinë kosovare. Në të shumtën e takimeve me OSBE, gjyqtarët ishin ankuar për nivelin e tyre të pagave dhe e kanë vënë në pikëpyetje të priturat e autoriteteve për kualitet të lartë të kryerjes së rasteve sepse kompensimi për punën e tyre është shumë dekurajues. OSBE-ja beson se është e domosdoshme rritja e pagave në mënyrë që t'i inkurajojnë juristët e mirë që t'i bashkohen trupave gjyqësore dhe të parandalojnë korrupsionin. Kështu, në fillim të dhjetorit të vitit 1999, OSBE, përderisa e kishte pranuar se ka kufizime të vazhdueshme të ardhurave financiare publike, ajo kishte rekomanduar që:

“Pagat e gjyqtarëve, prokurorëve dhe shërbyesve tjerë civil të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë duhet të vendosen në atë nivel që të jenë proporcionale me standardet jetësore të tyre dhe proporcionale me shkathhtësitë e tyre të specializura. Në veçanti, pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të rriten mbi nivelet e tanishme në mënyrë që të sigurohet se sistemi gjyqësor është në gjendje të rekrutojë profesionist të kuadrit të lartë si dhe t'i mbrojë zyrtarët civil nga presioni i korrupsionit.”¹¹⁴

Edhe pse nivelet janë ngritur që nga 1999, ato ende mbeten të ulëta. Në mars të vitit 2002, OSBE prapë e kishte ngritur çështjen e pagave të ulëta:

“Duke pasur parasysh mungesën e gjyqtarëve dhe prokurorëve vendor, çështja e pagave është një nga pengesat kryesore të gjetjes së personave kompetentë për t'u plotësuar këto vende. Përderisa është e kuptueshme se kemi një buxhet të kufizuar, duhet të kemi parasysh se për tu siguruar një gjyqësi e pavarur dhe e kualifikuar dhe zyre të prokurorëve publik, pagat duhet të nivelizohen me ato të ardhura që ata profesionist do të mund ti mermin jashtë gjyqësisë. [...]”

¹¹⁴ Vëzhgimet dhe rekomandimet e Seksionit për monitorimin të sistemit juridik i OSBE, Raporti 2-Zhvillimi i sistemit gjyqësor të, 17 dhjetor 1999.

Megjithatë, autoritetet kishin rezistuar që të dëgjojnë thirrjet për një rritje të arsyeshme. Në fakt, pagat nuk janë ngritur që nga viti 2002, kur ishte autorizuar një ngritje prej 5%¹¹⁵. Për momentin, të ardhurat neto mujore të gjyqtarëve janë siç vijon: Gjykata Supreme-538 EUR; Gjykata e Qarkut-479.50 EUR; dhe Gjykata Komunale-420.06 EUR.

ii. Objektet e paraburgimit

a. Dënimet alternative (masat jo-izoluese)

Dënimet alternative kërkojnë përkrahjen institucionale. Pa një përkrahje të tillë, nuk mund të implementohen në mënyrë të drejtë dënimet, dhe kështu nuk mund të konsiderohen si alternativa reale. OSBE-ja ka vërejtur se ekziston një mungesë serioze e kapaciteteve institucionale në Kosovë, që kufizojnë spektrin e dënimeve të mundshme. Edhe pse janë bërë përpjekje për të përkrahur kapacitetet institucionale, saktësisht krijimi i shërbimit me kusht, zbrazëtitat institucionale ende kufizojnë në mundësitë e gjykatave për të zbatuar dënime të ndryshme. Në dhjetor 2004, OSBE kishte rekomanduar që:

“Departamenti i Drejtësisë duhet të sigurojë vendosjen dhe ruajtjen e kapacitetit të nevojshëm institucional për implementimin e masave dhe sanksioneve të parashikuara me ligj. Kjo përfshinë: themelimin e institutit për trajtim të detyrueshëm rehabilitues për të varurit nga droga dhe alkooli; dhe, përgatitjet për ekzekutimin e dënimit me burg në formë të gjysmëlirisë.”¹¹⁶

Mungesa e kapacitetit institucional është veçanërisht e pranishme në fushën e sanksionimit kundër delinkuentëve të mitur.¹¹⁷ Dhe sipas asaj që është e paraparë me ligj, mungojnë qendrat disiplinore, institucionet edukuese, objektet e kujdesit të veçantë si dhe shtëpitë e kujdestarisë. Kështu OSBE-ja në dhjetor të vitit 2004, kishte rekomanduar më tutje që:

“Departamenti i Drejtësisë duhet të sigurojë vendosjen e një kapaciteti të nevojshëm institucional që do të jetë në pajtim me LPM-në. Kjo përfshin edhe krijimin e institucioneve si në vijim:

– Qendrës disiplinore;

¹¹⁵ ABA CEELI, Indeksi i reformave gjyqësore për Kosovën, tetor 2004, faqe 27.

¹¹⁶ Shqyrtimi i gjashtë, faqe 62.

¹¹⁷ Shqyrtimi i gjashtë, faqe 6.

- Një institucioni edukues;
- Një enti të kujdesit të posaçëm; dhe,
- Një institucion edukues-korrektues të llojit gjysmë të mbyllur.”¹¹⁸

Rekomandimet e sipërme ende nuk janë adresuar. Mungesa e kapaciteteve institucionale për shërbimin e dënimeve vazhdon t’i kufizojë mundësitë e gjykatave për shfrytëzimin e të gjitha opsioneve ekzistuese për sanksionim.

b. Personat me çrregullime mentale:

Para vitit 1999, nëse të pandehurit nga Kosova do të ishin konsideruar me çrregullime mendore, ata do të burgoseshin dhe trajtoheshin nëpër spitalet e Jugosllavisë jashtë Kosovës, si p.sh. në Shkup (Maqedoni) ose në Nish (Serbi). Kështu, kur sistemi shëndetësor ishte ndarë nga ai jugosllav në vitin 1999, Kosova ishte mbetur pa institut të përshtatshëm për paraburgim dhe trajtim. Rastet më të rënda ishin dërguar në spitalin e Prishtinës/Priština. OSBE kishte ngritur këtë çështje në raporte të shumta, të cilat e kishin theksuar nevojën për një kornizë të avancuar ligjore dhe nevojën për institucione të përshtatshme.¹¹⁹

Në vitin 2002 OSBE kishte rekomanduar që:

“Draft rregullorja për burgosjen dhe trajtimin e obliguar duhet të hyjë në fuqi si çështje prioritare. Kjo do të caktojë qartë bazat për paraburgim dhe trajtim të obliguar për të gjitha autoritetet, një procedurë funksionale për shqyrtim gjyqësor dhe periudhat e caktuara mes shqyrtimeve. [...]Dy dhomat në spital duhet të hapen menjëherë dhe policia e armatosur dhe e uniformuar duhet të largohet. Dhe më tutje, kjo masë duhet që menjëherë të përcillet me një kornizë të pastër ligjore, legjislativë dhe funksionale, që i mundëson këtyre rasteve të personave të sëmurë mental që sistemi korrektues dhe penal të kenë konsideratë. Dhe më tutje kishte rekomanduar që menjëherë të krijohet një repart i siguruar psikiatrik akut, me

¹¹⁸ Shqyrtimi i gjashtë, faqe 63.

¹¹⁹ Shih shqyrtimin e dytë, faqe 23-28, shqyrtimin e tretë, faqe 41-42, shqyrtimin e katërt, faqe 52-57 dhe shqyrtimin e pestë, faqe 34-38 të LSMS, Departamenti për të drejtat e njeriut dhe sundimit të ligjit të Misionit të OSBE-së në Kosovë.

personel dhe trajnime speciale në spitalin e Prishtinës, dhe nëse është e nevojshme gjithashtu edhe në vendet tjera..”¹²⁰

Më 24 gusht 2004 UNMIK-u kishte nxjerr Rregulloren 2004/34 mbi Procedurën penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore. Sipas kësaj Rregulloreje, gjykata shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim ndaj kryerësit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë së zvogëluar mendore nëse konstaton se ekziston rrezik serioz që kryerësi të kryejë vepër penale ku përfshihet akti i dhunshëm ose shkaktimi i lëndimit trupor personit tjetër.¹²¹ Dhe çka është shumë e rëndësishme, ligji përcakton se të gjitha masat e shqiptuara nga gjykata, përfshirë këtu burgimin, duhet të zbatohen nëpër institucionet për kujdes shëndetësor, e jo nëpër qendra të paraburgimit.

Pa marr parasysh dispozitat e reja, problemi më i madh në Kosovë vazhdon të jetë mungesa e një objekti të sigurt për vendosjen dhe trajtimin e personave me çrregullime mendore. Për momentin shfrytëzohen spitali i Neuropsikiatrisë në Klinikën Universitare të Prishtinës/Priştina, si dhe Qendra Korrektuese Neuropsikiatrike në Lipjan, por këto institucione nuk mund të ofrojnë ambient të sigurt për trajtim adekuat.¹²²

III. ÇËSHTJET LIGJORE

Përderisa UNMIK-u ka prezantuar një numër të madh ligjeve të reja (Rregulloret) dhe qarkoret gjyqësore për qështje të ndryshme, një numër fushash të cilat do të përfitonin nga ligjet e reja apo ato të ndryshuara, apo edhe nga nxjerrja e qarkoreve gjyqësore, ato kanë mbetur të paprekura, edhe përkundër rekomandimeve të OSBE-së. Në vijim janë dhënë shembujt:

i. Qarkoret e drejtësisë

a. Çështjet e përkthimit/interpretimit

¹²⁰ Shqyrtimi i katërt i Sistemit të gjyqësisë penale (shtator 2001-shkurt 2002), faqe 58.

¹²¹ Neni 7 i Rregullores së UNMIK-ut 2004/34 mbi Procedurën penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore.

¹²² Praktika e tanishme gjyqësore të vendosjes së personave me çrregullime mentale në masa sigurie, që i dërgon ata drejt në departamentin e Qendrës Korrektuese Neuropsikiatrike në Lipjan/Lipljan, pasi ky objekt është i siguar dhe ofrojnë trajtim psikiatrik. Ky objekt i ka ekspertët psikiatrik ndërkombëtar. Megjithatë, duhet të theksohet se objekti, si ai psikiatrik, ashtu edhe ai administrativ përbëjnë pjesën e burgut dhe kështu nuk e bëjnë këtë objekt si institucion mjekësor në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

Në prill 2003, OSBE kishte theksuar se njëri ndër problemet kryesore të rasteve të trafikimit ka qenë dështimi i gjykatave për të ofruar përkthim adekuat për të dyshuarin/të akuzuarin dhe për dëshmitarët.¹²³ Dhe si rezultat, është rekomanduar që DD-ja të nxjerr një qarkore gjyqësore për gjyqtarët dhe prokurorët që t'i informojnë ata se përkthyesit janë në dispozicion për të marrë pjesë në procedurat gjyqësore, dhe atë sipas kërkesës.¹²⁴ Ende nuk është nxjerrur ndonjë qarkore e tilla. Rastet e trafikimit ende ndikohen me mundësinë për përkthyes.

b. Qasja në vendimet e gjykatës

Sipas kodit të tanishëm të procedurës penale, roli i avokatit mbrojtës është më i disfavorshëm për nga natyra që ata të kërkojnë, në mes tjerash, argumente më përkrahëse dhe më të veqanta që i mundësojnë avokatëve të ofrojnë mbrojtjen më të mirë të mundshme. Dhe në fund, avokatët duhet të kenë qasje në vendimet me shkrim të gjykatës-duke përfshirë rastet kur ata nuk janë të përfshirë-në mënyrë që të zhvillojnë argumentet ligjore. Megjithatë, shumë avokatë janë ankuar se është vështirë për ta për të siguruar vendimet derisa ata ishin të caktuar për ato raste. Kështu, në dhjetor 2004, OSBE kishte rekomanduar se duhet të lëshohet qarkorja gjyqësore që i informon gjykatat për obligimet e tyre për të bërë vendime me shkrim si dhe aktgjykime që do të ishin lirisht të qasshme për avokatët mbrojtës.¹²⁵ Asnjë qarkore e tillë nuk është lëshuar. Avokatët mbrojtës ende kanë probleme në sigurimin/marrjen e kopjeve të vendimeve tjera të gjykatës.

ii. Ligjet

Në muajin prill të vitit 2002, OSBE ka rekomanduar ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut si dhe personelit të tyre në Kosovë, për të lejuar që gjykatat e vendit të mund t'i shqyrtojnë dhe vendosin për veprimet ose vendimet administrative të autoriteteve të UNMIK-ut¹²⁶. Ishte sugjeruar që ky ndryshim të përcaktojë qartë veprimet e rregullta që i ndërmerr UNMIK-u në cilësinë e administruesit lokal, të cilat pastaj do të ishin objekt për shqyrtim ligjor. Deri më tani nuk është bërë një ndryshim i tillë. Kosovës ende i mungon një sistem kuptimplotë i shqyrtimit ligjor të vendimeve të autoriteteve të UNMIK-ut.

¹²³ Shqyrtimi i pestë, faqe 40.

¹²⁴ Shqyrtimi i pestë, faqe 26.

¹²⁵ "Shqyrtimi i gjashtë, f. 72.

¹²⁶ "Shqyrtimi i katërt, f. 43.

Në Prill të vitit 2003, OSBE ka rekomanduar që PSSP-ja të lëshojë një urdhëresë administrative për të prezantuar obligimin për gjykatat ose prokuroritë që qysh në rastin e parë të mundshëm t'i njoftojnë dëshmitarët të cilët mund të jenë të kërcënuar lidhur me masat ekzistuese për mbrojtje të dëshmitarëve sipas Rregullores 2001/20 për mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve në procedurë penale¹²⁷. Një urdhëresë e tillë administrative do ta kishte zvogëluar frikën e dëshmitarëve dhe do t'i kishte inkurajuar ata që të dëshmojnë. Një urdhëresë e tillë administrative nuk është nxjerrur. Hezitimi i dëshmitarëve për të dëshmuar vazhdon ta dëmtojë sistemin juridik¹²⁸.

Në prill të vitit 2003, OSBE ka rekomanduar gjithashtu që rregullorja e përmendur mbi mbrojtjen e dëshmitarëve të ndryshohet për ta bërë të qartë se shkelja e masës ose urdhrin për mbrojtje paraqet vepër penale, si dhe e njëjta të vlejë për zyrtarin i cili i kryen detyrat në lidhje me masat mbrojtëse – nëse i zbulon të dhënat e fshehta lidhur me identitetin e dëshmitarit të mbrojtur¹²⁹. Edhe pse kjo rregullore është ndryshuar më 24 janar 2002, përmes Rregullores së UNMIK-ut 2002/1, rregullorja e re nuk e ka vendosur veprën si vepër penale siq ishte sugjeruar nga OSBE-ja.

IV. SHQETËSIMET LIDHUR ME PRAKTIKËN

i. Gjykatat

a. Kërkesat “*Habeas corpus*”

Peticioni për kundërshtimin e paraburgimit njihet edhe si kërkesa *habeas corpus*. Mekanizmi për *habeas corpus* përfundimisht ka hyrë në fuqi në vitin 2004 së bashku me KPPPK. Gjyqtari mund ta mbajë seancën e dëgjimit nëse kërkesa *habeas corpus* në shikim të parë vërteton se paraburgimi është i paligjshëm¹³⁰. Në Dhjetor 2004, OSBE ka vërejtur¹³¹ se “përkundër faktit se ka pasur disa raste kur mbrojtja e ka përdorur kërkesën e re *habeas corpus*, tani është njoftuar se gjykatat mund të jenë të painformuar në lidhje me mënyrën se si ti trajtojnë këto kërkesa” Prandaj, OSBE kishte rekomanduar që:

¹²⁷ “Shqyrtimi i pestë”, f. 26.

¹²⁸ Shih “Raporti për përgjigjen e sistemit të drejtësisë ndaj trazirave të marsit 2004” (dhjetor 2005).

¹²⁹ “Shqyrtimi i pestë”, f. 26.

¹³⁰ Neni 286(3) KPPPK.

¹³¹ “Shqyrtimi i gjashtë”, f. 29

“Instituti gjyqësor i Kosovës të ofrojë trajnime plotësuese për gjyqtarët lidhur me dispozitat të cilat e rregullojnë kërkesën *habeas corpus*”¹³².

IGJK-ja ka mbajtur një seri punëtorishë që kishin të bënin me çështjen e paraburgimit në muajt prill, maj dhe qershor të vitit 2005. Pa marrë parasysh analizën e OSBE-së dhe trajnimet plotësuese, gjykatat ende dështojnë t’i shqyrtojnë si duhet *habeas corpus* argumentet e mbrojtjes. Për shembull:

Më 19 gusht 2005, Gjykata e Qarkut në Prizren e ka vazhduar paraburgimin për tre të bashkë-akuzuar për rrëmbim. Më 14 shtator 2005, mbrojtja e kishte ngritur kërkesën *habeas corpus* për kundërshtimin e vendimit mbi zgjatjen e paraburgimit mbi bazën se shkaqet kryesore për caktimin e paraburgimit kishin pushuar së ekzistuari (pas mbledhjes së të gjitha provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve, nuk kishte më “dyshimi të bazuar”). Deri në kohën e mbajtjes së shqyrtimit kryesor më 17 tetor 2005, gjykata ende nuk kishte vendosur mbi kërkesën e ngritur.

Gjykatat në tërësi duhet t’i marrin parasysh kërkesat *habeas corpus* dhe t’u përgjigjen atyre në kohë të duhur.

b. Seancat publike

OSBE ka vërejtur se një numër i gjykatave të qarkut dhe ato komunale nuk i kanë vendosur në vend publik të gjitha oraret e gjykimeve publike, penale ose civile, të cilat janë caktuar të mbahen në gjykata. Kjo mund të paraqet shkelje të të drejtës së të pandehurit për gjykim publik¹³³. Në Tetor 2003, OSBE ka rekomanduar:

“[T]ë gjitha gjykatat penale për publikun të ofrojnë informata lidhur me datën, kohën dhe vendin e seancave publike. Kjo mund të arrihet përmes vendosjes së listës së rasteve të caktuara për shqyrtim në gjykatë, në vendet ku publiku ka qasje në to ose duke ua dhënë

¹³² Shqyrtimi i gjashtë”, f. 33.

¹³³ E drejta e gjykimit publik është pjesë përbërëse e të drejtës ndërkombëtare. E drejta ndërkombëtare parashikon që “çdo person ka të drejtë në [...] gjykim publik”, shih nenin 6(1) KEDNJ; nenin 14(1) PNDCP; nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Gjykata Evropiane ka theksuar se “... gjykimi është në përputhje me parimin e publicitetit vetëm atëherë kur publiku ka të drejtë të sigurojë informata lidhur me datën dhe vendin...” (shih *Riepan kundër Austrisë*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 14 nëntor 2000, para. 29). Për këtë arsye, si pjesë e obligimeve të tyre për të siguruar publicitetin e seancës, autoritetet duhet të sigurojnë informata lidhur me datën dhe vendin e seancës dhe kjo të jetë e gatshme për publik.

këtë informatë të gjithë anëtarëve të publikut që e kërkojnë atë, pa marrë parasysh përfshirjen e tyre në rastin e veçantë”¹³⁴.

Në përgjigje të kësaj, DD ka lëshuar qarkoren e drejtësisë 2003/7 për qasjen e publikut në drejtësi, në muajin shkurt të vitit 2004, me të cilën përshkruan se administratorët dhe kryetarët e gjykatave duhet të sigurojnë se oraret e gjykimeve janë vendosur në tabelën e shpalljeve të qasshme për publikun, dhe kjo në pajtim me nenin 76 të “Rregullave të veprimtarisë së brendshme të gjykatave”.

Mirëpo, OSBE ka vërejtur se një numër i gjykatave ende nuk i ka vendosur në tabelë oraret e plota të gjykimeve përkundër udhëzimeve specifike nga DD, dhe këtë çështje ia ka raportuar edhe njëherë DD-së¹³⁵. Gjykatat të cilat është gjetur të kenë shkelur këtë të drejtë janë Gjykata Komunale e Prizrenit (informata jo të sakta); Gjykata Komunale në Suharekë/Suva Reka (informata e vënë por vetëm në gjuhën shqipe); Gjykata Komunale në Rahovec/Orahovac (pa orar të gjykimeve); Gjykata e Qarkut në Prishtinë/Priština dhe ajo komunale (nuk janë dhënë informata); gjykatat komunale në Glllogovc/Glogovac, Lipjan/Lipljane dhe Podujevë/Podujevo (oraret e gjykimeve nuk janë vendosur në mënyrë konsistente); Gjykata e Qarkut në Pejë/Peć dhe gjykatat komunale (rrallë vendosin informata).

Është e papranueshme që, përkundër përkujtimeve të vazhdueshme, kryetarët e gjykatave ose administratorët ende dështojnë që të sigurojnë vendosjen e informatave në mënyrë të saktë, të plotë dhe në kohë të duhur të orareve të gjykimeve publike.

c. Vendimet e arsyetuara për paraburgim

Një nga mangësitë më të mëdha të sistemit të drejtësisë penale është dështimi i vazhdueshëm i gjykatave që t’i arsyetojnë si duhet dhe plotësisht vendimet e veta. Kjo ka të bëjë me të gjitha llojet e vendimeve, por në mënyrë të veçantë kjo dukuri është shprehur në aktvendimet për caktimin e paraburgimeve: gjykatat dështojnë që të vërtetojnë se përse ekzistonë “dyshimi i bazuar”; gjykatat dështojnë që të deklarohen rreth fakteve specifike të rasteve të cilat obligojnë caktimin e paraburgimit karshi atyre për lirim nga paraburgimi ose lirim të kushtëzuar; dhe në shumë vendime, gjykatat vetëm e përsërisin tekstin në të cilin janë të numëruara shkaqet për caktimin e

¹³⁴ HRRoL - OSBE raporti mujor (26 shtator -2 tetor 2003).

¹³⁵ Shih raportin mbi administrimin e drejtësisë nga gjykatat komunale (mars 2004) dhe OMiK-HRRoL raportin mujor për dhjetorin e vitit 2004.

paraburgimit, por pa i ndërlidhur ato me faktet e rastit. Kështu është vepruar njësoj edhe në aktvendimet e para, zgjatjet e paraburgimit dhe në procedurën ankimore, përfshirë edhe Gjykatën Supreme. Kjo mangësi ka vazhduar të ndikojë negativisht në të drejtat e të akuzuarve për t'u njoftuar për shkaqet e mbajtjes së tij/saj në paraburgim, ose për mundësinë e ankesës. Vendimet e tilla janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare¹³⁶. Ky problem është vërejtur në korrik të vitit 2000, kur OSBE kishte rekomanduar që:

“[T]ë gjitha urdhëresat për paraburgim të lëshuara nga gjykatat e Kosovës duhet të paraqesin faktet specifike të cilat e mbështesin ndonjë bazë të veçantë për caktimin e paraburgimit në pajtim me ligjin vendor si dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”¹³⁷.

Më tutje është rekomanduar që PSSP ta rishikojë ligjin në fuqi në lidhje që rishqyrtimi i vendimeve për paraburgim të të përfshijë “[...] aktvendim të shkruar plotësisht të arsyetuara lidhur me bazat për urdhërin e zgjatjes së paraburgimit”¹³⁸.

Pas rekomandimeve të lartpërmendura, në dhjetor të vitit 2000, DD kishte lëshuar një qarkore të drejtësisë 27/2000 mbi vendimet për caktimin e paraburgimit, në të cilën thuhet se të gjitha aktvendimet mbi paraburgimin të bëhen mbi bazën e aktvendimit të shkruar plotësisht të arsyetuar duke i paraqitur në hollësi bazat për caktimin e paraburgimit dhe çfarëdo dëshmi që e mbështesin këtë vendim. Por, edhe përkundër këtij udhëzimi gjyqtarët vendës kanë vazhduar të nxjerrin aktvendime të cilat vetëm se e parafrzojnë dispozitën e caktuar ligjore ndërsa në rastin më të keq vetëm e zbatojnë gabimisht.

Përfundimisht, në vitin 2004, me KPPPK janë paraparë dispozita të veçanta me të cilat kërkohet që aktvendimet mbi paraburgimin të jenë plotësisht të arsyetuara¹³⁹ dhe të cilat theksojnë që mungesa e

¹³⁶ Në lidhje me vendimet për paraburgimin, neni 9 (1) i PNDCP kërkon që heqja e lirisë të bëhet bazuar në shkaqet dhe në pajtim me procedurën e përcaktuar me ligj (parimi i ligjshmërisë); neni 5 (1) i KEDNJ-së kërkon që heqja e lirisë të bëhet në pajtim me ligjin, dhe për shkaqet shprehimisht të përmendura me ligj; standardet ndërkombëtare dhe e drejta e precedentit kërkon që gjykatat të paraqesin arsyet për vendimet e veta (*Hood kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 18 shkurt 1999, para. 60).

¹³⁷ “Shqyrtimi i parë”, f. 43.

¹³⁸ “Shqyrtimi i parë”, f. 43.

¹³⁹ Neni 283 (1) i KPPPK - Paraburgimi caktohet me aktvendimin me shkrim i cili përfshin: “bazën ligjore për paraburgim... dhe arsyetimin e fakteve vendimtare që e kanë 132 shkaktuar paraburgimin duke përfshirë edhe arsyet për dyshim të bazuar se personi ka kryer vepër penale dhe faktet vendimtare nga neni 281, paragrafi 1, nën paragrafi 2 i këtij Kodi”.

arsyetimit të duhur paraqet shkelje të procedurës penale dhe rrjedhimisht edhe bazë për ngritjen e ankesës¹⁴⁰.

Më tej, në dhjetor të vitit 2004, OSBE ka publikuar një raport të hollësishëm duke analizuar të gjitha aspektet e problemeve që kanë të bëjnë me aktvendimet për paraburgimin, si para ashtu edhe pas hyrjes në fuqi të kodit të përkohshëm penal dhe atij të procedurës penale, dhe ka dhënë gati dy faqe me rekomandime¹⁴¹. Në veçanti, OSBE ka theksuar rëndësinë e Gjykatës Supreme për udhëzimin e gjykatave të ulëta dhe ka rekomanduar që:

“Gjykatat e ankesës, dhe në veçanti Gjykata Supreme duhen që në mënyrë të vazhdueshme të lëshojnë vendime me të cilat udhëzohen gjykatat më të ulëta se vendimet mbi paraburgim gjithnjë duhet të jenë të arsyetuara si duhet dhe në pajtim me ligjin”¹⁴².

Megjithatë, përkundër përpjekjeve të bëra nga aktorët e ndryshëm për zhvillimin e kapacitetit të gjyqtarëve në aspektin e përpilimit të vendimit, mangësitë vazhdojnë të pllakosin gjykatat e Kosovës në të gjitha nivelet. Për shembull:

Gjykata Komunale në Prizren, më 18 shkurt 2005, zgjati paraburgimin e të dyshuarit për shkaktim të lëndimit të lehtë trupor. Prokurori kërkoi zgjatjen e paraburgimit “për arsye objektive,” pa e elaboruar. Në vendimin për vazhdim të paraburgimit, gjykata thjeshtë deklaroi se pas kërkesës nga prokurori publik dhe shqyrtimi i shkresave të lëndës, gjyqtari përfundoi se kushtet ligjore për të cilën është caktuar paraburgimin ende vazhdojnë të ekzistojë. Gjykata nuk dha elaborim për “arsyet objektive.”¹⁴³

¹⁴⁰ Neni 435 i KPPPK.

¹⁴¹ “Shqyrtimi i gjashtë”, f. 32.

¹⁴² “Shqyrtimi i gjashtë”, f. 32.

¹⁴³ Në një rast tjetër, Gjykata e Qarkut e Mitrovicës/Mitrovica urdhëroi paraburgimin e një personi të dyshuar për blerjen e paautorizuar, posedimin, shpërndarjen, dhe shitjen e drogave narkotike dhe substancave psikotropike. Avokati mbrojtës paraqiti ankesë dhe kërkoi që paraburgimi të zëvendësohet me burg shtëpiak. Gjykata e apelit, më 6 qershor 2005, refuzoi ankesën, duke përsëritur bazat ligjore për paraburgim. Megjithatë, askund në vendimin e vet gjykata nuk shpjegon përse burgu shtëpiak nuk do të ishte i mjaftueshëm nën këto rrethana.

Është shqetësim serioz se pesë vite pasi që OSBE-ja spikati problemin e arsytimit joadekuat janë bërë pak përmirësime në standardin e përgjithshëm të vendimeve për paraburgim nga gjyqtarët vendës, përkundër shembujve të izoluar të vendimeve mirë të arsyetuara.¹⁴⁴

d. Praktikë e shqiptimit të dënimeve

Njëra nga mangësitë më të rëndësishme në sistemin e drejtësisë penale e vërejtur nga OSBE-ja është dështimi i vazhdueshëm i gjykatave për të arsyetuar në mënyrë të duhur dhe plotë vendimet mbi dënimet dhe për të elaboruar rrethanat rënduese dhe lehtësuese në vendimet për dënim.

Në vitin 2004, OSBE-ja ka rekomanduar se në vendimet mbi ankesën, gjykatat e apelit dhe në veçanti Gjykata Supreme duhet t'i udhëzojë në mënyrë konsistente gjykatat më të ulëta se aktgjykimet dhe vendimet që kanë të bëjnë me dënimin duhet të përfshijnë një arsyetim të detajuar dhe individualizuar. Ajo ka theksuar në veçanti se gjykatat duhet të vendosin përkitazi me dënimin e individualizuar brenda kufijve të themeluar me ligj; japin arsyetim të detajuar gjatë vendosjes përkitazi me dënimin e lehtësuar përfshirë këtu edhe ekzistimin e rrethanave të tilla të veçanta që bëjnë me dije se qëllimi i dënimit mund të arrihet nëpërmjet të dënimit më të ulët; të zbatojë në mënyrë adekuate rrethanat lehtësuese dhe rënduese në pajtim me ligjin; dhe konsiderojë zbatimin e masave alternative ndaj dënimit me burg në të gjitha rastet.¹⁴⁵

Edhe pse ekzistojnë vendime të cilat marrin parasysh rekomandimet e dhëna, në përgjithësi, praktika e dhënies së vendimeve pa arsyetim ka vazhduar. Kështu është puna veçanërisht me vendimet mbi zbutjen e dënimeve dhe zbatimin joadekuat i rrethanave lehtësuese dhe rënduese. Megjithatë, monitoruesit e OSBE-së kanë vërejtur shenja të zhvillimit pozitiv përkitazi me aplikimin e masave alternative ndaj burgimit.

e. Vonesat

Mosaftësia e sistemit të gjykatave për të proceduar rastet brenda një periudhe të arsyeshme kohore pengon administrimin e duhur të drejtësisë në përgjithësi. Në lëndët penale, kjo disfavorshëm

¹⁴⁴ Është e vlefshme të përmendet se gjatë vitit 2004 dhe 2005, Gjykata Supreme e Kosovës ka prishur apo ndryshuar 41 vendime për paraburgim të gjykatave të shkallëve më të ulëta për shkak të arsytimit të pamjaftueshëm.

¹⁴⁵ Shqyrtimi i gjashtë, faqe 62.

ndikon në të drejtën e të pandehurit për t'u gjykuar brenda kohës së arsyeshme.¹⁴⁶ Një gjykim i shpejtë është veçanërisht i rëndësishëm kur i akuzuari është në paraburgim dhe ligji në fuqi urdhëron që i paraburgosuri të drejtën që ai/ajo të gjykohe brenda një periudhe të arsyeshme kohore ose të lirohet nga paraburgimi.¹⁴⁷ Në shkurt 2001, OSBE ka vërejtur që:

“Ekziston një shkelje e gjerë e të gjitha këtyre dispozitave për shkak se gjykatat e qarkut paraqesin mungesë të urgjencës në regjistrimin dhe përfundimin e gjykimeve penale. Për shembull lëndët shpeshherë shtyhen për shkak të dështimit për të zhvilluar/kërkuar testet mjeko-ligjore shumë muaj pas ngritjes së aktakuzës.”¹⁴⁸

OSBE-ja ka vërejtur këtë dhe shqetësime të ngjashme në shumë raste të mëtejme. Krahas kësaj, në mars 2004, OSBE-ja ka ofruar një analizë të detajuar të problemit të vonesave në sistemin e gjykatave komunale që mbulon si rastet penale ashtu edhe ato civile.¹⁴⁹ Në këtë raport OSBE-ja përfundon:

“Është evidente se vonesat në përpunimin e rasteve dhe numri i madh i lëndëve të pazgjdhura ndikojnë në mënyrë negative në administrimin e drejtësisë përkitazi me çështjet penale dhe civile. Shtimi i numrit të madh të rasteve të pazgjdhura duhet të adresohet në mënyrë urgjente para se të lejohet të bëhet burim i vonesave shtesë në veti. Efikasitet më i madh mund të arrihet nëpërmjet të identifikimit të praktikave të përdorura në gjykata me shkallë më të lartë të efikasitetit dhe mëpastaj zbatimit të tyre anembanë Kosovës. Krahas kësaj, postet e zbrazëta duhet të plotësohen dhe sipas nevojës gjyqtarët të rishpërndahen nëpërmes gjykatave.”¹⁵⁰

¹⁴⁶ E drejta për gjykim brenda një periudhe të arsyeshme kohore garantohet me nenin 6 (1) të KEDNj-së dhe nenin 14(3)(c) MNDCP-së. Kjo e drejtë është veçanërisht e rëndësishme në rastet në të cilat i akuzuari është në paraburgim. E drejta për gjykim brenda një periudhe të arsyeshme kohore është e mbrojtur shprehimisht me ligjin vendës në fuqi (neni 5 i KPPPK-së), e cila parashikon kufijtë kohor për rregullimin e fazave të ndryshme të procedurës.

¹⁴⁷ Neni 5 paragrafi 3 i KPPPK-së thotë se “çdo privim i lirisë dhe në veçanti çdo paraburgim në procedurën penale duhet të zvogëlohet sa i përket kohëzgjatjes së tij deri në kohën më të shkurtër të mundshme”.

¹⁴⁸ Shqyrtimi i dytë, faqe 21.

¹⁴⁹ Raporti për Gjykatat Komunale, faqe. 8-16.

¹⁵⁰ Raporti për Gjykatat Komunale, faqe 17.

Autoritetet e UNMIK-ut janë përpjekur që të adresojnë këtë problem në nivel strukturor. Në vitin 2003, KGJPK-ja ka urdhëruar një vlerësim të sistemit gjyqësor të Kosovës.¹⁵¹ Projekti vlerësoi strukturën ekzistuese të gjykatave në Kosovë përfshirë këtu edhe numrin e kërkuar të posteve gjyqësore dhe prokuroriale. Në bazë të këtij raporti ishte hartuar Ligji mbi Gjykatat e Rregullta, i cili ka për synim, pjesërisht, futjen e sistemit të gjykatave në rrjedhat kryesore të politikave dhe në përmirësimin e efikasitetit.

Megjithatë, për momentin, vonesat vazhdojnë. Rastet në vijim ilustronë pasojat serioze që vonesa mund të ketë:

Në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, i pandehuri u gjykua në bazë të KPP të RFJ-së për posedim të paligjshëm të armëve dhe substanca eksplozive. Aktakuza kundër të pandehurit ishte ngritur më 20 gusht 2000, mirëpo shqyrtimi kryesor nuk kishte filluar gjer më 17 janar 2005, gati katër vite e gjysmë pas ngritjes së aktakuzës.

Në një rast tjetër në të cilën u mbajt procedura e shkurtër në bazë të KPP të RFJ-së pranë Gjykatës Komunale të Mitrovicës/Mitrovica, i pandehuri ishte ngarkuar me vepër penale të braktisjes së personit që ka kërkuar ndihmë. Propozim akuza u parashtrua më 28 shkurt 2003, mirëpo shqyrtimi kryesor nuk është mbajtur deri më 19 janar 2005, gati dy vjet pas parashtrimit së propozimakuze.

Në këto raste kufijtë kohor të parashikuar për fillimin e gjykimeve ishin shpërfillur në mënyrë flagrante. Vonesat nuk i ishin atribuar rasteve të komplikua ashtu sikur as sjelljes së të akuzuarit. Për më tepër, KEDNJ-së parasheh një detyrë për palët nënshkruese që të organizojnë sistemet e tyre juridike ashtu që t'ju lejojë gjykatave që të përbushin kërkesat e nenit 6(1).¹⁵² Ky nen thotë se autoritetet mund të mbahen përgjegjëse në rast të dështimit për të shtuar resurset si përgjigje ndaj numrit të rasteve të pazgjidhura dhe mangësive strukturore të cilat shkaktojnë vonesa.¹⁵³

¹⁵¹ Kjo është kryer në bashkëpunim me Divizionin e Zhvillimit Gjyqësor të DD të UNMIK-ut, Zyrës së zhvillimit, ndihmës dhe trajnimit prokurorial jashtë Amerikës të DD të SHBA-ve dhe Këshillit të Evropës.

¹⁵² *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës*, KEDNJ, A 66 para. 29 (1983).

¹⁵³ Është me rëndësi të ceket se vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në *Eckle kundër RFGJ-së* (15 korrik 1982), paragrafi 92, ku gjykata konsideron se qeveria nuk mundet të mbështetet në argumentin e normës së madhe të punës me të cilën janë përballur gjykatat përkatëse, e cila ka shkaktuar në mes tjerash edhe vonesa deri në tre vjet ndërmjet të paraqitjes së propozim akuzës dhe fillimit të gjykimit.

Në Kosovë, vonesat shkaktohen nga një sërë të metash apo kombinime të tyre, të cilat gjykatat dhe organet e UNMIK-ut duhet t'i adresojnë. Gjatë viteve të kaluara, OSBE-ja ka analizuar një numër të këtyre mangësive dhe ka dhënë rekomandime për zgjidhjen e tyre.¹⁵⁴ Disa nga shkaktarët kryesor janë diskutuar më poshtë.

Dështimi i gjykatave për të siguruar pjesëmarrjen e viktimave dhe dëshmitarëve ka qenë problem që nga viti 1999. Ky problem mbetet i tillë edhe sot. Kjo është pjesërisht për shkak të vështirësisë në mbajtjen e shënimeve të sakta të adresave që rezultojnë me probleme gjatë dorëzimit të fletëthirrjeve për gjyq. Edhe pse Urdhëresa administrative 2002/16¹⁵⁵ përcakton procedurën për organet gjyqësore të UNMIK-ut për të kërkuar zbulimin e shënimeve personale nga regjistri civil, shumica e gjyqtarëve dhe policia nuk kanë qenë të vetëdijshëm për këtë mundësi të marrjes së adresës së një personi.¹⁵⁶ Për të korrigjuar këtë, në mars 2004 OSBE-ja ka rekomanduar që:

“DD-ja duhet të nxjerr një qarkore të drejtësisë me të cilën informohen gjyqtarët, policia hetimore dhe pjesëtarët e njësisë regjionale të fletë-arresteve dhe gjykatave për procedurat e parashikuara me Urdhëresën administrative 2002/16. Krahas kësaj një sistem më fleksibil për kërkesat e informatave nga gjykatat që i bëhen regjistrimit civil duhet të dizajnohet përfshirë këtu edhe plotësimin e formularit të standardizuar nga kryetari i trupit gjykues dhe përcjelljen e tij regjistrimit civil nëpërmjet të koordinimit të DD-së.”¹⁵⁷

Këto masa do të mund t'i ndihmonin gjykatat në gjetjen e shpejtë të dëshmitarëve dhe viktimave të cilët kanë dështuar të marrin pjesë në gjykimin. Megjithatë, gjer më tani, DD-ja nuk ka nxjerrë qarkoren e drejtësisë për t'i informuar gjykatat. Më tutje, gjykatat nuk kanë përdorur procedurat e përcaktuara me Urdhëresën administrative 2002/16 dhe asnjë gjykatë nuk ka iniciuar formularët e standardizuar për të kërkuar informatat nga regjistri civil. Shumica e gjyqtarëve dhe policëve ende nuk duket se janë të vetëdijshëm për mundësinë e marrjes së adresës së personit nëpërmjet të kësaj procedure. Me sa duket, gjykatat nuk mund të mbledhin nismën për adresimin e këtij problemi.

¹⁵⁴ Shqyrtimi i pestë, faqe 36-37; Shqyrtimi i dytë, faqe 19, 21 dhe 80; shqyrtimi i tretë, faqe 44; shqyrtimi i katërt, faqe 21 dhe 25; shqyrtimi i pestë, faqe 30-31; raporti i gjykatave komunale, faqe 8-17; raporti i OSBE-së mbi administrimin e drejtësisë (mars 2002), faqe 10-19.

¹⁵⁵ Urdhëresa administrative Nr. 2002/16 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/13 mbi regjistrin civil qendror siç është ndryshuar me Urdhëresën administrative 2003/19.

¹⁵⁶ Urdhëresa deklaron se kërkesa duhet t'i dorëzohet drejtorit të DD-së dhe i adresohet drejtorit për çështje administrative. Në praktikë, pasi të autorizohet, nevojiten pesë minuta për procedimin e një kontrollimi.

¹⁵⁷ Raporti i gjykatave komunale, faqe 30.

f. Menaxhimi i rrjedhës së lëndëve:

OSBE-ja potencon se menaxhimi i lëndëve nga disa gjykata ishte një faktor tjetër kontribuues në krijimin e vonesave. Në mars 2002, OSBE-ja rekomandoi se:

“Teknikat moderne dhe praktike të menaxhimit të lëndëve duhet të përkrahen dhe zbatohen ashtuqë gjyqtarët të mund të mësojnë të përballen me normën e madhe të punës përderisa në të njëjtën kohë plotësojnë edhe kërkesat e shpejtësisë.”¹⁵⁸

Shtylla I dhe DD-ja ka bërë shumë pak për të adresuar problemet e menaxhimit të dobët të lëndëve. Dhe OSBE-ja vazhdoi të dokumentojë rastet në të cilat vonesat e panevojshme shkaktohen nga mangësitë e sistemit të menaxhimit të lëndëve. Për të ndihmuar në zvogëlimin e këtyre vonesave, në mars 2004 OSBE-ja rekomandoi që:

“DD-ja duhet të kryejë një hulumtim për të përcaktuar arsyet për një menaxhim më të mirë të rrjedhës së lëndëve në gjykatat e caktuara komunale. Pas përcaktimit të tyre, këto ‘praktika më të mira’ administrative të gjykatave duhet të ndahen me kryetarët e të gjitha gjykatave. DD-ja duhet të ndihmojë gjykatat në zbatimin e këtyre praktikave më të mira për t’i ndihmuar gjykatave për të përdorur më mirë resurset e tyre dhe për t’ju shmangur vonesave të panevojshme në procedimin e lëndëve.”¹⁵⁹

Nuk është ndërmarrë asnjë projekt i praktikave të mira nga DD-ja. Problemi vazhdon. Megjithatë, Qendra Kombëtare për Gjykatat Shtetërore (QKGjSH) ka zhvilluar katër seminare/punëtori mbi menaxhimin e rrjedhës së lëndëve për kryetarët dhe administratorët e gjykatave.¹⁶⁰ Në të vërtetë, më 6 dhjetor 2005, QKGjSH-ja ka mbajtur disa punëtori regjionale mbi zvogëlimin e numrit të rasteve të pazgjydhura në lëndët civile që ka për qëllim përcaktimin e standardeve kohore. QKGjSH-ja gjithashtu zhvilloi hartimin e standardeve kohore për t’i përdorur ato për matjen e vonesave dhe të ofrojnë një referencë për gjykatat që ato ta përdorin atë kur analizojnë menaxhimin e rasteve të tyre. Këto përpjekje nga QKGjSH-ja përfaqësojnë një fillim pozitiv në adresimin e kësaj çështje të rëndësishme.

¹⁵⁸ Raporti mbi administrimin e drejtësisë (mars 2002), faqe. 20.

¹⁵⁹ Raporti i gjykatës komunale, faqe 30

¹⁶⁰ Qendra kombëtare për gjykatat shtetërore (QKGjSH), është një agjenci e kontraktuar nga USAID-i për realizimin e një projekti të reformës së sektorit të drejtësisë në Kosovë.

g Caktimi i prokurorëve komunal:

OSBE-ja ka vërejtur se në gjykatat komunale, gjykimet vonohen rregullisht për shkak se prokurori nuk është paraqitur gjatë seancës dëgjimore, me sa duket për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet të gjykatave dhe prokurorëve. OSBE-ja ka vlerësuar se problemi ka lindur pjesërisht për shkak të faktit se prokurorët komunal janë caktuar në gjykatat komunale në qendrën e qarkut dhe mund të kërkohet që mbulojë ndonjëherë nga gjykatat komunale në kuadër të qarkut.¹⁶¹ Kështu, në mars 2004, OSBE-ja rekomandoi që:

“DD-ja duhet të prezantojë një mekanizëm që siguron një lidhje më të mirë të drejtpërdrejt ndërmjet gjykatave komunale dhe prokurorëve gjegjësisht. Në të gjitha rajonet prokurorët duhet të caktohen për një apo më shumë gjykata komunale në vend se të caktohen për tërë rajonin.”¹⁶²

Gjer më tani, prokurorët nuk janë caktuar në gjykatat përkatëse dhe problemet rreth koordinimit vazhdojnë të ndikojnë në seancat dëgjimore. OSBE-ja është e brengosur se një numër i gjykimeve, veçanërisht në gjykatat më të vogla komunale, vazhdimisht shtyhen për shkak të mospjesëmarrjes së prokurorëve publik, gjë që rezulton në vonesa të tej-zgjatura.

h Dëshmia e ekspertit:

Dëshmia e ekspertit shpeshherë kërkohet me qëllim të zhvillimit të hetimeve penale dhe/apo gjykimet. Në Kosovë marrja e dëshmisë prej ekspertit ka qenë e ngadalshme dhe problematike për dy arsye: së pari, mungesa e ekspertëve të kualifikuar në Kosovë në veti nënkupton që organet gjyqësore janë drejtuar kah ekspertët e huaj, gjë që kërkon kohë dhe së dyti, ekspertët nga Kosova rregullisht kanë dështuar që të marrin pjesë në seanca gjyqësore kur janë thirrur për to. Ekspertët kanë qenë shumë të ngadalshëm pa arsye në dorëzimin e raporteve të tyre. Disa raporte kurrë nuk janë kompletuar. OSBE-ja ka vërejtur se rastet rregullisht rezultojnë në vonesa për shkak të mungesës së dëshmive të ekspertit. Në shkurt 2002, OSBE-ja ka spikatur se:

¹⁶¹ Raporti i gjykatave komunale, faqe 15-16.

¹⁶² Raporti i gjykatave komunale, faqe 30.

“Përpos nëse është e adresuar në mënyrë adekuate nga organet e UNMIK-ut, praktika e ekspertëve të gjykatës në mospërfilljen sistematike të urdhrave që vijnë nga gjykatat penale do të rezultojnë në shkelje serioze të garancive të të drejtave të njeriut për gjykim të drejtë dhe proces të rregullt. Më tutje, kjo do të dobësojë autoritetin gjyqësor për të ekzekutuar vendimet e veta dhe për të pranuar ndihmë të duhur nga zyrtarët dhe departamentet të cilat duhet të përmirësojnë administrimin e drejtësisë.”¹⁶³

Një pjesë e problemit ishte pagesa e vonuar për kompensime edhe ashtu të vogla që u ipen ekspertëve. Në të vërtetë, nga janari deri në mars 2001, protestat ishin mbajtur nga ekspertët mjeko-ligjor të cilat kanë refuzuar që të ofrojnë raporte deri sa të plotësohen kërkesat financiare. Në shkurt 2002, OSBE-ja raportoi se:

“[Për shkak të kufizimeve financiare dhe logjistike, ekziston një hezitim dhe madje edhe refuzim nga ana e ekspertëve mjeko-ligjor në Kosovë për të ofruar shërbimet e tyre siç janë shkuarja në vendin e ngjarjes dhe ofrimi i dëshmisë në gjyq. Kjo ka vështirësuar funksionimin e gjykatave.”¹⁶⁴

OSBE-ja ka rekomanduar që “ekspertët gjyqësor të paguhen me kohë.”¹⁶⁵

Më 31 tetor 2002, DD-ja ka themeluar Zyrën e Ekzaminuesit Mjekësor e cila ka pushtet ekskluziv për të koordinuar kryerjen e vlerësimit të ekspertit lidhur me lëndimet fizike.¹⁶⁶ Ky ishte hapi i parë. Megjithatë, ekzistojnë shumë pak veprime të ndërmarra nga organet për korrigjimin e problemeve në marrjen me kohë të raporteve të ekspertit si nga ata vendës ashtu edhe nga ata ndërkombëtar. Më tutje, kjo vazhdon të shkakton vonesa në gjykime.¹⁶⁷

ii. Çështjet e avokatëve mbrojtës

Përmes monitorimit të vet, OSBE-ja ka vazhduar të vëzhgojë rastet në të cilat avokati mbrojtës ka dështuar që të përfaqësojë klientët e tyre në mënyrë efektive dhe/apo kanë

¹⁶³ Shqyrtimi i katërt, faqe 21.

¹⁶⁴ Raporti mbi administrimin e drejtësisë (mars 2002), faqe 13.

¹⁶⁵ Raporti mbi administrimin e drejtësisë (mars 2002), faqe 20.

¹⁶⁶ Lexo qarkoren e drejtësisë 2002/08.

¹⁶⁷ Në dhjetor 2004, OSBE-ja raporton se ka vërejtur “një sërë rastesh të tjera, në të cilat e drejta e të paraburgosurit për gjykim të shpejtë është arritur për shkak të vonesave të konsiderueshme në marrjen e raporteve të ekspertëve.” *Shih*, shqyrtimi i gjashtë.

shkelur kodet vendëse të mirësjelljes. Në shumë raste kjo ka shkaktuar shkelje të të drejtës së të akuzuarit për mbrojtje efektive. Shqetësimet janë potencuar rregullisht nga OSBE-ja që nga viti 2000.¹⁶⁸ Fatkeqësisht, shumë nga këto janë të përhapura edhe sot.

a. *Rekomandimet për avokatët mbrojtës*

Përkundër përmirësimeve të diskutuara në kreun 3, shumica e avokatëve mbrojtës ende nuk janë duke vepruar si duhet dhe ende janë duke dështuar në realizimin e standardeve e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të klientëve të tyre. Që nga raporti i fundit të OSBE-së mbi sistemin e drejtësisë penale të publikuar në dhjetor 2004, OSBE-ja ka vazhduar të vërejë mangësitë në punën e avokatëve mbrojtës, shembujt e të cilave janë paraqitur më poshtë:

OSBE-ja vazhdon të vëzhgojë rastet në të cilat avokatët mbrojtës dështojnë, pa arsyetim, që të paraqiten në gjykatë në ditën e seancës dëgjimore. Ky shqetësim ishte ngritur nga OSBE-ja në dhjetor 2004. Në shumicën e rasteve gjykatat trajtojnë praninë e avokatit mbrojtës si një formalitet dhe thjeshtë e caktojnë avokatin e parë mbrojtës në dispozicion për një seancë përkatëse edhe pse ai apo ajo nuk ka njohuri për rastin. Është shqetësim se avokati mbrojtës i sapocaktuar shumë rrallë kërkon shtyrjen e seancës së gjykimit me qëllim që të njohtohet lidhur me rastin.

Në një seancë të konfirmimit të aktakuzës të mbajtur pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priştina, më 21 mars 2005, katër të akuzuar u deklaruan të pafajshëm për kryerjen e veprës penale të trafikimit me njerëz. Gjyqtari për konfirmim ceku se avokati mbrojtës i një të dyshuari nuk ishte i pranishëm dhe kërkoi nga përfaqësuesi i palës së dëmtuar që të gjejë dikë për ta përfaqësuar atë të akuzuarin. Avokati i ri mbrojtës u paraqit në gjykatë, pranoi aktakuzën dhe u njohtua me klientin e tij të ri. Avokati i ri mbrojtës nuk kërkoi shtyrjen e seancës për të konsultuar klientin e tij dhe për të përgatitur lëndën. I akuzuari u deklarua i pafajshëm. Avokati mbrojtës i emëruar *ad hoc* u paraqit të jetë mjaft pasiv për shkak të panjohurisë së tij lidhur me rastin. Në seancat e mëtejshme, i akuzuari ishte përfaqësuar nga avokati mbrojtës i caktuar fillimisht.¹⁶⁹

¹⁶⁸ Shih, shqyrtimi i parë, faqe 42, 55 dhe 75; shqyrtimi i tretë faqe 31; shqyrtimi i pestë faqe 45-50; shqyrtimi i gjashtë faqe 33 dhe 72.

¹⁶⁹ Në një shembull tjetër, në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në Prizren, më 17 mars 2005, tre të akuzuar u gjykuan për akuza të abuzimit seksual të personit nën moshën 16 vjeçare. Avokati mbrojtës i caktuar *sipas detyrës zyrtare* dështoi të paraqitet. Gjykata emëroi një avokat tjetër mbrojtës i cili plotësisht nuk kishte

Dështimi i avokatit mbrojtës për të marrë pjesë në seancat dëgjimore dhe/apo për të kërkuar shtyrje kur avokati i sapo caktuar rrezikon të drejtën e personit për gjykim të drejtë. Veçanërisht shqetësuese është ajo se në rastet e sipërpërmendura gjykatat dështojnë që të mbrojnë të drejtat e të akuzuarit të cilat edhe ashtu ishin mospërfillur nga avokati mbrojtës i tij i caktuar fillimisht (duke mos u paraqitur) dhe nga avokati i ri mbrojtës i sapo-caktuar (që ka pranuar të vazhdoj me mbajtjen e seancës dëgjimore pa u përgatitur). Precedenti gjyqësor për të drejtat e njeriut thekson se përderisa gjykatat nuk janë përgjegjëse për çdo dështim apo mangësi në anën e avokatit mbrojtës, ato duhet të intervenojnë në rastet kur ekzistojnë dështime të qarta për të ofruar përfaqësim efektiv.¹⁷⁰ Megjithatë, gjykatat në Kosovë ka më shumë gjasë që të jenë pjesë e problemit sesa të zgjidhjes.

OSBE-ja gjithashtu ka vërejtur shembuj ku i njëjti avokat mbrojtës ka përfaqësuar të pandehurit e ndryshëm në të njëjtin rast. Ky shqetësim ishte ngritur fillimisht nga OSBE-ja në tetor 2001.¹⁷¹ Megjithatë, praktika vazhdon të vërehet:

Për shembull, në një rast pranë Gjykatës Komunale në Gjilan/Gnjilane, tre të pandehur ishin akuzuar bashkërisht për tentim vjedhje të rëndë. Një ditë para shqyrtimit kryesor të mbajtur më 30 maj 2005, avokati mbrojtës ishte emëruar sipas detyrës zyrtare për të përfaqësuar dy të pandehur. Njëri nga të pandehurit ishte i dënuar me pesë muaj burgim duke i shqiptuar dënimin me kusht për periudhë prej një viti, përderisa i pandehuri ishte liruar nga akuza.¹⁷²

Një veprim i tillë nga avokati mbrojtës është në shkelje të ligjit të aplikueshëm dhe Kodit të Mirësjelljes.¹⁷³

njohuri për rrethanat e rastit, mirëpo shqyrtimi kryesor vazhdoi pa avokatin mbrojtës i cili kishte kërkuar kohë për t'u konsultuar me klientin e tij.

¹⁷⁰ *Kamasinski kundër Austrisë*, KEDNj-ja, A 168 para. 65 (1989), i referohet faqes 264 nga Harris, O' Boyle dhe Earbrick në Ligjin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Butterworths 1995).

¹⁷¹ Shqyrtimi i tretë, faqe 25.

¹⁷² Në shembullin e dytë, në Gjykatën Komunale të Mitrovicës/Mitrovica, dy të pandehur ishin akuzuar për okupim të paligjshëm të pronës së paluajtshme. Gjatë shqyrtimit kryesor të mbajtur më 23 maj 2005, dy të pandehur ishin përfaqësuar nga i njëjti avokat mbrojtës i angazhuar në mënyrë private. Pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, të pandehurit e parë ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me gjobë, përderisa i pandehuri i dytë është liruar.

¹⁷³ KPPK thekson se "në procedurën penale avokati mbrojtës nuk është i lejuar që të përfaqësojë dy apo më shumë të pandehur në të njëjtën lëndë" (neni 71(1)). Për më tepër, sipas Kodit të Etikës Profesionale të Avokatëve, avokati "nuk duhet të jetë këshilltar apo përfaqësues të më shumë se një klienti në të njëjtën lëndë

b. Rekomandimet organeve gjyqësore

Shumë nga rekomandimet e bëra drejt autoriteteve relevante që kanë për qëllim përmirësimin e kushteve për avokatin mbrojtës, nuk janë adresuar. Dështimi i organeve për të adresuar këto çështje e bënë më të vështirë për avokatin mbrojtës që të përmirësojnë standardin e punës së tyre.

Shqetësimet përkitazi me përfaqësimin joadekuat janë veçanërisht me rëndësi kritike përkitazi me avokatin mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare. OSBE-ja ka vërejtur se avokatët mbrojtës të cilët janë angazhuar sipas detyrës zyrtare kanë më shumë gjasa që të ofrojnë përfaqësim joadekuat. Avokati mbrojtës i kishte theksuar OSBE-së se kompensimi për avokatin e caktuar sipas detyrës zyrtare është një mos-nxitje për të ofruar mbrojtje të mirë. Në fund, për shkak të mungesës së resurseve për të angazhuar në mënyrë private avokatin, pjesëtarët më të varfër të shoqërisë pranojnë përfaqësimin e nivelit më të ulët, gjë që është shpesh joefektive. Kjo është e papranueshme. Në dhjetor 2004, OSBE-ja ka rekomanduar një zgjidhje të dyfishtë – një rivlerësim të tarifave për avokatin mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare dhe një politikë më e rreptë nga OAK-u në lidhje me avokatët të cilët dështojnë të ofrojnë mbrojtje efektive:

“Departamenti i administratës gjyqësore duhet të rishqyrtojë sistemin e pagesave për avokatët e caktuar nga gjykata.”¹⁷⁴

“Oda e Avokatëve të Kosovës duhet të jetë e hapur për ankesa dhe duhet të ndërmarrë veprime disiplinore kundër anëtarëve të cilët dështojnë të përmbushin detyrat e tyre profesionale ndaj klientëve të tyre në veçanti avokatëve mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare të cilët dështojnë të përfaqësojnë klientët e tyre pa arsyetim të duhur.”¹⁷⁵

OSBE-ja është informuar që niveli i pagesave për avokatët mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare nuk është ngritur nga Departamenti i administratës gjyqësore (DAGj). Kjo për këtë arsye mbetet joadekuate. Më tutje, edhe pse OAK-u është marrë me një numër të ankesave kundër avokatëve, duke marrë parasysh se avokatët mbrojtës ofrojnë rregullisht një mbrojtje joefektive dhe shpeshherë sillen në mënyrë jo të duhur në gjykatë, OAK-u nuk ka qenë mjaft aktive në rregullimin e profesionit të saj. Që nga viti 2001, Oda ka shqiptuar vetëm tre sanksione disiplinore kundër

nëse ekzistojnë konflikte të interesit ndërmjet të klientëve apo ekziston një rrezik serioz për një konflikt të tillë” (neni 4, nën-paragrafi 4.1).

¹⁷⁴ Shqyrtimi i gjashtë faqe 73.

¹⁷⁵ Shqyrtimi i gjashtë, faqe 72.

anëtarëve të vet: një suspendim për gjashtë muaj, një qortim, dhe një gjobë. Edhe pse ka pasur ankesa të cilat i janë paraqitur Komisionit disiplinor të OAK-ut në vitin 2004 dhe 2005 nuk ka pasur raste të shqiptimit të sanksioneve disiplinore kundër ndonjë avokati mbrojtës nga ana e Odës. Si DAGj-ja ashtu edhe PAK-u kanë nevojë që të punojnë bashkërisht në gjetjen e ndonjë zgjidhje për këtë problem të vazhdueshëm.

Autoritetet kanë dështuar që të merren me një numër të fushave të cilat ndikojnë në punën e avokatit mbrojtës. Për shembull, në shqyrtimin e vet të fundit, të publikuar në dhjetor 2004, OSBE-ja ka nxjerrë rekomandimet në vijim prej të cilave asnjë nuk është adresuar:

“Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm duhet të shpall Ligjin mbi Avokatinë si prioritet ashtuqë edukimi i vazhdueshëm ligjor të bëhet obligativ për avokatët mbrojtës.”¹⁷⁶

Gjer më tani, Ligji mbi avokatinë është ende në formë të draftit dhe është në pritje të promulgimit nga PSSP-ja.

“Departamenti i Drejtësisë duhet të përcjell qarkoren e drejtësisë të posa nxjerrë Odës së Avokatëve të Kosovës për shpërndarje anëtarëve të vet.”

Oda e Avokatëve të Kosovës ende nuk ka pranuar ndonjë qarkore të drejtësisë të lëshuar nga DD-së.

“Departamenti i Drejtësisë duhet të sigurojë se që së paku një dhomë e konsultimit në secilën gjykatë të vihet në dispozicion për avokatët mbrojtës.”¹⁷⁷

Sipas informatave të pranura nga kryetarët e gjykatave komunale dhe të qarkut, ende ekziston një krizë në aspektin e hapësirave për zyre; mezi ka zyre të mjaftueshme për gjyqtarët dhe stafin e tyre përkrahës. Kështu, gjykatat janë në pamundësi të dedikojnë ndonjë zyre për avokatin mbrojtës. Për momentin gjyqtarët përpiqen që të gjejnë vend për avokatët mbrojtës duke ua lëshuar zyrën sipas nevojës. Në realitet, avokati mbrojtës dhe klienti shpeshherë ngushëllohen me takimin në korridore të objektit të gjykatës.

¹⁷⁶ Shqyrtimi i gjashtë, faqe 72

¹⁷⁷ Shqyrtimi i gjashtë, faqe 73.

V. SHQETËSIMET PËRKITAZI ME PROGRAMIN E GJYQITARËVE DHE PROKURORËVE NDËRKOMBËTAR

Programi GjPN i UNMIK-ut ishte hera e parë kur gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar kishin punuar bashkërisht me homologët e tyre vendës në gjykatat e rregullta vendëse duke e zbatuar ligjin vendës. Mekanizmi ishte komponentë e nevojshme e bashkuar me sukses të përgjithshëm në luftimin e krimit ndëretnik dhe të organizuar në periudhën pas qershorit 1999. Megjithatë, duke marrë parasysh këtë risi, jo për befasi ky mekanizëm u përball me një sërë mangësish. Edhe pse shumë nga këto janë adresuar nga UNMIK-u (lexo 35 - 37 si më lartë), disa prej tyre nuk janë shtjelluar fare.

i. Aranzhimet joadekuate kontraktuale

Çdo gjyqësi duhet të gëzojë pavarësi funksionale, kryesisht, lirinë nga ndërhyrja e ekzekutivit në rezultatet e punës së gjyqësisë. OSBE-ja është e brengosur se për shkak të natyrës së kontratave në bazë të të cilave gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar janë punësuar, ata nuk kanë gëzuar pavarësi të plotë nga ekzekutivi.¹⁷⁸ Më në veçanti, vendimet mbi zgjatjen e kontratave të gjyqtarëve nga dega e ekzekutivit e UNMIK-ut (DD-ja dhe përfundimisht PSSP-ja). OSBE-ja kishte monitoruar një numër të vogël të rasteve në të cilat ekzekutivi kishte ndërhyrë në vendimmarrjen gjyqësore.¹⁷⁹ Për këtë arsye, në shkurt 2002, OSBE-ja rekomandoi një sistem përmes cilit organi i pavarur do të vendoste mbi zgjatjen së kontratave për gjyqtarët vendës:

“Duke pasur parasysh mandatin e shkurtë të gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar për shkak të sistemit ekzistues të personelit të KB-ve dhe varshmërinë e disponueshmërisë së tyre në miratimin e qeverive të shteteve të tyre, vendimet për zgjatjen e kontratave të këtyre zyrtarëve duhet të merren jashtë autoritetit të DD-së dhe PSSP-së, si garanci e pavarësisë efektive institucionale. Çështja e zgjatjes së kontratave të gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar duhet t’i dorëzohet rregullisht KGJPK-së për shqyrtim; një konsideratë e tillë duhet të plotësojë të njëjtat kriteret si ato që aplikohen në vlerësimet disiplinore.”¹⁸⁰

Për arsye të ngjashme, OSBE-ja gjithashtu rekomandoi që:

¹⁷⁸ Shqyrtimi i katërt, faqe 29.

¹⁷⁹ Shqyrtimi i katërt, faqe 34-36.

¹⁷⁹ Shqyrtimi i katërt, faqe 43.

“Gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar duhet të jenë objekt i të njëjtit mekanizëm të llogaridhënies disiplinore sikur çdo pjesëtar tjetër i gjyqësisë. Pasiqë KGJPK-ja mund të lejojë rishikimin e vendimeve të tyre, dhe se gjetjet e saj kanë një pushtet të ekzekutueshëm dhe nuk kërkojnë miratim formal nga PSSP-ja, atëherë gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar duhet të jenë edhe objekt i procedurës disiplinore të KGJPK-së.”¹⁸¹

Fatkeqësisht, PSSP-ja dhe DD-ja nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim në këto çështje. Kontratat gjashtëmujore të gjyqtarëve ndërkombëtar zgjaten nga organet ekzekutive. Më tutje, KGJPK-së nuk i është dhënë pushteti për t’i nënshtruar gjyqtarët ndërkombëtar në masat disiplinore. Së këndejmi, organet ishin lënë me opsionin e disiplinimit të gjyqtarit nëpërmjet të zgjatjes, apo në të kundërtën përfundimin i kontratës. Kjo mungesë e pavarësisë funksionale vazhdon të minojë reputacionin e programit të PGJN-rë.

Një shqetësim tjetër buron nga kontratat e punësimit me PGJN. OSBE-ja ka vërejtur se, në një numër të rasteve, gjyqtarët ndërkombëtar kishin lëshuar misionin para përfundimit të gjykimeve të filluara. Më rastin më të mirë, kjo ka rezultuar në një situatë të pavolitshme, të ndërrimit të përbërjes së trupit gjykues gjatë gjykimit; dhe në rastin më të keq, gjykimet duhej të rifillonin. Kjo ka vënë në kompromentim administrimin e drejtësisë, ka shkaktuar vuajtje të panevojshme për dëshmitarët të cilët është dashur të ri-dëshmojnë në gjyq dhe përfundimisht ka ndikuar në të drejtën e të pandehurit për gjykim të drejtë.¹⁸² Në korrik 2003, OSBE-ja rekomandon se:

“UNMIK-u duhet të sigurojë që gjyqtarët ndërkombëtar të jenë në gjendje të përfundojnë rastet e tyre para përfundimit të misionit.”¹⁸³

Kjo do të mund të arrihej thjeshtë nëpërmjet të shtimit të një klauzole në kontratën e gjyqtarit dhe prokurorit e cila thotë se ai/ajo duhet të mbetet në mision deri sa të përfundojë gjykimi i tij/saj. Megjithatë, asnjë klauzolë e tillë nuk i është shtuar kontratës dhe problemi ende vazhdon.

ii. Procedurat joadekuate për caktimin e lëndëve

¹⁸¹ Shqyrtimi i katërt, faqe 43.

¹⁸² Departamenti i të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, raporti javor 30 qershor – 6 korrik 2003.

¹⁸³ Departamenti i të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, raporti javor i departamentit 30 qershor – 6 korrik 2003.

OSBE-ja është brengosur për mungesën e kritereve transparente për zgjedhjen e lëndëve që duhet t'u caktohen kolegjeve sipas Rregullores 64. Gjyqtarët ndërkombëtar në disa raste janë caktuar të punuojnë me lëndë të cilat kanë mundur të zgjidhen në mënyrë të duhur gjyqtarët vendës, siç janë lëndët e aksidenteve të trafikut që përfshijnë zyrtarët e UNMIK-ut, apo krime më të lehta. Është e paqartë se si është bërë caktimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve në lëndët e caktuara. Në raportin e vet “Strategjia për drejtësi” të qershorit 2001, OSBE-ja rekomandoi që:

“Duhet të bëhet një zyrtarizim i menjëhershëm i kritereve në bazë të të cilave shqyrtohen kërkesat e Rregullores 64 shqyrtohen. Këto kritere duhet t'u shpërndahen avokatëve mbrojtës me ndihmën e Qendrës burimore për mbrojtje penalo-juridike dhe Odën e Avokatëve të Kosovës. Këto kritere duhet gjithashtu t'u shpërndahen drejtpërdrejt të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve publik të emëruar.”¹⁸⁴

OSBE-ja konsideroi se mungesa e kritereve të qarta për zbatimin e Rregullores 64 mund të rezultoi që rastet e ngjashme të trajtohen ndryshe. Në prill 2002, OSBE-ja inkurajoi autoritetet që kriteret përkatëse t'i bëjnë “transparente dhe të sakta” dhe sugjeroi që “[m]e qëllim të përmirësimit të llogaridhënies, vendimet e PSSP-së për të zbatuar Rregulloren duhet të jenë të arsyetuara edhe juridikisht edhe faktikisht.”¹⁸⁵ Gjendja mbetet e pandryshuar dhe gjer më tani nuk ekzistojnë urdhëresa administrative që specifikojnë kriteret për zbatimin e Rregullores 64.

OSBE-ja gjithashtu ka shprehur shqetësimet që lëndët nuk u caktohen gjyqtarëve ndërkombëtar në bazë të një mekanizmi të zakonshëm – siç duhet të jetë – mirëpo caktohen nga DD-së, pas miratimit të PSSP-së.¹⁸⁶ Së këndejmi, OSBE-ja rekomandoi që Rregullorja 64 duhet të ndryshohet për të adresuar këtë shqetësim dhe në maj të vitit 2003 përsëriti rekomandimin e vet:

“Duhet të themelohet një mekanizëm sistematik mbi atë se cilët gjyqtarë caktohen për lenden e veçantë; caktimi i gjyqtarëve për lëndët nuk duhet të lihet nën pushtetin e drejtorit të DD-së dhe PSSP-së. Gjyqtarët e caktuar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/64 duhet të veprojnë në përputhje me të gjitha garancitë procedurale të parashikuara me ligjin vendës përfshirë këtu edhe dispozitat për diskualifikim mbi bazën e anshmërisë.”¹⁸⁷

¹⁸⁴ Strategjia e OSBE-së për raportin e drejtësisë, qershor 2001, faqe 6.

¹⁸⁵ Shqyrtimi i katërt, faqe 44.

¹⁸⁶ Shqyrtimi i katërt, faqe 25.

¹⁸⁷ Shqyrtimi i pestë, faqe 30.

Në vitin 2002, në bazë të rekomandimeve të ngjashme, drejtori i atëhershëm i DD-së kishte iniciuar konsultime me OSBE-në dhe kishte shqyrtuar të gjitha rregulloret e UNMIK-ut përkitazi me emërimin e zyrtarëve ndërkombëtar gjyqësor.¹⁸⁸ DD-ja madje edhe kishte hartuar një rregullore të re e cila kishte për qëllim të zëvendësojë legjislacionin ekzistues në lidhje me këtë çështje. Megjithatë, gjer më tani rregullorja nuk është shpallur në ligj. Si pasojë e kësaj, vazhdojnë shqetësimet lidhur me dukjen e mungesës së pavarësisë në gjyqësi.

iii. Mungesa e mentorimit

OSBE-ja është shqetësuar me mungesën e bashkëpunimit të duhur ndërmjet të GJPN dhe homologëve të tyre vendës. Organizimi i programit të PGJN, i cili shikohet si sistem paralel – me administratën e vet, zyrtarët ligjor, logjistika e avancuar, procedurat e ndryshme për caktimin e lëndëve dhe shkalla e lartë e sigurisë personale – portretizojnë një pasqyrë të ndarjes ndërmjet të gjyqtarëve/prokurorëve ndërkombëtar dhe atyre vendës. Duke marrë parasysh mungesën e njohurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar mbi standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, OSBE-ja ka qenë e mendimit që PGJN duhet të zgjerojnë mandatin e vet ashtuqë ndërkombëtares të shërbejnë si mentor të homologëve të tyre vendës; duke iu ndihmuar atyre në rastet më serioze dhe trajnimi i gjyqtarëve vendës për të zbatuar dispozitat e të drejtave të njeriut. Në raportin mbi strategjinë për drejtësinë të qershorit 2001 OSBE-ja rekomandoi se:

“Duhet të ekzistojë një zhvillim i një qasje koherente për ndarjen e punës ndërmjet gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar dhe atyre vendës në të cilën përfshihen mënyra për përmirësimin e marrëdhënieve të punës dhe sjelljes profesionale. Për shembull, përdorimi i ekipeve të prokurorëve ndërkombëtar dhe vendës do të ishte efektive në ndërtimin e kapaciteteve të prokurorëve vendës, veçanërisht në rastet e vështira siç është ndjekja penale e krimit të organizuar.”

OSBE-ja konsideron se programi i PGJN si i tërë nuk ka përmbushur aq sa duhet rolin e vet aq të nevojshëm dhe të pritur të mentorimit të gjyqësisë vendëse. Përpos punës së bashku me gjyqtarët dhe prokurorët vendës në disa raste penale, nuk ekziston ndonjë strategji e dukshme e përgjithshme e cila do të mundësonte që prania e PGJN të shërbejë si mentorim praktik i homologëve vendës apo

¹⁸⁸ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/6 mbi emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/34 dhe 2001/2, dhe Rregullores së UNMIK-ut 2000/64 mbi caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar dhe ndryshimin e vendit, siç është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/34.

edhe përfshirja e PGJN-ve në këto trajnime. Vendimi për të zhvendosur të gjithë PGJN-të në Prishtinë/Priština prej nga ata janë në gjendje që të gjykojnë rastet anembanë Kosovës (e ashtuquajtura “kompetencë e plotë”) me gjasë do të varros të gjitha shpresat për çfarëdo programi të mentorimit.

OSBE-ja mirëpret përpjekjet e ndërmarra në themelimin e Zyrës së prokurorit special të Kosovës. Sipas DD-se, është parshikuar që gjithsej 10 prokurorë dhe 10 zyrtarëve ligjor vendës do të monitorohen dhe mentorohen nga prokurorë dhe zyrtarë ligjor ndërkombëtar derisa ata ndjekin penalisht lëndët e zgjedhura të krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore, krimet ndëretnike, terrorizmin dhe rastet e korupsionit. Mbetet të shihet nëse kjo do të mbetet e vetmja trashëgimi e programit të PGJN e mbetur në sistemin e drejtësisë së Kosovës.

KREU 5

PËRFUNDIMET

Në rastin e Kosovës, rruga për të arritur tek një sistem modern i drejtësisë penale me një respekt për të drejtat e njeriut dëshmon të jetë mjaft e gjatë dhe e vështirë. Ende qëndron një rrugë e gjatë para nesh. Megjithatë, përderosa si komuniteti ndërkombëtar ashtu edhe ai vendës kanë shpresuar për një reformë më të mirë, më të shpejtë dhe më të fokusuar, shumë pak mund të dyshojnë se është arritur një progres i qëndrueshëm.

OSBE-ja ka bashkëpunuar ngushtë me partnerët e vet ndërkombëtar dhe vendës, jo së paku në monitorimin e sistemit të drejtësisë dhe ngritjen e shqetësimeve përkitazi me gjykimin e drejtë dhe procesin e rregullt. Ky raport ilustron një sërë rekomandimesh të OSBE-së të cilat janë implementuar: institucionet janë themeluar, reformat e mëdha legjislative kanë modernizuar sistemin gjyqësor, standardi i praktikës profesionale për gjyqtarët dhe juristët është arritur në disa fushat dhe përfshirja e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar ka ndihmuar në shtjellimin e çështjeve të ndjeshme të rasteve ndëretnike dhe krimit të organizuar.

Megjithatë, gati gjashtë vjet pasi që UNMIK-u filloi të administrojë me Kosovën, nuk ekziston ndonjë mungesë e problemeve; shkeljet e normave të të drejtave të njeriut vazhdojnë të ndodhin. Në mënyrë zhgënjyese, shumë mangësi të cilat janë spikatur nga OSBE-ja janë lënë të paprekura: institucionet e reja duhet të krijohen apo që të vjetrat të përmirësohen; gjyqtarët dhe prokurorët kanë nevojë për rritje të pagave; ndryshimet në ligj ende kërkohet të bëhen; gjyqtarët bëjnë të njëjtat ndryshime pas viteve të trajnimit; avokati mbrojtës ende dështon të përfaqësojë në mënyrë të duhur klientët e tyre; dhe, mangësitë janë të pandara në programin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar ende dobësojnë nismën përndryshe të suksesshme.

Për aq shumë përgjegjësi të mbetura juridike dhe gjyqësore që do t'i dorëzohen IPVQ-ve nga UNMIK-u, ky raport shërben si përkujtues i asaj çka mund të arrihet me vullnet të mirë dhe përpjekje më të madhe. Ndoshta çka është më e rëndësishme, ky raport shërben si një përkujtues i

asaj çka mbetet të bëhet me qëllim që sistemi i drejtësisë penale të plotësojë standardet ndërkombëtare dhe t'i shërbejë në mënyrë të zellshme popullit të Kosovës.

SHTOJCË

ZHVILLIMET PËRKATËSE NË LEGJISLACIONIN PENAL 2000 – 2005

2000

- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/62 mbi përjashtimin e personave për një kohë të kufizuar me qëllim të sigurimit të qetësisë, sigurisë dhe rendit publik. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/62 ka hyrë në fuqi më 30 nëntor 2000.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/64 mbi caktimin e gjyqtarëve/prokurorëve ndërkombëtarë dhe/ose ndërrimin e vendit e shpallur më 15 dhjetor 2000 e ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2001/34 dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2005/50.

2001

- Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/1 për ndalimin e gjykimeve në mungesë për shkelje serioze të ligjit humanitar ndërkombëtar, shpallur më 12 janar 2001.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/2, mbi ndryshimet e rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut, për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë shpallur më 12 janar 2001.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/4 mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë shpallur më 12 janar 2001.

- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/07 për autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë shpallur më 21 shkurt 2001.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/08 për themelimin e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës shpallur më 6 prill 2001.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/09 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, shpallur më 15 maj 2001..
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/10 për ndalimin e kalimit të paautorizuar të kufirit shtetëror/administrative shpallur më 24 maj 2001.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/12 mbi ndalimin e terrorizmit dhe akteve tjera të ngjashme shpallur më 14 qershor 2001.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/18 për themelimin e një komisioni për shqyrtimin e paraburgimeve jashtëgjyqësore të bazuara në urdhra ekzekutivë shpallur më 25 gusht 2001.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/20 për mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe të dëshmitarëve në procedurën penale, shpallur më 20 gusht 2001.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/21 mbi dëshmitarët bashkëpunues, shpallur më 20 gusht 2001.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/22 mbi masat kundër kriminalitetit të organizuar shpallur më 20 gusht 2001.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/28 mbi të drejtat e personave të arrestuar nga organet e zbatimit të ligjit, shpallur më 11 tetor 2001.

2002

- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/1, ndryshimi i rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/20 për mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe të dëshmitarëve në procedurën penale shpallur më 24 janar 2002, ka zgjatur zbatueshmërinë e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/20 për procedurat penale të iniciuara ndërmjet qershorit 1999 dhe datës së rregullores së tanishme.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/2, ndryshimi i rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/21 mbi dëshmitarët bashkëpunues shpallur më 24 janar 2002, ka zgjatur zbatueshmërinë e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/21 për procedurat penale të iniciuara ndërmjet 10 qershorit 1999 dhe datës së rregullores së tanishme.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/20 zbatimi i rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut Nr. 2000/64 për caktimin e gjyqtarëve-prokurorëve ndërkombëtarë dhe ndryshimin e vendit shpallur më 14 dhjetor 2002.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/7 mbi përdorimin e shënimeve me shkrim me rastin e marrjes në pyetje gjatë procedurës penale të udhëhequra nga organet e zbatimit të ligjit shpallur më 28 mars 2002.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/6 mbi masat e fshehta dhe masat teknike të vëzhgimit dhe hetimit shpallur më 18 mars 2002.

2003

- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/1 ndryshimi i ligjit në fuqi lidhur me veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën seksuale shpallur më 6 janar 2003.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12 mbrojtja kundër dhunës në familje shpallur më 9 maj 2003.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25 mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, shpallur më 6 korrik 2003. Kodi ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004.

- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/26 mbi Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës shpallur më 6 korrik 2003. Kodi ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/34 mbi ndryshimin e ligjit në fuqi mbi procedurën për dorëzimin e banorëve të Kosovës në shtetet e huaja shpallur më 14 nëntor 2003.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/36 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/64 për caktimin e gjyqtarëve-prokurorëve ndërkombëtarë dhe ndryshimin e vendit, shpallur më 14 dhjetor 2003.

2004

- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi pengimin e larjes së parave dhe veprave të ngjashme penale, shpallur më 5 shkurt 2004.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/8 mbi ligjin penal për të mitur, shpallur më 20 prill 2004.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/10 mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi pengimin e larjes së parave dhe veprave të ngjashme penale, shpallur më 29 prill 2004.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/19 mbi ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, shpallur më 16 qershor 2004.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/29 për mbrojtjen kundër rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, shpallur më 5 gusht 2004.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/34 mbi procedurën penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore, shpallur më 24 gusht 2004.

2005

- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/9 për ndryshimin e rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi pengimin e larjes së parave dhe veprave të ngjashme penale, shpallur më 23 shkurt 2005.

- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/26 mbi shpalljen e ligjit për zhdukjen e korrupsionit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, shpallur më 12 maj 2005.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/53, shpallur më 20 dhjetor 2005, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë. Kjo rregullore themelon Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/52 për themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) është shpallur më 20 dhjetor 2005.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/54 mbi kornizën dhe parimet drejtuese të Shërbimit Policor të Kosovës, shpallur më 20 dhjetor 2005.

LIGJET E KUVENDIT TË KOSOVËS

- Ligji mbi shëndetësinë nr. 2004/4, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 shkurt 2004, shpallur nëpërmjet Rregullores së UNMIK-ut 2004/31, shpallur më 20 gusht 2004.
- Ligji mbi bashkëpunimin me Tribunalin e Hagës, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 shkurt 2004, në pritje të shpalljes nga PSSP-ja.
- Ligji kundër korrupsionit nr. 2004/34, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 8 gusht 2004, shpallur nga PSSP-ja më 7 qershor 2004.
- Ligji mbi barazinë gjinore 2004/2, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 shkurt 2004, shpallur nga PSSP-ja më 7 qershor 2004.
- Ligji kundër diskriminimit nr. 2004/3, miratuar Kuvendi i Kosovës më 19 shkurt 2004, shpallur nga PSSP-ja më 20 gusht 2004.
- Ligji mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve nën përkujdes shëndetësor nr. 2004/38, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 8 gusht 2004, shpallur nga PSSP-ja më 19 nëntor 2004.